

Edhe këtë fundjavë në skenën e Turbinës, trupa e Teatrit Kombëtar do të luajë “Edmond” nga Alexis Michalik, nën regjinë e Indrit Çobanit dhe Andia Xhungës

“EDMOND”, HISTORIA E NJË KOMEDIE NË TEATRIN KOMBËTAR

Një shënim i shkurtër për shfaqjen e fundit të Teatrit Kombëtar shoqëruar nga një përsiatje e përkthyesit si dhe copëza bisedash me regjisorët e aktorët Lulzim Zeqja dhe Genti Deçka

nga Andreas Dushi



LEFTERI EDHE GURËT E SOKAKËVE I BËRI TË TREGONIN HISTORI

Nga Mehmet Gëzhilli

(fq. 6)

SHËNIME MBI LIBRAT

“MAXIMILAN LAMBERTZI PËR LETËRSINË SHQIPE”, VEPËR KAPITALE E ANTON N. BERISHËS

Nga Emin Azemi

(fq. 8)

Është një vepër kapitale e Anton N. Berishës që e lidhë një traditë studimi të albanologjisë evropaine dhe, sidomos, të albanologëve gjermanë e austriak, me lexuesin shqiptar, i cili shumë pak ka qenë i njoftuar mbi kontributin e këtyre albanologëve.

AVE DASHURIA SI MISION
DHE QYTETËRIM NË
POEZINË E SARË GJERGJIT

Nga Alisa Velaj

(fq. 7)

Ky vëllim poetik mund të lexohet dhe si një reminishencë biblike e rrugëtimit të qenies njerëzore, apo nostalgjisë edenike që fillojmë ta ndiejmë në shpirtrat tanë, sa herë ndiejmë pikëllimin për këtë botë përherë e më pak të përsosur ku jetojmë.

Mendime për vëllimin “Gracka qiellore”

Poezia hermetike e Mimoza Pulajt
në metamorfozën e saj të re

Nga Jolanda Cmeta

(fq. 11)



Vlerësime për tekstin e akademik Jani Thomait:
Leksikologjia e gjuhës shqipe

Teksti universitar rron gjatë vetëm kur ribotimet e tij bëhen më përkushtim e kompetencë shkencore

Nga Gjovalin Shkurtaj

Përpunimi dhe plotësimet e përditësimet e vazhdueshme e mbrojnë tekstin nga vjetrimi dhe e bëjnë atë të rrojë shumë gjatë. Teksti *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (qysh nga viti 1961) **ka qenë dhe vijon të jetë libri-bazë** për formimin shkencor të studentëve të degës gjuhë-letërsi shqipe...


(fq. 5)

Shikuar sipas teorisë psikoseksuale-patriarkale të Blumit dhe nga lëvizjet feministe

Muza vazhdon të jetë grua

Nga Dije Demiri-Frangu

(fq. 20)



VENUSI I URBINOS

Dr. Bledar Kurti

(fq. 22)

BIBLIOTEKË

Shqiponja Axhami

(fq. 10)

Për sa kohë...

Fatbardh Amursi (Rustemi)

(fq. 14)

Homer “i verbër”-në kohë verbanësh

Andrea Camilleri

(fq. 15)

Ingrid

Fatlum Mehulli

(fq. 16)

Foshnja

Adil Olluri

(fq. 17)

Vrasja e njeriut të ligjit

Zija Çela

(fq. 18)

Përgjigjet e munguara

Bajram Sefaj

(fq. 19)

Një Prilli!

Rexhep Ferri

(fq. 21)

Magjia e bjeshkëve të nemuna

**Si ta kujtojmë poetin
Evgeni Jevtushenko?**

Nga Visar Zhiti

(fq. 12)

“EDMOND”, HISTORIA E NJË KOMEDIE NË TEATRIN KOMBËTAR

Një shënim i shkurtër për shfaqjen e fundit të Teatrit Kombëtar shoqëruar nga një përsiatje e përkthyesit si dhe copëza bisedash me regjisorët Indrit Çobani dhe Andia Xhunga e aktorët Lulzim Zeqja dhe Genti Deçka

nga Andreas Dushi

Nga pikëvështrimi im si dikush që e do shumë teatrin, niveli i pjesëve që vihen në skenë nga Teatri Kombëtar bind këdo se të mos ndjekësh ndonjërin syresh, humbet shumë. Sëfundmi, “Edmond” i autorit Alexis Michalik, mjaft i njohur kudo në botë, tërhoqi vëmendjen e duartrokitjet e spektatorëve të shumtë, përgjatë netëve kur u shfaq në skenën e *Turbinës*.

I lindur më 13 dhjetor, 1982, Michalik është një aktor, dramaturg e regjisor francezo-britanik. Pjesët teatrale që kanë autorësinë e tij janë përkthyer në dhjetëra gjuhë dhe luajtur në skenat më të rëndësishme jo vetëm evropiane. Që nga 2001 kur luajti rolin e Romeo në “Romeo dhe Zhulietta”, vënë në skenë nga Irina Brook në teatrin e Chaillot, Michalik ka veshur petkun e shumë prej karaktereve më të famshme të tragjedisë, dramaturgjisë e komedisë botërore. Në vitin 2006 vuri në skenë shfaqjen e tij të parë, një komedi muzikore me motiv të marrë nga veprat e Shekspir. Që nga ajo kohë e deri tani, ka fituar disa herë çmimin *Molier* në Francë për pjesë të ndryshme.

Tejet interesante është gjithpërfshirja e tij në vepër. Nga autor i saj, kthehet në regjisor për t’u bërë mandej edhe aktor, duke mbajtur jo rrallë herë mbi shpatulla role kryesore.

Njohja më e madhe i erdhi pas vitit 2008 kur vuri në skenë *R&J*, një adaptim i Romeo dhe Zhulietës me vetëm tre aktorë që luanin të gjithë personazhet, njëri ndër të cilët ishte edhe vetë ai.

E njëjta frymë, pra ajo e një aktori që mbulon disa role ruhet edhe në shfaqjet e tjera, mes të cilave “Edmond” që, edhe nga trupa e Teatrit Kombëtar u vu në skenë pikërisht kështu. Lulzim Zeqja, Vasjan

Lami, Helidon Fino, Luli Bitri, Laert Vasili, Ilirida Bejleri, Arben Derhemi, Flaura Kureta, Myzafer Zifla, Genci Fuga, Ina Gjonçi, Besmir Bitraku dhe Genti Deçka luanin dy a më tepër role, krejt të ndryshme njëri prej tjetrit.

Historia e Edmond de Rostand ndërkohë që shkruante komedinë e tij më të njohur *Sirano dhe Berzhërak*, për më tepër se dy orë krijoi një të tillë atmosferë ku e qeshura bashkohej me përsiatje të thella të natyrave nga më të ndryshmet. Përtej saj, kjo pjesë paraqiti sërish ndryshimin rrënjësor që arti ka pësuar në të gjithë rrafshet, kryesisht atë estetik pasi, as nuk mund të imagjinohej jo shumë vjet më parë shkruarja e një teksti dramatik dhe vendosja e tij në skenë në qendër të të cilit të ishte historia se si u shkrua një komedi, pra kthimi i autorit në personazh nga një tjetër autor, me ndërmjet tyre thuajse një shekull.

Ulje-ngritjet e shpeshta e të papritura, marrjet e dhëniet mes personazheve që i luan i njëjti aktor, loja gjeniale e secilit prej zotëruesve të skenës, skenografia e mrekullueshme... E gjitha pak ditë para, atë ditë e pak ditë pas Ditës Botërore të Teatrit.

Kjo pjesë është përkthyer nga shkrimtari dhe përkthyesi i njohur Nasi Lera i cili, ndër të tjera, kur e kontaktova për t’i kërkuar një mendim, ide, përjasje a përsiatje rreth tekstit, më tha:

Që kur lexova për herë të parë tekstin e “Edmond”, u mahnita nga ideja e teatrit për teatrin. Dramaturgu Alexis Michalik ia ka dalë të ndërtojë jo vetëm një homazh për shkrimtarin, poetin, dramaturgun e jashtëzakonshëm Edmond de Rostand, por edhe një homazh për vetë teatrin, artin e arteve.

Atëherë kur mora ta përkthej “Edmond”, pata fatin të shkoja në Francë dhe gjëja e

parë që kërkoja ishte nëse në një teatër atje do të luhej kjo shfaqje. Bashkë me time shoqe vajtëm dhe e ndoqëm ku, vetë autori ishte edhe regjisor, edhe aktor në të. Ndërkohë më pas, pamë në skenën e Teatrit Kombëtar premierën e vendosur nën regjinë e Indrit Çobanit dhe Andia Xhungës. Ishte e mrekullueshme dhe (biseda mes meje dhe Nasit po zhvillohet në telefon) kam time shoqe pranë e cila më thotë se “Edmond” i Teatrit tonë Kombëtar ishte më i bukur se “Edmond” i teatrit në Francë!

Aktori **LULZIM ZEQA** është në rolin kryesor, atë të dramaturgut Edmond de Rostand, personazh nga i cili edhe komedia e merr titullin. Sikurse e thashë, Edmond është një personazh real, lindur më 1 prill 1868 në Marsejë të Francës. Vepra e tij shihet si e ndërlidhur me neo-romantizmin, ndërsa dramata e komeditë, mes të cilave më e mirënjohura është *Sirano dhe Berzhërak* duket sikur i kundërvihen teatrit natyralist aq të përhapur në të vonët e shekullit XIX. Në kohën e tij, vendosi në skenë disa pjesë, të cilat kaluan thuajse pa u vënë re nga askush, deri kur shkroi kryeveprën, *Sirano mbi të cilën është ngritur edhe subjekti i komedisë së vënë në skenë nga trupa e Teatrit Kombëtar*. Ndër punët e tij, përtej krijimtarisë vlen të përmendet edhe fakti se është përkthyes i poetit latin Katuli (*Catullus* në origjinalin latinisht). Pavarësisht kësaj dhe lidhjes së tij me skenën e teatrit, ai e ka quajtur veten poet.

Sirano dhe Berzhërak, ndonëse u shkrua në një atmosferë të çuditshme, që trajtohet aq këndshëm në “Edmond”, u kthye në triumf për vetë de Rostandin, atëherë 29 vjeç, por jo vetëm. Secili nga aktorët u bë i njohur menjëherë, pasi ajo u luajt mbi

300 net dhe në shumë pak kohë u përkthye në anglisht, gjermanisht, rusisht e të tjera gjuhë evropiane. Qysh nga Hygoi, nuk ishte shfaqur një entuziazëm i tillë për një pjesë teatrale të shkruar në vargje.

E pyeta Zeqjan fare shkurt për këtë rol, duke pasur parasysh natyrën e tij komplekse, edhe nga pikëvështrimi që më nxiti komenti i Lerës, ai i teatrit për teatrin.

Andreasi: Për ju si aktor, si ishte kthimi jo thjesht në një personazh të krijuar prej një dramaturgu, por në një personazh që vetë është dramaturg? Në këtë rast, roli i ndërmjetës mes tekstit dhe spektatorit ngjan më kompleks dhe më i ndërlikuar sesa zakonisht, apo e kam gabim...?

Lulzimi: Të them të drejtën, Aleks, autori i vërtetë i *Edmond*, me atë tekst të mirë e të vlerësuar thellësisht në Francë, e ka bërë të lehtë të përtypet nga krijuesi i figurës artistike që në këtë rast është aktori që luan Edmondin. Për mua ka qenë një punë goxha e vështirë marrëdhënia me trembëdhjetë personazhet e veprës. Dua të them kjo vështirësi më dha dhe çelësin për t’ju afruar figurës së dramaturgut. Arritja për të krijuar unë marrëdhënie si aktor me personazhet e tjerë të veprës më dha këtë çelës magjik që më hapi derën për të takuar personazhin e dramaturgut që në rastin konkret është Edmond! Procesi ka qenë fantastik!

Andreasi: Shfaqjet e ndryshme ku ju luani, a kanë një kuptim të veçantë për ju, si të thuash një kuptim unik? Nëse po, parë nga perspektiva juaj personale, në këtë rrafsh si i jeni qasur “Edmond”?

Lulzimi: Të gjithë personazhet që unë luaj kanë kuptim unik, sepse janë të gjithë personazhe unikë! Por ka personazhe që të lënë njolla ose bëhen pikë kyçe për aktorin në karrierë... dhe sa për Edmondin, besoj se është i tillë!

Ndërsa **GENTI DEÇKA**, aktori i dashur për publikun dhe edhe për mua personalisht, luan disa role episodike, karaktere krejt të ndryshme, që, parë nga një sy i pastërvitur, ngjan vërtetë e çuditshme se si dikush ia del me sukses të futet nën lëkurën e gjithë atyre personazheve, për shumëkënd një gjë e pamundur. Ndër to është edhe ai i shkrimtarit të madh rus, Anton Çehov për të cilin thuhet se vërtetë, për hir të rastësisë, është takuar me Edmond de Rostandin në Paris.

Në vijim, shkurt e përmbledhtazi, Deçka e tregon në këtë eksperiencë të veçantë e tejet të bukur...

Andreasi: Në galerinë e personazheve që luani në “Edmond”, kë do të veçonit dhe pse?



Lulzim Zeqja



Genti Deçka



Genti: Nuk mendoj se ka një aktor i cili nuk do të ëndërronte të luante Çehovin në skenë. Fatkeqësia e rolit në fjalë është jetëgjatësia shumë e shkurtër në skenë. Sa herë Çehovi im personal del nga skena, një fije keqardhje më përshkon dhe më bën të dua ta mbaj fort atë çast. Por teatri i tillë është, lind aty dhe vdes aty...

Andreasi: Si e perceptoni raportin e publikut me atë aktor që gjatë një shfaqjeje vesh petkun e disa personazheve?

Genti: Sfida e aktorit me veten në radhë të parë është qasja ndaj rolit çdo herë me unikalitet, i cili në sytë e publikut duhet të përkthehet në disa personazhe të mirëtheksuar dhe të ndryshëm prej njëritjetrit.

Në rastin e shfaqjes “Edmond” kjo sfidë shumëfishohet duke e vendosur aktorin para një përgjegjësie akoma më të madhe krahasuar me shumë vepra të ngjashme. Shpejtësia, sinkronizimi, kostumet, dinamikat e ndryshme të skenave të “Edmond”, e vendosin aktorin përballë një përgjegjësie të madhe duke mos e lënë këtë të fundit plotësisht të qetë as kur magjia e “Edmond” mbaron dhe aktori shkon në shtëpi. Do të doja të dija çdo natë, të kuptoja atë që përpiqemi të përcjellim te publiku më këtë gjerdan rolesh, por fatkeqësisht nuk mund të lexojmë mendjet e tyre.

Andreasi: Rolet tuaja janë episodike, si copëzat e vogla të mozaikut pa të cilat, ai është i çalë, i paplotë... Ky mozaik, pra kjo shfaqje, mendoni se i flet në të njëjtën mënyrë kujtdo, pa kufij gjeografikë, pra njëlloj flet me spektatorin shqiptar ashtu sikurse me atë francez?

Genti: Po e mbyll me diçka nga Çehov: “Sot ndoshta jemi vetëm tre, nesër do jemi gjashtë dhe kështu me radhë... Nëse luftojmë çdo ditë për atë që është vlerë, do të shumëfishohemi patjetër!”

në Akademinë e Arteve, Ervina Kotolloshi, e cila prej vitesh jeton aty dhe punon si Pedagoge në një universitet pranë Parisit.

Takimi i dytë dhe më i rëndësishëm ishte pasi mjeshtri i përkthimit dhe letërsisë Nasi Lera na e dha tekstin e përkthyer. Pasi ia propozuam për përkthim, Zotit Lera, ai e mori si fillim vetëm për ta lexuar dhe do të na kthente një përgjigje nëse do ta ngacmonte vepra apo jo. Por brenda pak ditëve që na kërkoi takimin e dytë, na e solli të përkthyer. I mrekulluar nga pjesa dhe njëkohësisht i habitur nga vështirësia që ai imagjinonte sesi do vihej kjo pjesë në skenë. Në të dyja takimet, qoftë kur e dëgjova të treguar, qoftë kur e lexova, zemra rrihte fort dhe thoshte vetëm PO.

Indriti: Në vitin 2017 kam qenë në Rene në TNB festival me shfaqjen *Lucrezia Borxhia* të regjisorit Eric Vigner. Këto janë mundësi që kontakti me teatrin bashkëkohor të jetë i drejtpërdrejtë, dhe sigurisht unë e shfrytëzoja për të njohur dhe krijuar kontakte jo vetëm me aktorë, regjisorë, por edhe me dramaturgjinë moderne. Por surpriza më e bukur ishte në Paris, kur mikësha ime dhe e Andias, Ervina Kotolloshi erdhi na takoi dhe na dhuroi “Edmond” nga Alexis Michalik e botuar dhe vënë në skenë vetëm pak muaj përpara me shumë sukses në Paris. Dhe kështu ne u kthyem nga Parisi sëbashku me “Edmond” në Tiranë.

Andreasi: Produksione të tilla, me numër aq të madh aktorësh pjesëmarrës, janë pak “të frikshme”. Ishte e vështirë për ju në këtë rast të dilnit mbi dyshimin e suksesit të kësaj shfaqjeje?

Andia: Jo nuk ishte aspak e frikshme. Sa më shumë aktorë në skenë, aq më e bukur/intensive shfaqja. Sigurisht që numri i lartë i aktorëve kërkon një menaxhim shumë të madh. Mbi të gjitha që secili prej tyre luante

nga 3-4 role. Nëse do të ishin mbi skenë aktorë, aq sa ka role vepra, duhet të ishin diku te pesëdhjetë aktorë. Po me këtë pjesë është marrë më shumë Indriti. Çdo ditë kam vërtetuar me sytë e mi, sesi i ka frymëzuar aktorët një e nga një. Sesi i ka ndenjur pranë, sesi i ka këshilluar, sesi ka këmbëngulur, për të parë rezultatin që ju keni parë sot. Dita ditës, MOS dyshimi që kishim, vërtetohej gjatë provave krenarisht!

Indriti: Shfaqje si “Edmond” me një numër të pazakontë skenash, me një numër të pazakontë personazhesh, me një numër të pazakontë rolesh që luan i njëjti aktor, e bëjnë të jashtëzakonshme eksperiencën për një regjisor. Çdo krijimtari është një hap nga e njohura drejt së panjohurës dhe si e tillë, aty brenda janë frika, guximi, ankthi, besimi, dyshimi, entuziazmi, errësira, drita, ngjyrat, ëndrra...

Andreasi: Spektatorët e mbushën thuajse çdo natë plot sallën e Turbinës. Ky fakt si ju bën të ndiheni?

Andia: Për herë të fundit publikun sy më sy e kishim parë para pandemisë. Dhe ta shikoje sallën aq plot e përplot pas dy viteve shkëputje ishte një kënaqësi shumë e madhe. Jam e lumtur që “Edmond” vazhdoi e mbushi sallën plot e përplot, akoma edhe më shumë se “Familja Tot apo Tag” etj....

Indriti: Nuk mund të ketë Teatër pa publikun. Është gjysma e trupit. Teatri është një vend ku ne mund të bisedojmë me veten, të nxisim monologjet tanë të brendshme ndërkohë që dëgjojmë dialogët e të tjerëve...

Andreasi: A mendoni se me kohën, publiku shqiptar po del mbi vetveten duke edukuar shijet e tij estetike aq sa të përjetojë në plotni një komedi, dramë a tragjedi bashkëkohore evropiane?

Andia: Publiku është si fëmija, çfarë t'i japësh për të ngrënë, atë do të hajë! Nëse e kultivojmë që në fëmijëri me Teatër të

mirë, me kulturë, me shije të hollë për artin, atëherë kur të rritet, nuk mund të ketë shije tjetër... Është shumë i rëndësishëm Teatri për fëmijë. Që aty duhet të nisë gjithçka. Duhet të investohet më shumë te dramaturgjia për fëmijë. Brezi i ri duhet të bëjë ndryshimin dhe për këtë duhet ndihmuar. Gjithsesi Teatri i përket publikut dhe publiku kurrë nuk duhet gjykuar.

Indriti: Për fatin tonë jo të mirë, nuk kemi nga pjesa burokrate e Teatrit asnjë studim të audiencës. Publiku na njeh shumë mirë, ata e kanë një skaner mbi aktorin, dramaturgjinë, ndërsa institucionet e Teatrit nuk e kanë. Personalisht i jam drejtuar për konsultim disa organizatave që kanë bërë disa studime jo specifkisht për audiencën e teatrit, por me fokus të afërt, por këto mbeten angazhime individuale të miat. Prezenca e publikut të plotëson, i jep kuptim ekzistencës sonë në skenë, si pasojë jam i lumtur dhe në përpëlitje për ta njohur sa më mirë publikun...

Andreasi: Po rreth eksperiencës së të qenurit bashkëregjizor, çfarë mund të thonë?

Andia: Kur i cakton pikat mbi i që në fillim, çdo gjë shkon më së miri. Sigurisht që orkestra ka vetëm një dirigjent. Por bashkëpunimet tona janë që nga shfaqja jonë e parë në skenë në 2003. Pra le të themi, që tashmë me apo pa emrin e të dyve mbi poster, të njëjtën gjë kemi bërë në çdo shfaqje.

Indriti: Andia është burim energjie, pasioni, dashurie, nuk mund të bëhej “Edmond” nëse nuk do të ishim bashkë!

Sigurisht, gjithë kjo, nga përkthimi i Nasit e deri te gjenialiteti i aktorëve, do të mbeteshin në një hapësirë eterne, të boshtë, larg spektatorit, sikur të mos ishte për punën e dy regjisorëve, partnerë në këtë projekt, por jo vetëm: partnerë në jetë. Fjalën e kam për **INDRIT ÇOBANIN E ANDIA XHUNGËN**, çiftin e artistëve që morën guximin ta vinin “Edmond” në skenë. Sapo i kontaktova, e mirëpritën me shumë dëshirë ftesën për t’ju përgjigjur pak pyetjeve rreth kësaj shfaqjeje, secili nga pikëvështrimi i vet si dhe nga ato çfarë kujtojnë apo përjetojnë.

Andreasi: Nga erdhi njohja e parë me tekstin dhe çfarë ju shtyu të mendonit vendosjen e tij në skenë?

Andia: Edmondin e kemi takuar për herë të parë në Paris. Ishte një dhuratë nga mikja jonë e ngushtë, shoqja ime e klasës



Andia Xhunga



Indrit Çobani

Edhe për mua personalisht, është hera e parë që shkruaj për një pjesë teatrale të parë në kompleksitetin e saj, duke dalë përtej ndonjë qasjeje letrare a filologjike vetëm të tekstit. Singlerisht, kur e ndoqa shfaqjen, mendova se nuk kishte kuptim mos të sillja te lexuesi ynë nëpërmjet zërave të disa artistëve që i çmoj shumë diçka nga kjo shfaqje. Shumëkush, jo për faj të vet por për hir të mundësive, nuk i ndjek dot produksionet e Teatrit Kombëtar. Kjo edhe për shkak të një handikapi pa kuptim falë të cilit, nuk e di se pse, trupat teatrale nuk lëvizin, të paktën brenda Shqipërisë. Nuk e di herën e fundit kur trupa e Teatrit Kombëtar ka ardhur, fjala bie, në teatrin “Migjeni” të Shkodrës, ndonëse trupa e këtij të fundit ka vënë në skenë e Teatrit Kombëtar shfaqjen e fundit që u luajt aty para shembjes së godinës, “Gomari i Babatasit”.

Ku i dihet, ndoshta ky shkrim nxit dikë për të shërbyer në të mirë të asaj ndërldhjeje që mungon, kështu mungesa e jetës aktive kulturore në shumë qytete që nuk janë Tirana do të gjallërohet paksa, ndërsa shija estetike, me patjetër do të latohet edhe më!

Përpunimi dhe plotësimet e përditësimet e vazhdueshme e mbrojnë tekstin nga vjetrimi dhe e bëjnë atë të rrojë shumë gjatë. Teksti *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (qysh nga viti 1961) **ka qenë dhe vijon të jetë libri-bazë** për formimin shkencor të studentëve të degës gjuhë-letërsi shqipe në të gjitha universitetet dhe institutet e larta pedagogjike. Përpunimi, rishtjellimet dhe plotësimet e shembullzimet e reja në ribotimin e vitit 2020 e bëjnë atë një **tekst monografik nga më të plotët në fushën e gjuhësisë shqiptare**. Ai do të mbetet edhe më tej si teksti bazë dhe si model i përkushtimit e i kujdesit të autorit për ta vënë mësime të mbështetje të sigurtë të hulumtimeve të reja shkencore.

“Mori bilë, bilë e Lalës,
mori e bukur, mori e zymët,
Pse më shpie në monë e shkuom?”
(G.Dara i Riu, Kënka e sprasme e Balës)

E fillova me këto vargje këtë shkrim vlerësues për librin *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (2020) të akademikut Jani Thomai, sepse ribotimi i këtij libri, mbas plot 60 vjetve, mua dhe atyre që kemi qenë studentë të degës së gjuhës e të letërsisë shqipe në vitet 1962-1966, na kujton botimin e parë të tij, të vitit 1961, na kujton kohën kur ishim studentë në vitin e parë të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë dhe teksti në formë dispense të shaptilografuar nga Shtëpia Botuese e Universitetit ishte nga tekstet e para origjinale në gjuhën shqipe. Atëherë librat e tekstet, qoftë edhe të shtypura me shaptilograf, ishin të pakët; shumë nga lëndët e formimit shkencor e profesional i jepnim provim mbi bazën e leksioneve të folura nga pedagogët, që i shkruanim me shkurtime në fletore, sepse Universiteti i Tiranës ishte ende i ri (themeluar në vitin 1957). Mbaj mend se teksti *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (1961) në formë dispense ishte nga të paktët libra që patëm mundësi ta kishim në kohën e duhur dhe prof. Jani (atëherë djalë i ri, i pashëm e i veshur me sqimë) ishte nga ata që jo vetëm shpjegonte qartë e rrjedhshëm, po edhe, në leksionet e folura, përtej atyre që kishte shkruar në dispensën e sapobotuar, shtonte, saktësonte, shembullzonte në çdo temë a nëntemë dhe, sigurisht, kemi përfituar mjaft edhe nga shembulli e modeli i tij si ligjërues universitar, serioz dhe i saktë, i përgatitur mirë, i gatshëm për shpjegime e përgjigje të lidhura me lëndën, po edhe kërkues e me zotësinë që të na hapte edhe horizonte për punë të mëvetësishme e duke na ngjallur edhe dëshirën që të mblidhnim fjalë të rralla të shqipes, të lakmonim të ndërmerrnim detyra kursi e tema nga fusha e leksikologjisë apo e dialektologjisë, sikundër kishte bërë edhe vetë ai, duke u diplomuar me një temë studimore për të folmen e vendlindjes së tij, Semanit (rrethi i Fierit), që vlerësohet si një nga monografitë e para, por edhe më të plota e të mira të dialektologjisë shqiptare.

Lënda e Leksikologjisë, në ato vite (tashmë të largëta) sipas Planit mësimor e programeve të lëndëve (që tashti po u thonë *kurrikula e silaba*) bëhej një

(Vlerësime për tekstin e akademik Jani Thomait: *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (Shtëpia Botuese “Qendra Traditë-Art-Libra (QTAL), Tiranë, 2020)

Teksti universitar rron gjatë vetëm kur ribotimet e tij bëhen më përkushtim e kompetencë shkencore

Nga Gjovalin Shkurtaç

semestër dhe jepej provim si lëndë e përbashkët me *Fonetikën e gjuhës shqipe*. Të dyja ishin lëndë të vështira për studentët që vinin nga shkollat e mesme e me atë nivel që vetëkuptohet, porse në rastin tim, që kisha kryer shkollën e mesme pedagogjike në Shkodër, kisha një farë njohurie sadokudo më të mirë, sepse kisha pasur mësues të gjuhës shqipe disa nga emrat e mirënjohur si Shefik Osmani, Tomor Osmani, Luigj Franja, Safet Hoxha, Fadil Podgorica, Neki Lezha etj., të cilët, sikundër dihet, kur do të hapej Instituti i Lartë Pedagogjik (sot Universiteti) i Shkodrës, ata krahas prof. Kolë Kamësit, prof. Kolë Ashtës, prof. dr. Jup Kastratit etj. do të ishin ndër pedagogët titullarë të lëndëve kryesore të programit të shkollës së lartë.

Viti i parë i studimeve në universitet gjithmonë është i vështirë, por në atë kohë, pikërisht për mungesën e teksteve origjinale e të shkruara në gjuhën shqipe ishte shumë i vështirë. Për disa lëndë kishte vetëm dispensa të përkthyer nga gjuha ruse si *Hyrje në gjuhësi*, që e ligjëronte doc. Mynyr Reso, por teksti me të cilin studionim ishte i Reformackit, një gjuhëtar rus. Të përkthyer ose të kompiluara (termi që përdorej në ato vite) ishin edhe dispensat e letërsisë së huaj, të cilat, megjithatë, kishin dituri të mira dhe sidoqoftë, me ato dhe leksionet e folura e seminarët e literaturën ekzistuese, u formua një brez që nuk do të shkonte pa lënë gjurmë. Po lejohem të përmend se kemi qenë në vitin e parë dhe kemi ndjekur lëndën e Leksikologjisë një grup i vogël studentësh e prej tyre disa do të bëheshin gjuhëtarë të njohur si prof. dr. Ethem Likaj, prof. dr. Hëna Pasho, që ka punuar për shumë vjet si hartuese fjalorësh terminologjikë në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë, prof. dr. Ali Xhiku, studiues i letërsisë shqipe dhe arbëreshe, prof. dr. Agron Duro edhe ai terminolog i njohur etj.

Teksti *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (1961) i Jani Stëfit (më vonë do ta ndërronte mbiemrin në Thomai) ka qenë nga tekstet më të para origjinale për lëndë të formimit gjuhësor. E kam ruajtur atë tekst, sikundër kam mbajtur në raftet e bibliotekës sime edhe dispensat e disa lëndëve të tjera të asaj kohe, prej të cilave, për nivelin e lartë

dhe argumentimet e shembullzimet e përshtatshme e të vlefshme dalloheshin “Hyrje në historinë e gjuhës shqipe-Fonetika historike e shqipes” nga prof. Eqem Çabej, “Morfologji e gjuhës së sotme shqipe” nga prof. Shaban Demiraj; “Fonetika e gjuhës shqipe” nga Anastas Dodi dhe “Dialektologjia shqiptare” nga Jorgji Gjinari. Teksti i parë i Leksikologjisë (dispensë, 1961) u botua për herë të parë si libër (me shtyp të lartë) nga Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore të Krahinës Autonome të Kosovës, Prishtinë, në Ndërmarrjen grafike “Slobodan Joviq”, Beograd, me 1970, 120 faqe, nën kujdesin e Ahmet Kelmendit.

Dhe, për ta mbyllur këtë hyrje që na shpie këtu e 60 vjet më parë, duhet të themi se prof. dr. Jani Thomait, përtej vlerësimeve meritore si leksikologu më prodhimtar i kohës sonë, autor monografish të gjera për probleme të derivacionit semantik e të leksikut dialektor e krahinor të shqipes, kryeradaktor dhe autor fjalorësh madhorë të gjuhës shqipe (*Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*), drejtues projektesh madhore në fushën e leksikografisë shqiptare, i takon merita se ia doli me sukses të na jepte **shpejt e mirë** të parin tekst mësimor për leksikologjinë shqiptare. Me atë tekst (natyrisht edhe të ribotuar disa herë për nevojat e studentëve të profilit filologjik e gjithmonë edhe duke e përmirësuar, duke i bërë plotësime, shembullzime të hollime me shumë rëndësi për formimin shkencor të studentëve e leksikologëve të rinj), akademik Jani Thomai ka kontribuar ndjeshëm në formimin e brezave të tërë të studentëve e pasuniversitarëve të fushës së filologjisë e të gjuhësisë shqiptare në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, në të gjitha fakultetet e degët ku teksti *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (qysh nga viti 1961) **ka qenë dhe vijon të jetë libri-bazë** për formimin shkencor të studentëve. Teksti krijon e jep thuajse të plotë sistemin konceptor të fushave të leksikut, të semantikës leksikore, të fjalëformimit, të frazeologjisë e të leksikografisë, duke qenë si udhërrëfyes e mbështetje teorike për analizat, interpretimet e përgjithësimet e të dhënave konkrete të shqipes. Pjesa



kryesore e këtij sistemi konceptor jepet si shtojcë në fund të tekstit. Theksojmë se ky libër është jo vetëm teksti i parë mësimor i lëndës së leksikologjisë shqipe, po është njëherazi edhe histori e zhvillimit të fushave të leksikologjisë e të leksikografisë shqipe që nga fillimi, duke e sjellë atë deri më 2020.

Me librin *Leksikologjia e gjuhës shqipe* janë formuar dhe kanë marrë dijet e para për leksikologjinë e leksikografinë shqiptare breza të tërë studentësh, pasuniversitarësh prej të cilëve do të dilnin edhe figura të dalluara të profesoratit në universitetin e Tiranës e të rretheve, si prof. dr. Ali Jashari, hartues i disa fjalorëve dhe monografive të gjera për leksikologjinë shqipe, prof. dr. Valter Memishaj, bashkautor në *Fjalorin e gjuhës shqipe* (2006, 2020) dhe autor i disa monografive nga fusha e leksikologjisë, kurse aktualisht “krah i djathtë” i akad. Jani Thomait në Projektin madhor të hartimit të *Fjalorit të Madh të Gjuhës Shqipe*, të mbështetur nga Akademia e Shkencave. Në pamundësi për t’i përmendur të gjithë, mjafton të themi se pjesa dërmuese e atyre që kanë hartuar fjalorë të gjuhës shqipe gjatë këtyre gjashtëdhjetë viteve të fundit kemi qenë ish-studentë ose ish-doktorantë të Jani Thomait dhe, për arsye të kompetencës, përkushtimit e seriozitetit të tij, gati të gjithë ata që kanë mbrojtur grada e tituj shkencorë në lëmin e leksikologjisë e të leksikografisë shqipe kanë pasur “kungimin” e kryeleksikologut tonë të urtë, si mentor (udhëheqës shkencor), si recensues dhe, shpesh, disa kanë pasur edhe gëzimin që prof. Jani t’u ketë shkruar edhe Parathënien e veprave të tyre e që, natyrisht, ka qenë një vlerë e shtuar e botimeve të tilla, si “Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe” (Korçë, 2007) dhe “Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit” (Korçë, 2016) dhe “Fjalor i homonimeve në gjuhën shqipe” (Tiranë, 2020) të prof. dr. Ali Jasharit, ish-studentit dhe vazhduesit të përkushtuar e meritort të akademikut J. Thomai.

Më poshtë, sipas traditës së vlerësimit të veprave shkencore, po lejohem të shpreh **disa kundërime më të veçanta:**

Së pari, vlerësoj se ribotimi i teksteve të tilla si *Leksikologjia e*

gjuhës shqipe mbas plot gjashtëdhjetë viteve që nga botimi i parë, kur është fat i bardhë që autori të jetë ende gjallë e në jetësi e podhmtari të plotë si akademiku Jani Thomai, ish-profesori, kolegu e miku ynë i dashur, tashmë 87-vjeçar, duhet përshëndetur, përgëzuar e uruar ashtu si veprohet në rastin e restaurimit të ngrehinave të mëdha monumentale arkitekturore, sepse teksti *Leksikologjia e gjuhës shqipe* mbasi është lexuar e studiuar me përfitim nga mijëra studentë e pasuniversitarë dhe nga leksikologët specialistë, mbas këtij rivështrimi e përplotësimi me kundërime, ravijëzime të reja me shtesa shembullzimesh të përzgjedhura e të përditësuara e me akribinë që i karakterizon shkrimet e Jani Thomait, ka marrë tashmë nivelin e atillë që mund të quhet një tekst monografik, një libër që meriton jo vetëm të përgëzohet, po edhe të urojmë të ndiqet si shembull prej të gjithë gjuhëtarëve që kanë shkruar e botuar tekste universitare.

Për ta merituar këtë cilësim, autori ka gjetur edhe një gërshetim të përshtatshëm të tipologjisë së radhitjes së lëndës, krerëve e sythave të librit, duke sjellë me madhësi të dallueshme shkronjash shtjellimet plotësuese e kundërime të reja të hollësive e saktësuese, si dhe referimet bibliografike, duke iu shmangur shënimeve në fund të faqeve (footnotes), pra, edhe duke ua lehtësuar punën lexuesve, po edhe duke i dhënë parashtrimin karakter unik e të mbërthyer në mënyrë shumë të rrjedhshme e të atillë që të theksohen sa më mirë dijet kryesore (konceptet, nocionet, përkufizimet) e të dallohen nga ato plotësuese e të një rëndësie dytësore, por gjithsesi të domosdoshme e të vlefshme për një rrokje sa më të plotë të lëndës. Pra, aty na jepen në një organizim të natyrshëm krejt qerthulli i dijenive që duhet të ketë një njeri që merret me studimet në lëmin e leksikologjisë e të leksikografisë shqipe.

Së dyti, vlerësoj se libri *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (2020) pohon dhe argumenton bindshëm që në fushën e leksikologjisë e të leksikografisë shqipe tashmë është krijuar një trashëgimi e pasur, kanë ardhur prurje të shumta nga mbledhjet e leksikut dialektor e të rrjedhave prej botimeve letrare e artristike dhe nga ligjërimi i mediave etj., po ka pasur edhe botime me vlerë nga të gjitha krahinat shqiptare e nga shtresat leksikore nga vjeljet e letërisë së shkruar dhe nga gjuha e folur.

Leksikologjia shqiptare nis me një fjalor, me *“Fjalorin latinisht-shqip”* të Frang Bardhit (1635). Prej këtij caku kohor, në rrjedhë të moteve, nga shekulli në shekull, ndihmesat njohëse, botimet dhe studimet janë zgjeruar e janë bërë më cilësore. Shumë gjuhëtarë shqiptarë e albanologë të huaj të shquar kanë dhënë ndihmesën e tyre në fondin tashmë të pasur të studimeve për gjuhën shqipe e sidomos për leksikologjinë e leksikografinë shqipe. Mund të thuhet se gjysma e dytë e shekullit të kaluar dhe këta dy dhjetëvjeçarët e parë të mijëvjeçarit të ri kanë qenë më të begatë, si në prodhimtarinë shkencore

të mirëfilltë, ashtu edhe në përpunimin e zbatimin e metodave bashkëkohore të studimeve. “Por- sikundër e ka theksuar edhe vetë profesor Jani -mbetet ende shumë për të bërë, si për studimin e çdo gjuhe, edhe për shqipen është e natyrshme të ketë përparim të mendimit shkencor e të metodologjisë së kërkimit, të ndiqen zhvillimet e pandërprera të gjuhës gjithnjë në lëvizje, siç është edhe vetë mendimi shkencor. Kështu, dyshoj se do të vijë një ditë e të themi “bëmë aq sa duhet”. Por të bëjmë së paku aq sa mundemi. (Shih: “Ex Libris”, E shtunë, 26 maj 2021, f.1-5).

Pa dyshim se, ashtu si e thotë akademiku ynë, trashëgimia që sot e kemi, na lejon të bëhen edhe sintheza e parashtrësia më të plota, jep dorë që tashmë mund edhe të ndërmerren hulumtime thelluese e të përmirëtuara dhe të mbërrihet ngritja e cilësisë së mësimdhënies së leksikologjisë si lëndë formuese e dorës së parë në shkollat e larta të profilit filologjik e të mësuesisë. Mbi të gjitha, libri *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (2020) synon dhe ia del mbanë në mënyrë të tumirueshme për ta zgjeruar më tej problematikën e kërkimeve të mëtejshme, duke dhënë mbështetje të sigurtë për t’i forcuar bazat teorike të formimit shkencor e profesional të studentëve e pasuniversitarëve në krejt hapësirat ku ka universitete ose institute kërkimore albanologjike që kryejnë edhe hulumtime e studime për leksikon, në të gjitha trojet ku flitet e shkruhet shqipja. Shpreh bindjen time të plotë se libri *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (2020) do të jetë edhe më tej mbështetje e fortë për studimet gjuhësore dhe për formimin e gjuhëtarëve të rinj.

Së treti, vlerësoj si ndihmesë të shënueshme dukurinë se në këtë

ribotim të tekstit *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (2020), autori ka mbërritur të shkojë shumë më lart, po edhe të shtrihet më gjerë sesa detyra e një përditësimi a plotësimi të ndonjë sythi a kreu, sikundër bëhet zakonisht në ribotimin e teksteve universitare për nevoja të mësimdhënies e të pajisjes së studentëve me një tekst bazë e të rëndësishëm. Teksti ka të njëjtën bërthamë fillestare, por ai tashmë pothujase është rishkruar, pasuruar e përpikmëruar në shkallën më të lartë të mundshme.

Akad. Jani Thomai, edhe në ribotimet e mëparshme të këtij tekti kishte bërë shtesa, përpunime, shtjellime të përditësuara e të shembullzuara më ndryshe, kurse në ribotimin që kemi në dorë, me shumë ëndje, studentët, pasuniversitarët dhe leksikologët e leksikografët apo, thënë ndryshe, të gjithë ata që filologjinë dhe gjuhësinë e kanë profesion, do të gjejnë një trajtim sa të përditësuar e të pasuruar, aq edhe të përmirëtur e të thelluar në shtjellime të reja, që mund të shihet si modeli sesi duhet të veprojnë autorët e suksesshëm të teksteve për shkollën e lartë.

Libri *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (2020), me përpunimin e thelluar që i është bërë, me rikundrimin (përkant. rihartimin) e rritjen cilësore të parashtrimit e të krejt shtjellimeve të tij, ka mbërritur në cilësimin më të lakmueshëm të një libri universitar, si **tekst monografik nga më të mirët që kanë dalë deri më sot në fushën e gjuhësisë shqiptare**. Le të përmendim, me këtë rast, si thotë fjala e bukur e etnografisë së të folurit popullor: për t’ia shëndoshur krahët autorit rrëfimin e tij të çiltër në Parathënien e këtij libri, ku ai ka shprehur se

gjatë punës për ta ripunuar, për ta përditësuar e për ta plotësuar atë punë janë mbajtur parasysh, ndër të tjera, katër synime kryesore, të cilat po i parafrazojmë sipas rendit që i ka pohuar ai. Synimet e një studiuesi e pedagogu me përvojë të gjatë si titullar i Leksikologjisë, natyrisht, do të ishin të lidhura me pasqyrimin sa më të plotë të arritjeve të gjuhësisë shqiptare në 20 vitet e para të mjëvjeçarit të ri; të vendosej një përpjesëtim më i mirë ndërmjet degëve e nënfushave të leksikologjisë, si semasiologjia, frazeologjia, terminologjia, vlerat stikistike e ligjërimore të fjalëve etj. Si gjuhëtar me përvojë të gjatë, autori ynë ka lakmuar që teksti të jetë i atillë që t’u japë studentëve dije e shtjellime me karakter formues dhe nxitës për ta njohur, dashur e adhuruar fjalën shqipe, për ta zotëruar frazeologjinë dhe aftësinë e pashtershme fjalëformuese e fjalëkrjuese të popullit shqiptar, për të hyrë sa më thellë në njohjen e terminologjisë së fushave të shumta e të larmishme të shqipes dhe hapësirat e stilistikës gjuhësore, duke dalluar edhe raportet midis togjeve frazeologjike të qëndrueshme dhe fogfjalëshave të lirë etj. Natyrisht, në të gjitha këto kahe a synime, vrujon përherë mëtimi madhor i autorit që libri të jetë jo vetëm mbështetje për mësimin e lëndës së Leksikologjisë, po edhe i dobishëm për një log sa më të gjerë lexuesish e studiuesish, veçmas për mësimdhënësit e gjuhës shqipe, për gazetarët dhe për të gjithë ata që kanë dëshirë a detyrë të thellohen në njohjen e fjalës shqipe si njësi leksikore dhe veçoritë e saj në gjuhën shqipe; që duan të dinë e të thellohen në kuptimin leksikor dhe tërësor e të mëvetësishëm, për fjalën si strukturë që ka përmbajtje dhe formë të caktuar etj.

Së mbrami, natyrisht në hapësirat nevojshat të rrudhura të një recensionit vlerësues e paraqitës të përgjithshëm, por jo shterues, e ndiej për detyrë ta përgëzoj ish-pedagogun tim e kolegun nderuar, akademikun shumë të çmuar Jani Thomain, për këtë botim të tekstit *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (2020) duke theksuar se ky libër pasqyron zhvillimin e shkencës së leksikologjisë e të leksikografisë shqipe, si dhe të disiplinave të tjera të gjuhësisë shqiptare e botërore, prandaj, sikundër e ka pohuar edhe vetë autori “dera mbetet e hapur për përditësime e prurje të reja, të mëtejshme”. Teksti mbyllet me një bibliografi thuajse të plotë të studimeve (monografi, artikuj shkencorë, fjalorë etj.) për këto fusha, që kanë qenë burim shkencor për tekstin, por që kanë qenë e janë mundësi e lehtësi për t’u shfrytëzuar për gjithë ata që duan t’i zgjerojnë njohuritë e tyre në këto fusha, për studentët si referenca mbështetëse për hartimin e temave të diplomave universitare, ose për këdo që ndërmerr studime në këto fusha për master, doktoraturë etj.

Jetë të gjatë, shëndet e vlagë pune edhe për vepra të tjera profesori ynë i nderuar dhe i vyer.

Tiranë, 24 mars 2022



Këtu e mëse 45 vjet më parë, më 1965, kur isha djalë i ri, m'u dha rasti të vizitoj Gjirokastrën, ku u sorollata nëpër sokakët e saj misteriozë për dy ditë të plota.

Ishim një grup korçarësh që për sdhjetë ditë do të vizitonim Shqipërinë e Jugut.

Kot nuk thonë, se sa më shumë të udhëtosh, aq më shumë do të mësosh, por edhe aq më shumë do ta duash vendin tënd.

Midis shumë vizitave, pa e diskutuar vizitën në Kalanë – anije gjigande majë kodrës, nuk mund të lihej pa vizituar edhe shtëpia ku kishte lindur Enver Hoxha, muze që s'kishte një vit që ishte inauguruar.

Aty njoha për herë të parë Lefter Dilon, një burrë tepër i tërhequr, veshur me shumë sqimë, dhe çdo gjë dukej sikur i ndriste.

Dukëe na përshëndetur miqësisht dhe na uruar mirëseardhjen, menjëherë shtruar-shtruar por si i thonë fjalës, filloi të fliste me shpirt për historinë, duke u përqendruar te pavioni i Rilindjes Kombëtare.

Duke soditur portretet e rilindasve të mëdhenj, vendosur njëri pas tjetrit, Lefteri e ndali shkopin e ciceronit te disa kopertina gazetash. Ato titulloheshin “Shkopi”, “Sopata”, “Rrufeja”.

-A i shikoni këto gazeta? – na u drejtua Lefteri me një pyetje sugjestionuese dhe aty për aty na e dha vetë përgjigjen: - Këto gazeta i ka botuar larg në Egjipt Jani Vruho, i ndihmuar nga Athanas Tashko. Dhe e dini se çfarë kishte krijuar me këto tre tituj? Një shprehje proverbiale: “Armiqtë e kombit tonë më “Shkop” t'i rrahim, me “Sopatë” t'i presim, me “Rrufe” t'i shfarosim!”

Dhe pastaj duke na kaluar nga pavioni në pavion, na shpjegoi me aq zgjuarsi e pasion, sa dhe buza sikur iu përcëllua nga të folurit. Kjo fjalë “përcëllim” apo “përvëlim” na u kujtua aty për aty, nga që Lefteri tha për Rilindasit një shprehje frazeologjike: “Rilindasit e deshën aq shumë Shqipërinë, sa punuan, shkruan, luftuan dhe folën aq shumë për Shqipërinë, “sa edhe peshku mund t'u piquej në buzë”.

Kaluan vite por ato fjalë herë pas here më kujtoheshin, se më dukeshin sikur më qernë ngulitur si gozhdë në ndërgjegjen dhe ato sikur fshehur e në mënyrë të mistershme si udhëtim rinor nëpër Shqipëri na kishin shtuar edhe më shumë dashurinë për Atdheun, por që ne sipas Çajupit, i themi edhe “Mëmëdhe”.

Nuk kaloi shumë, veçse një dhjetë vjeçar, që do të bëhesha edhe unë banor i qytetit të gurtë, Gjirokastrës, për t'u kalitur si revolucionar, fillimisht i rekomanduar për tre vjet, por se sa do të zgjatej, nuk dihej.

Dhe ashtu ndodhi vërtet. Nga tre vjet, zgjati për plot pesëmbëdhjetë vjet në jug të mëmëdheut. Të transferohesh nga Tirana, ku sapo e kisha filluar karrierën e gazetarit të ri, plot ëndrra, e të transferohesh në Gjirokastrë, e të stacionohesh në krye të Lazaratit, në grykën e malit të Sopotit, duke stërvitur dymbëdhjetë ushtarë, pa pasur asnjë ditë shkollë ushtarake, nuk është gjë e paktë.

Dhe me një valixhe të madhe, me plaçka dhe dorëshkrime, duke marrë rrugën për Gjirokastrë, duke lënë pas familjen, me djalin një vit, një copë shtëpi që kisha gjashtë muaj që e kisha marrë me sa e sa peripeci, duke udhëtuar gjithë ditën, sa me tren, dhe me autobuz, në ato rrugë që s'i harrojmë kurrë për vështirësitë dhe peripecitë, njeriu kërkon një ngushëllim për të lehtësuar sado pak brengën që e bren.

Dhe unë përpiquesha t'i gjeja një ngushëllim vetvetes: “Vërtet po shkon në Gjirokastrë, por atje do të gjej atë drejtorin e muzeve dhe do të kem çfarë të mësoj. Po do të gjej edhe atë librarin e veçantë që s'të linte të dilje nga libraria, pa të të futur me dashje apo pa dashje edhe një libër në xhep.

Më vonë, mësova që ai librari që s'e kishte shokun, e thërrisnin “Alizoti”.

Kur vajta në Gjirokastrë, atje mësova se kur vinin nga fshatrat e kërkonin ndonjë

LEFTERI DHE GURËT E SOKAKËVE I BËRI TË TREGONIN HISTORI

Nga Mehmet Gëzhilli

libër për bujqësinë, ai u shiste “Fijet e barit” të Uitmanit për libër bujqësor dhe siç i thonë fjalës, “e hanin sapunin për djathë”.

Por të ndalerm pak më gjatë për t'u përqendruar te Lefteri. Sa mbaroja stërvitjen apo shërbimet njëzetë e katër orëshe në krye të Lazaratit, frymën e mbaja o në Muze te Lefteri, o te Kafe “Çajupi”, për ta pirë përherë kafën me të. Dhe kështu u bëmë miq të përhershëm. Dhe historitë e pasioni i tij për historinë, kulturën, muzeumet, për t'i kthyer edhe gurët e sokakëve që të flisnin, nuk kishin kufi. Më kujtohet se në muzeun e shkollës “Liria”, atje ku ngrihet Obelisku i Arsimit për Gjirokastrën, në një pllakë guri të zakonshme kishte gdhendur vargje të Koto Hoxhit, të cilat i kishte shkruar në burgun e Turqisë, ku me sa mbaj mend, këtu e vite të shkuara, kishte shkruar fjalët:

Ju, o djem, do më kujtoni
Se do bëhet Shqipëria,
Por ç'e do, se unë s'do shoh
Se u sosën ditët e mija...

Dhe këto vargje i kishte parë të gdhendura në murin e qelisë mësuesja e ardhshme e shkollave shqipe, Sevasti Qiriazit, e cila, e maskuar si djalë, i krijoi vetes mundësinë të vizitonte Koto Hoxhin në qelitë e tmerrshme të burgjeve të Turqisë.

Lefteri projektoi, krijoi, e mbushi Gjirokastrën me muze. Kalaja, Muzeu i Armëve, Muzeu i Luftës Nacionalçlirimtare, Muzeu Etnografik, Muzeu i Mërgimit në Goranxi, muze historikë në sa e sa fshatra, Muze Historik në shtëpinë e vëllezërve Topulli, Bajo dhe Çerçiz, Heronj të Popullit. Dhe mbi të gjitha, ngritur nga themelet, zbulimi, pastrimi dhe rindërtimi i Kompleksit Arsimit, ishte një nga veprat më suverprizuete, e zbuluar, e frymëzuar dhe ndërtuar nga mendja dhe duart e Lefterit.

Por Lefteri ishte dhe një autor librash. Shumë vite, që më 1943 botoi “Ligjëron


Fan Noli”, botoi monografitë për Avni Rustemin, ku me njohjen e gjerë që kishte me personalitetet, bëri të mundur të sillte në Shqipëri dokumentet e procesit gjyqësor të Avni Rustemit nga Franca. Ai zbuloi, nëpërmjet Nexhip Alpanit nga Stambolli, autobiografinë e Ismail Qemalit, për të cilin shkroi edhe një libër. Shkroi studime për Idriz Gurin, për “Drita çan errësirën” dhe çdo ngjarje që kishte ndodhur dhe përkujtohej, Lefteri do ta shoqëronte me broshura, me fletë-palosje, ose me shkrime në gazetën e qytetit “Pararoja” ku Lefteri kishte rubrikën e përhershme “Ditari gjirokastrit” dhe “Gjirokastra në shekuj”. Këto dy vepra tepër madhore, të derdhura në qindra faqe, është një pasuri e madhe historike dhe kulturore që mjerisht kanë mbetur të shpërndara nëpër gazeta, në revista e arkiva, dhe s'kanë parë dritën e botimit në libra të plota.

Vetë shtëpia e Lefterit ishte një arkivë e muze, e pasuruar me pasion, por edhe jo pa stres e stërmundim. Dhe ajo shtëpi që duhej ruajtur me polici e me zjarrfikës te dera, një natë të kobshme u përvëlua. Se si e qysh u përvëlua, mbeti mister dhe enigmë! Por atje u përvëlua një histori e tërë.

Mbas kësaj tragjedie mora vesh se Lefteri qe shtruar në një spital në Tiranë. Vrapova për ta parë. Sa hyra në derë, e mbyti ngashërimi. Lotët nuk i binin pika-pika, por, siç thotë populli, i binin çurk nëpër faqet e zbehta.

Nuk kaloi kohë me brengën që s'ia shëronte kush, shkoi të pushonte, pas një pune, sa pasionante e të gëzueshme, me një dhimbje farmak, për çfarë i ndodhi.

Do thënë se ca zyrtarë të koshës, të qytetit, nuk u sollën mirë me Lefterin, në prag të pensionit, kur ai deshi të punonte me muzeumet sa të kishte frymqën gjallë. Po kështu, kur vdiq Lefteri, kishin kaluar më se tre muaj dhe shtypi i kohës nuk kishte thënë dy fjalë për të.



I miri njeri, poeti dhe vlerësuesi i çdo pune të mirë, Dritëro Agolli, më dërgon redaktorin e gazetës “Drita”, novelistin e shquar Vito Koçi, që më thotë: “Me porosi të Dritëro Agollit do të bësh një shkrim për Lefter Dilon”. Atëhere isha transferuar pas pesëmbëdhjetë vjet “kalitje revolucionare”, në Tiranë.

Shkrimi u botua në gazetën “Drita”. Kolegët e mi gjirokastritë, me të cilët kisha mbaruar fakultetin, më thanë jo për falenderim, që: “atë që s'e bëmë ne gjirokastritët, e bëre ti, korçari, për Lefterin”.

Dhe unë me dashamirësi iu ktheva përgjigje: “S'ka rëndësi kush e bëri, rëndësi ka që e kujtuam Lefterin, këtë njeri, të kompletuar me shumë virtyte, por që mbeti e do mbetet emblema e muzeologjisë shqiptare”.

Po tani ndalemi pak te “Kandili i Kuq” i Faik Konicës. Faik Konica që më 1910 kishte deklaruar që do të botonte “Kandilin e kuq”, por se çdo të përfshinte në të, nuk e dimë.

Prof. Jup Kastrati, që ka botuar monografinë e jetës së tij, e deklaroi këtë dhe mendon se Faiku do të botonte shkrimet e publikuara deri atëherë në “Albania” dhe në “Dielli”. Se sa e vërtetë është kjo, nuk e dimë, për sa nuk e thotë Faiku vetë. Por dimë me saktësi se Lefteri mbledhi shkrimet e Faikut, i daktilografoi një pjesë, një pjesë të madhe i ka kopjuar me dorë, dhe më 1939, me gjalljen e tij, ia dërgoi librin Faikut në SHBA. Faiku ia ktheu përgjigjen, me përgëzimet më të veçanta. Filloi lufta. Më 1942 Faiku vdiq. Dhimbjen për mikun e tij Lefteri e zbuti duke e përfunduar librin e Faikut dhe e bëri gati për shtyp. ai sapo kishte botuar librin “Ligjëron Fan Noli”.

Mbas lufte filloi anatemimi për Faikun, “i poshtër”, “tradhëtar”, “ka bërë këtë e ka bërë atë”, dhe kush guxonte të botonte gjësendi për Faikun, s'merrte veç se të shara e kritika.

Shtëpia e Lefterit u dogj dhe nga gjithë ajo pasuri, se si shpëtoi nuk e dimë, se si u ruajt, por shpëtoi i vetmi dorëshkrim, “Kandili i kuq” i Faik Konicës, dorëshkrim, natyrisht, i dëmtuar rëndë.

Pas shumë vitesh, djali i Lefterit, Llambi Dilo na i besoi si miqtë e tij, që ky dorëshkrim të botohet.

Dhe ne i kushtuam tërë kujdesin e duhur, dhe vende-vende duke e deshifruar edhe me lupë, mundëm ta përgatitim, dhe ashtu si libri i Faikut i shpëtoi zjarrit, mundi t'i shpëtojë edhe harrimit.

Viti që po hyjmë, në 110-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë dhe 80-vjetorin e ndarjes nga jeta të Faikut, këtë vepër dhe vepra të tjera të Faikut do t'i botojmë duke shpallur vitin 2022, si vit i Faik Konicës, Fan Nolit, Ndre Mjedës, Asdrenit, Nonda Bulkës, viti i përvjetorëve të mëdhenj.

Për sa i përket Lefterit, do të mjaftonin fjalët: “E ndjejmë si detyrë falenderimin e veçantë për Llambin, djalin e përkushtuar për të atin, që ky dorëshkrim të përjetësohej dhe duke botuar këtë vepër të veçantë, krevia ndoshta një detyrim, sado të vogël për Lefterin dhe për Gjirokastrën, në të cilën shijova bukën e saj, shova etjen me ujin e saj, thitha ajrin e pastër të Sopotit, mora njerëzinë dhe fisnikërinë gjirokastrite.

Me këtë rast, dua të kujtoj të tjerët dhe vetveten, vepra e Faik Konicës, por edhe e Leftëer Dilos duhet të botohet tërësisht e plotë, e saktë dhe sa më bukur.

Atëhere do të jemi të qetë dhe s'do të justifikohemi me ngushëllime.

Mbarësi e botime në vitin 2022, për këtë vend të etur për dije dhe kulturë.”

Në fund po lë edhe një thënie të kryetarit të Akademisë Rumune lënë në librin e përshtypjeve të Muzeut shumë vite më parë:.

“Lefter Dilo meriton një statujë me mbishkrimin: “Mbret i pakurorëzuar i muzeologjisë ballkanike”.

Tiranë, 20 dhjetor 2021

AVE DASHURIA SI MISION DHE QYTETËRIM NË POEZINË E SARË GJERGJIT

Nga Alisa Velaj



*“Asnjëherë s’gabojnë të vërtetën thonë
fjalët/ Prej tyre s’ka më mashtrim/[...] Ajo dhe buzët e saj besëlidhëse/ Gjithë
të fshehtat gjithë buzëqeshjet/ Dhe çfarë
petkash zemërgjerësie/Për ta përfytyruar
krejt lakuriq.”*

Këto vargje të poetit frëng Pol Elyar do të më vërtiteshin pambarim në kokë, ndërsa humbësia e përhumësia në strukturat e universit poetik të vëllimit “Ave Aelia”.^{*} Po çfarë shenjon vallë ky titull aspak i zakonitë në një lexim të parë? Po t’u referohemi historisë dhe mitologjisë, hasim në emrin AeliaKapitolina, ku Aelia rrjedh prej emrit të perandorit romak Adrian (Aelius), ndërkohë që Kapitolina do të thoshte se qyteti i ri i ndërtuar prej këtij perandori i kushtohej JupiterKapitolinusit. Jupiteri (zot i qiejve, bubullimave dhe mbreti i zotave) ishte hyjnia kryesor për romakët, para se krishterimi të bëhej fe mbizotëruese në këtë perandori. Adriani i kushtoi Jupiterit një tempull që u ndërtua mbi rrënojat e tempullit të vjetër hebre kur pushtoi Jeruzalemin. Ky i fundit do të njihej me emrin e vjetër Aelia deri në përhapjen e krishterimit atje.

Aelia pra është trajta femërore e emrit mashkullor Aelius. Pa Aeliusin nuk do të kish lindur Aelia, sikurse Eva nuk do të kishte lindur dot, nëse Zoti nuk do të kish krijuar më parë prej pluhurit Adamin. Vëllimi “AveAelia” vendos në qendër të tij zanafillën biblike të krijimit të njeriut për ta shndërruar atë përmes përpunimit poetik në zanafillën e lindjes së dashurisë. Poeti Sarë Gjergji përshkruan me një mjeshtëri të rrallë përmasën erotike të jetësnjerëzore, duke i ngritur dashurisë një nga himnet më të bukura të poezisë shqipe. Për të,Adami mbetet i njëjti përmes rrjedhës së kohërave, ndërsa secila femër mbart patjetër nga pak Evëbrenda saj. Zbulimi i botës femërore dhe mashkullore në Librin e Zanafillës apo mëkati biblik i përjetimit të epshit (këtu nën gjykimin hyjnor), rimerret prej poetit si mëkati më i bukur dhe ëmbëlak. Miti biblik përdoret kështu thjesht si strukturë formale,ndërsa brendia e tij transformohet me një bukuri poetike të pashoqe, duke e

parë erodin në përmasën e tij fizike, psikologjike dhekozmiqe.

*“Palmuç, me gurin flas
N’vallëzim me erën
përtejquiejve të kokës sime
nën vetulla më varet muzgu.”*

Erosi është trandja dhe përmbytja e burrit, qielli nën të cilin frymon qenia e tij. Dashuria, si alfa dhe omega e jetës njerëzore, përcakton strukturat e jetës dhe botës. Çdo mashkulli i duhet një Evë për t’u vetëshpallur perandor i dashurisë. Femra (erosi) shndërrohet kështu në domosdoshmërinë absolute të ekzistencës sëdashkullit. Ashtu si Aeliusi (emri mendohet se rrjedh nga Helios - Diell) ngre një tempull kushtuar perëndisë Jupiter dhe e quan Aelia qytetin e pushtuar mbi të cilin ngre tempullin, ashtu çdo Adam ka për zotërim të tijin një Evë, mbi qenien e së cilës ka ngritur tempullin e dashurisë. Shën Eva, Shën Aelia, apo Shën Diellza e Adamit shumëfishohet në një mijë, dhjetë mijë, njëqind mijë, një milion eva, aelia apo diellza të tjera, për aq mijë apo milionë adamë që jetojnë qyteteve të botës.Shën Diellza apo Shën Dashuria është për mashkullin domosdoshmëri dhe zotërim, luftë dhe paqe. Gjergji zbërthen psikologjinë e botës mashkullore me një kthjelltësi dhe qartësi solomonike. Në vargjet e tij endet erërimi dhe etja erotike e Këngës së Këngëve, zjarrmia e shpirtave dhe trupave që shkrihen nga pasioni kopshteve të dashurisë marrafrymëse.

*“Aromë frutash
si një frymë hyjnore
ndjehet në Eden
ekockat e mia shenjtërisht m’i ndez
ti që mban e thyen boshtin e universit”.*

Në një tjetër kontekst, thujse të mezidukshëm edhe për një lexues model, ndryhen frikërat e nëndheshme të një shqetësimi thellësisht tokësor. Subjekti poetik (perandori Adam) druhet se mund ta humbasë diku dikur perandorinë e tij, Ave-Evën. Në fund të fundit të gjitha perandoritë zhduken një ditë. Aelia është harruar me kohërat. Po a nuk është kaq e dhimbshme të humbasësh atë që e ke ndërtuar si shtëpinë tënde, si zotërimin tënd?!

*“Eva lindi në kopsht/ Shtëpi e Adamit
u bë...”*

Ky vëllim poetik mund të lexohet dhe si një reminishencë biblike e rrugëtimit të qenies njerëzore, apo nostalgjisë edenike që fillojmë ta ndiejmë në shpirtat tanë, sa herë ndiejmë pikëllimin për këtë botë përherë e më pak të përsosur ku jetojmë.

*“Në dheun e Nodit
Adami ndien
se shpirtit frymën trupi ia zë.”*

Shembja e një dashurie rimerret sërisht përmes alegorisë biblike, ku rebelimi i së dashurës, ose përmbytja e Shën Adamit vjen para lexuesit si tronditja e themeleve të një qytetërimi. Ajo, mëkatarja e pakohë, Eva rebelohet

kundër mashkullit dhe vetvetes njëherësh. Ajo, brinja e brinjës humbet madhështinë, duke braktisur tragjikisht vetveten dhe atdheun e saj qiellor! Mashkulli i mohuar prej dashurisë nuk e braktis kurrë diellin e tij nostalgjik, duke i shëmbëllyer një perandori të hutuar, në gërmadhat e qytetit që e pushtoi me pasion pushtuesi, për ta humbur një ditë krejt papandehur. Duket si një mallkim i dyfishtë. Ajo braktis Adamin, kur dhe vetë ai ka braktisur me parë të njëjtin atdhe me të sajën. Në qeniet dashurore qenkemi përherë kështu, me një papërmbushje të pambarimtë, për sa kohë besuam në një besëlidhje të përkohshme, tokësore, dhe i kthym shpinën besëlidhjes hyjnore. Ndaj shpirtat e dashuruar do të ndiqen përherë nga një hije shpagimi dhe gjendje paplotnie.

“Eva, shpalljen kundër qiellit shkruan: Adami vdiq
Ky, në shpirt e ruan: diell...”.

Atëherë duke kaluar në një sferë filozofike shtrojmë pyetjen: Përse do të na vlente braktisja e një besëlidhjeje të vjetër, nëse një besëlidhje e re, jo vetëm që nuk do të na bënte më të lumtur, por do të na shpinte drejt mpakjes së lirisë? Vetëm kur dashuria të vijë si mision i çdo kohe në ikje dhe në ardhje, e tashmja e evave dhe adamëve do të endet si mall zemre dhe frymë dashurie në ujërat mes tokës dhe qiellit.



^{*} Pol Elyar, shkëputur nga poezia “E kaltër toka si portokalle”, vëllimi poetik “E kaltër toka”, Përkthyer nga Ilia Lëngu, Vëllëzërit Tafa, Tiranë, 2004, f. 31.
^{**} Sarë Gjergji, “Ave Aelia”, Adonis, Durrës, 2018.

Interesimi i Anton Nikë Berishës për albanologun austriak Maximilan Lambretz kishte evoluar, bashkë me ngritjen dhe formimin e tij profesional. Kështu, fillimisht, ai duke qenë një studiues i letërsisë gojore në kuadër të Institutit Albanologjik të Prishtinës, i kishte përqëndruar kërkimet në veprimtarinë e Lambretzit pikërisht në fushën e kësaj letërsie, konkretisht në studimet e tij mbi epikën dhe përrallën tonë gojore.

“MAXIMILAN LAMBERTZI PËR LETËRSINË SHQIPE”, botuar nga ITSHKSH në Shkup, është një vepër kapitale e Anton N. Berishës që e lidhë një traditë studimi të albanologjisë evropaine dhe, sidomos, të albanologëve gjermanë e austriak, me lexuesin shqiptar, i cili shumë pak ka qenë i njoftuar mbi kontributin e këtyre albanologëve. Kjo vepër është një përpjekje serioze, jo vetëm për ta ndriçuar një veprimtari pak të njohur të Maximilian Lambretzit, por edhe për të vendosur një standard valorizimi në interpretimin e teksteve të autorëve të huaj mbi letërsinë dhe kulturën shqiptare.

Nga hulumtimet e prof. Berishës rezultojnë që Lambretzi kishte dhënë një ndihmesë të madhe, përpjesërisht në mbledhjen dhe në studimin e thesarit tonë gojor, edhe në prezantimin e specifikave etnopskologjike e kulturologjike të shqiptarëve para një audience më të gjerë evropiane. Përmes studimeve të tij, dhe sidomos hulumtimeve të epikës sonë gojore dhe përrallës, Lambretzi kishte arritur që ta “skanojë” karakterin shpirtëror e psikologjik të shqiptarëve përmes një “rentgeni” të vendosur dikund në malet e Shqipërisë.

Duke e ndarë në katër pjesë librin e tij, Anton Nikë Berisha ka bërë një organizim të menduar mire të lëndës me material të bollshëm nga puna shkencore e Lambretzit.

Në secilën prej këtyre pjesëve, duke filluar nga pjesa e parë ku Lambretzi paraqitet si njëri ndër albanologët më të shquar, pastaj pjesa e dytë në të cilën jepet kontributi i Lambretzit për letërsinë e shkruar shqipe, për ta rrumbulkaksuar profilin e tij shkencor në pjesën e tretë dhe të katërt me angazhimet dhe pasionet shkencore që Lambretzi kishte treguar ndaj letërsisë gojore shqipe si dhe ndaj librave gjuhësorë-mësimor, pa anashkaluar edhe kontributin e tij si përkthyes letrar, sidomos nga shqipja në gjermanisht, ku një vend qëndror zë sidomos përkthimi në gjermanisht i “Lahutës së Malcis”.

Një arkitekturë e tillë librare është ndërtuar me zellin e hulumtuesit që kishte marrë për bazë, përpos veprimtarisë së Lambretzit, edhe një mori burimesh bibliografike që i kushtoheshin këtij albanologu të shquar. Kjo mbase i ka mundësuar Berishës të jepë në mënyrë të detajuar gjithë tipologjinë dhe kronologjinë e veprimtarisë së Maximilian Lambretzit, i cili për herë të parë kishte ra në kontakt me gjuhën shqipe gjatë një udhëtimi në Itali dhe në Greqi, teksa kishte përgjuar bisedat e peshkatarëve të Atikës dhe të Thivisit.

I impresionuar nga ajo që kishte mbledhur në terren, Lambretzi në vitin 1917 kishte botuar në revistën “Posta e Shqypnisë” të Shkodrës disa tekste autoriale mbi epikën dhe mbi poezinë gojore shqipe. Kurse, po në të njëjtin vit, një qasje më serioze e tij mbi këtë poezi në formë të studimit me titull “Poezia popullore e shqiptarëve”, ishte botuar në Sarajevë.

“Doracaku dhe libri i leximit të gjuhës shqipe” (Lehr - und Lesebuch des Albanischen (Vjenë 1913) është libri i parë i Lambretzit në fushën e albanologjisë, të cilin e shkroi në bashkëautorësi me Gjergj Pekmezin.

Kurreshtja për gjuhën shqipe tek Lambretzi sa vinte e po shtohet, dhe për ta shuar këtë kurreshtje në vitet 1913/14 ai kishte udhëtuar në Italinë e jugut për

“MAXIMILAN LAMBERTZI PËR LETËRSINË SHQIPE”, VEPËR KAPITALE E ANTON N. BERISHËS

Nga Emin Azemi

të mësuar diçka më tepër mbi të folmet arbëreshe, por edhe për ta përdorur arbërishten si urë kalimi në interpretimin e mëpastajm të veprave të autorëve tjerë shqiptarë. Kështu edhe ndodhi. Dy vite më vonë, më 1916, me qëllim të hulumtimeve gjuhësore dhe folklorike udhëtoi për herë të parë në Shqipëri si anëtar i Komisionit për Ballkanin të Akademisë austriake të shkencave.

Përveç këtyre të dhënave, pas një hulumtimi disaveçar, autori na jep edhe një mori informacionesh me komentime përcjellëse, që lidhen me veprimtarinë e Maximilan Lambretzit. Ky i fundit në vitin 1922 kishte botuar dy vepra: “Përralla shqiptare dhe tekste të tjera të folklorit shqiptar” dhe “Midis Drinit dhe Vjosës. Përralla nga Shqipëria”, ku në fokus të interesimit të tij janë poezia gojore, posaçërisht epika gojore dhe veçantitë e saj.

Maximilian Lambretzi, duke dashur ta shuaj kurreshtjen e tij mbi thesarin e pazbuluar të trashëgimisë gojore shqiptare, e kishte shfrytëzuar rastin që bashkë me trupat austro-hungareze të zbarkojë në Shqipëri në vitin 1916. Ai vendoset në Shkodër dhe për herë të parë njihet për së afërmi me aristokracinë kulturore të këtij qyteti, përfshi edhe Gjergj Fishtën, me të cilin bashkëpunoi në redaksinë e gazetës Posta e Shqypnisë, tek e cila i botoi disa tekste autoriale.


Gjatë qëndrimit në Shkodër, Lambretzi u angazhua edhe në mbikqyrjen e shkollave në zonën austro-hungareze, kurse ishte edhe anëtar i Komisionit Letrar Shqipe, i ngarkuar nga autoritetet austro-hungareze për vendosjen e një norme letrare të gjuhës shqipe.

Njohja me Fishtën dhe me autorët tjerë të traditës shkrimore të rrethit letrar të Shkodrës - V.Prenushi, Sh. Gjeqovi, N.Nikaj, H.Mosi. N. Mjeda - i dhuroi Lambretzit shansin e rrallë që të bëjë sprovat e para të interpretimit të disa prej veprave kulmore të kësaj tradite, ku një vend të rëndësishëm zinte “Lahuta e Malcisë” e Gjergj Fishtës. Prandaj, falë Lambretzit, Fishta u bë i

njohur për lexuesin gjermanofon, përmes studimit “Gjergj Fishta dhe epi heroik shqiptar Lahuta e Malcis”. Një hyrje në botën e legendave shqiptarë”, botuar në vitin 1949 dhe sidomos përmes përkthimit të plotë në gjermanisht të “Lahutës së Malcis” në vitin 1958, e cila përcillej me një parathënie dhe me shënime sqaruese dedikuar lexuesit gjermanofon i cili për herë të parë po njihet më nga afër me një teatër të lashtë epik, ku vijat karakterologjike të shqiptarëve paraqiteshin me dorën mjeshtrore të një “filigranisti” homerik, siç ishte Gjergj Fishta, i cili po e hapte perden e madhe të traditës kulturore shqiptare para një opinioni të kultivuar evropian. Madje A. N. Berisha me të drejtë ka përzgjedhur një mendim të Karl Gurakuqit që i afrohet shumë lësaj të vërtetë: “Shërbimet qi i ka sjellë kombit shqiptar (Lambertz-i – v. A.N.B) janë të mëdhaja, por ma i madhi asht, pa tjetër, përkthimi i “Lahutës”, qi na qet faqen e bardhë përpara botës së kulturime”.

Në anën tjetër, libri “MAXIMILAN LAMBERTZI PËR LETËRSINË SHQIPE” na jep të kuptojmë se lexuesi shqiptar përmes këtij albanologu përvetësoi një kulturë të re receptimi të letërsisë sonë, sidomos të asaj pjese që vështirë komunikonte me hapësirën kulturore shqiptare, për shkak të gjuhës arkaike, siç ishte, bie fjala “Gjella e Shën Mëris Virgjër” e Jul Varibobës, pjesë të së cilës i kishte përkthyer edhe në gjermanisht. Mbi këtë vepër, siç mësojmë nga ky libër që kemi në duar, Lambretzi kishte shkruar një studim në vitin 1956, të cilin e quan “një kurorë prej baladash dhe poezish lirike”. Për ta argumentuar këtë konstatim, autori citon Lambretzin teksa shprehet se “vepra, më e mirë kurora e këngëve, është hartuar në dialektin e vendlindjes së poetit, për nga forma dhe përmbajtja e arrirë, plot hijeshi dhe poezi. Humori dhe tiparet e botës regjionale i bëjnë poezitë e Varibobës pa dyshim thesare më të çmueshme të letërsisë së shkruar italo-shqiptare”.

Praktika të ngjashme të përvetësimit të traditës gojore në letërsinë e shkruar, kanë qenë prezente edhe në përvojën e



shkrimtarëve të ndryshëm botëror. Njëri nga ta, Italo Kalvino, i cili arkitekturën e narracionit letrar e mbindërtonte duke përdorur kallximin popullor si brum letrar të cilin e integron në strukturën fabulare të tij. Ai madje e kishte pranuar hapur se “La novella nun e bella se sopra nun ci si rappel” (“Tregimi nuk është i bukur nëse nuk mbindërtohet”), duke i dhënë hapësirë kësaj tematike në Leksionet amerikane: “Nëse në një moment të caktuar të aktivitetit tim letrar kam qenë i pasionuar pas tregimeve popullore, kjo nuk buronte nga besimi në ndonjë përkatësi etnike (duke marr parasysh edhe faktin se rrënjët e mia ishin në një Itali moderne e kosmopolite), por për shkak të interesit tim struktural e stilistik për ekonominë, ritmin dhe ligjikën thelbësore me të cilën këto tregime janë rrëfyer”. 1)

Në studimin e tij, edhe Anton Nikë Berisha ka shkoqitur përkushtimin e Lambretzit mbi lidhjet e ngushta të epikës gojore shqiptare me llojet e tjera të krijimtarisë letrare gojore shqipe, të cilat i bëri objekt trajtimi edhe afitë e saj me përrallat shqipe, të cilat, siç do të shprehej Klod Bremon, mund të shërbenin edhe si “atome narrative”2) të letërsisë së shkruar.

Lidhjet e epikës gojore shqipe me epikën e shkruar, ndonëse “në procesin e gjatë të bashkëjetesës dhe të bashkëepimit kufijtë e ndikimeve nuk mund të përcaktohen në mënyrë të prerë...sepse letërsia që bartet gojë më gojë ka zanafillën më të hershme, është krijuar dhe ka jetuar më parë se letërsia e shkruar”. 3), Lambretzi i gjen më së miri te “Lahuta e Malcis” e Gjergj Fishtës, dhe kjo ka ndodhur, sipas profesor Berishës, edhe për të dëshmuar ekzistimin e Homerit si poet dhe krijues i epeve të famshme antike “Iliadës” dhe “Odi-sesë”, duke sjellë të dhëna për përkime të thella e të gjithan-shme të epikës gojore shqiptare dhe të “Lahutës së Malcisë”. Pikërisht nga ky studim i profesor Berishës rigjejmë tezën e njohur, të cilën e kishte mbështetur edhe Lambretzi se Homeri i kishte shkruar dy kryepet duke pasur për bazë poezinë gojore dhe “falë gjeniut të tij ai arriti t’i ngritë ato në atë nivel dhe t’u japë atë formë, e cila na ka arritur dhe si e tillë na është e njohur”.

Interesimet më thelbësore të Maximilian Lambretzit për autorët shqiptarë, duke huazuar në veprat e tyre thesarin e letërsisë gojore si një “farë” letrare, mbase, mund të vërehen pikërisht në qasjen që ai kishte ndaj veprës së Fishtës dhe Varibobës. Këtë interesim të Lambretzit, autori Berisha e sqaron në këtë mënyrë: “Edhe punimet e Lambretzit për veprat “Gjella e Shën Mërisë Virgjër” të Varibobës dhe “Lahuta e Malcis” të Fishtës përligjin lidhshmërinë e madhe të letërsisë sonë gojore me letërsinë tonë të shkruar, përkatësisht të përkimeve poetike dhe të afrive midis tyre. Pra, vetëm vështrimi në tërësi i mendimit të Lambretzit për letërsinë tonë mundësoi ndriçimin dhe njohjen e mirëfilltë të ndihmesës së tij në këtë fushëveprimtari”.

Përveç që afirmoi kulturën e shkrimit shqip dhe thesarin tonë popullor në hapësirën gjuhësore gjermanofone,



Lambretzi, siç na e thotë autori Anton Nikë Berisha, do të mbetet në kujtesën e studiuesve dhe vëzhguesve të rrjedhave teorike-letrare edhe me studimin e njohur “Lindja dhe zhvillimi i letërisë shqiptare”, në të cilin për herë të parë analizohen disa specifika dhe dukuri të qarqeve letrare të letërsisë shqipe, por njëherësh për herë të parë në mënyrë të detajuar merren në shqyrtim nga një studiues shqiptar, siç e kemi rastin me autorin e këtij libri, cili teksa flet për prirjen e Lambretzit për të depërtuar në specifikat e shtrirjes hapësnore të letërisë shqipe e kishte bërë këtë ndarje në gjashtë treva: treva italoshqiptare, letrarët e Shkodrës, shkrimtarët dhe poetët e Shqipërisë së Mesme (nga Tirana dhe Elbasani), treva toske, treva e Korçës dhe letrarët e diasporës, përfshi shkrimtarët me kombësi shqiptare në Bukuresht, Sofje, Konstandinopol, Egjipt dhe Amerikë”.

Lambretzi kur iu rrek të shkoqis gjeografinë letrare shqiptare, nuk mjaftohej vetëm me sqarimet e mësiërme, andaj, siç na e zbulon profesor Berisha, ai shkon më tej me zbërthimin e kësaj teme: “Nga qarqet letrare të formuara janë së pari qarku i Shqipërisë së Veriut me Shkodrën si qendër, së dyti arbëreshët e Kalabrisë dhe Siçilisë me qendrat Spezzano Albanese, San Demetrio Corone, Palermo (Piana dei Greci), së treti qarku i Shqipërisë së Mesme ose qarku gegë jugor me qendrat së pari Elbasanin e pastaj Tiranën, së katërti qarku i Shqipërisë së Jugut me qendrat Korçën (Voskopojën), Gjirokastrën dhe Frashërin dhe së fundit i pesti emigracioni ose letrarët në Stamboll, në Bukuresht, në Sofje, në Vjenë, në Kajro e Aleksandri, në Boston të SHBA-ve”. Me këtë rast profesor Berisha kishte vërejtur se kësaj radhe Lambertzi përmend pesë qarqe e jo gjashtë si në Hyrjen e vëllimit “Zwischen Drin und Vojusa” dhe kjo kishte ndodhur pasi që në qarkun e Shqipërisë së Jugut përfshin edhe krijuesit nga Korça, të cilët më 1922 i kategorizonte grup me vete.

Para se të merrej me studimin e letërsisë shqipe, asaj gojore dhe të shkruar, Maximilian Lambertz, siç provohet edhe në këtë libër të A. N. Berishës, sigurisht kishte nuhajtje mbi atë se çka do të mund ta intrigonte atë më së tepërmi dhe kjo iu mundësua në momentin kur ra në ontakt me këtë letëris, nga e cila nuk u shkëput deri në fund të jetës së tij. Depërtimi i tij në thellësitë magjike të tonalitetit poetik të letërisë shqipe, bazohej në studimin e karakterit etno-pskologjik të traditës së pasur popullore prej nga vinte e pashterrshme gurra e letërisë gojore, e cila luajti edhe rolin e një palimsesti për letërsinë e shkruar.

Pas analizës që i bën studimit “Poezia popullore e shqiptarëve. Një studim hyrës” (Volks poesie der Albaner. Eine einführende Studie), të Lambertzit, profesor Berisha vë në pah meritat e këtij studuesi për të identifikuar rëndësinë e komunikimit të artit të fjalës në formën gojore përballë atij të shkruar. Nga ky studim kuptojmë diçka më tepër edhe mbi statusin e poetit popullor, të cilët nuk janë të parët, që kanë hartuar poezi, kurse “veprat e veta poetike nuk i bënë nga asgjëja, por qindra vjet para tyre ishte tek populli i tyre në të gjitha kohët një radhë e madhe dhe e aftë e krijuesve popullorë, si burra ashtu edhe gra, që ndjen nevojën t’i shprehin ndjenjat dhe fantazinë e tyre në formë të artit dhe se poezia gojore nuk i paraprin vetëm krijimtarisë poetike të shkruar të një popullit, si një burim i pa shtjerrë dhe i pandalshëm, por ajo është gjithashtu, në masën më të madhe, pasqyrë e cilësive shpirtërore”.

Shembuj të shumtë nga letërsia botërore na e konfirmojnë këtë qëndrim të Lambertzit mbi lidhshmërinë e letërisë gojore me atë të shkruar, dhe kjo më së miri është shfaqur edhe në krijimtarinë e Dantes, siç e ka vërejtur edhe studiuesi

Sidnei Finkelshtajn.

“Danteja duke e shkruar ‘Komedinë Hyjnore’ në gjuhën italiane “vulgare” në një kohë që dijetarët vazhdonin të shkruanin akoma latinisht, shënon kthimin e artistëve nga populli për të gjetur lëndën tyre të parë. Bokaçioja e shkroi “Dekameronin” duke përdorur gjuhën dhe historitë e popullit, krijoi një formë me anë të së cilës zbulonte një tablo të jetës së qytetarëve italianë.”⁴⁾

Lidhshmëria e Lambertzi me letërsinë gojore shqipe nuk ishte thjeshtë çështje kureshtjeje sipërfaqësore e një të huaji që për herë të parë po e vizitonte një vend të panjohur. Kjo lidhshmëri burimin e kishte te pasioni i fuqishëm i Lambertzit për të nxjerrë në pah vlerat e panjohura të një tradite mijëravjeçare që ishte ruajtur me xhelozi nga goja në gojë dhe nga kënga në këngë.

Kjo mbase është edhe merita e këtij studimi mbi këtë albanolog gjermanofon, i cili kishte edhe një arsye tjetër të fortë që e spjegonte thelbin e përkushtimit ndaj letërsisë gojore shqipe, duke përfshi edhe këngët kreshnike. Për ta ilustruar më së miri këtë përkushtim, profesor Berisha sjell para lexuesit një pasazh shumë domethënës nga fundi i studimi të Lambertzit “Poezia popullore e shqiptarëve”, që ishte botuar më 1917: “Sot për sot po e jap fjalën e shpresës, që nëse edhe një herë bota do ta fitojë lirinë, nga qenësia e popullit shqiptar, ku ruhen aq thesare të lashta e të bukura në këngë dhe në përralla, në gojëdhëna e besime popullore, shkenca do të nxjerrë po ashtu njohuri të çmueshme edhe mbi doke e zakone të popujve të tjerë indogjermanë”.

Nëse i referohemi vet titullit të këtij libri

“Maximilan Lambertzi për letërsinë shqipe” nuk e kemi vështirë të vërejmë interesimin dhe fokusimin e autorit Anton N. Berisha në shpalimin e detajeve të panjohura nga veprimtaria e gjerë e Maximilina Lambertzit, sidomos mbi interesimin e këtij albanologu austriak ndaj problematikave të veçanta të letërsisë shqipe. Prandaj edhe këtu konsiston ky hulumtim shterrues i profesor Berishës, i cili përpos kronologjisë, sjell edhe tiopologjinë e studimeve të Lambertzit mbi letërisë shqipe. Lexuesi shqiptar për herë të parë do të njohet me profilin shkencor të një albanologu të huaj, veprimtaria e të cili ishte ngusht e lidhur me ndriçimin e specifikave dialektore të gjuhës shipe si dhe me nuancat zhvillimore të letërisë shqipe, siç mund të shihet edhe në punimin e tij: Albanische mundarten in Italien (Dialektet shqiptare në Itali – Indogermanisches Jahrbuch II, Jhg. 1914 – 1915), ku përmend dhe letërsinë e arbëreshëve të Italisë dhe disa nga përfaqësuesit më emblematic të saj.

Për të shterruar kureshtjnie e lexuesit, autori ka sjellur edhe një mori materialesh që lidhen drejtpërdrejt me punën studimore të Lambertzit, e që kishin në fokus letërsinë shqipe. Në këtë kontekst ai përmend Raportin e vitit 1916, paraqitur pranë Akademisë mbretërore të shkencave të Vjenës (Anzeiger 53, Jhg. 1916), në të cilin Lambertzi jep disa të dhëna pak më të plota për këtë letërsi (sidomos f. 129 – 130 dhe 134 – 136). Në këtë material për herë të parë vëhet në dukje një konstatim që kishte të bënte me vlerat e letërsisë së arbëreshëve të Italisë, sipas të cilit letërsia e mirëfilltë e shkruar shqipe së pari lindi te arbëreshët e Italisë, por duke shtuar mozaikun e vlerave edhe në dy krahë tjetër të letërisë shqipe, në

Jug të Shqipërisë, ku në çerekun e fundit të shek. 19-të kishte lindur një letërsi e shkruar me përfaqësuesit gjenialë, Naim be Frashërin dhe Asdrenin, kurse në Veri të Shqipërisë, sipas Lambertzit, po zhvillohej një letërsi me autorë që kishin individualitete të theksuara, ndër të cilët ai përmend: Gj. Fishtë, Sh. Gjeçovin, A. Xanonin, H. Mosin, L. Gurakuqin, A. Harapin etj.

Si përfundim mund të thuhet se albanologjia shqiptare dhe ajo e huaj, tash e tutje kanë rastin të studiohen në një rrafsh komparativ, falë hulumtimit monografik gjithpërfshirës që vjen përmes këtij libri tepër të veçantë të studiuesit tonë të shquar Anton Nikë Berisha.

Vlerën e këtij libri e shtojnë tri komponenta thelbësore që ndërliiden drejtpërdrejt me fuqinë receptuese të tij dhe me kredon krijuese e shkencore të vet autorit:

E para, libri i profesor Berishës është i hapur në pikëpmaje të ideve që shtrohen për arsye se autori ka përzgjedhur metodologjinë e krahasimit dhe selektimit të materialit arkivor të albanalogut Maximilan Lambertz, duke iu dhënë mundësi edhe studiuesve të tjerë që të plotësojnë pikëpamjet dhe vështrimet e tyre kritike mbi punën voluminoze të këtij albanologu austriak.

E dya, autori ka përdorur burime e referenca të shumta dhe kjo ia shton kësaj vepre vlerën e dokumentimit të dëshmisë, një komponentë kjo mjaft e qenësishme e rezistimit të fakteve ndaj erozionit të mosvëmednjes dhe harresës.

E treta, në literaturën tonë shkencore-albanologjike kjo monografi jo vetëm që plotëson një boshllëk në fondin botues kushtuar albanologëve të huaj, por ajo mund të merret edhe si model i kombinimit të dijes, përvojës dhe përkushtimit hulumtues të autorit, i cili formatin e tij prej studiuesi të veçant po e mbindërton me këtë vepër kapitale kushtuar njërit prej korifenjve të albanologjisë gjermane – Maximilian Lambertzit.

Libri “MAXIMILAN LAMBERTZI PËR LETËRSINË SHQIPE” bën pjesë në atë grup veprash, rëndësia e të cilëve shkon duke u shtuar bashkë me ngritjen e kulturës së receptimit në një shkallë më të lartë, për t’u bërë, kështu, pjesë e formimit dhe zhvillimit të një kulture më të avancuar të vlerësimit të autorëve dhe veprave, pasi që, siç e thotë edhe Manfred Nauman: “Vepra të caktuara me veçantitë e tyre përmbajtësore e nxisin lexuesin që të jenë në kontakt të vazhdueshëm me to, ndërkohë që ka vepra të tjera, mbase më shumë, të cilat lexuesi pas një kohe të caktuar i braktis si objekt receptimi.”⁵⁾

Libri që kemi në dorë, me të cilin tash e tutje do të jemi në “kontakt të vazhdueshëm”, funksionin e vet komunikues dhe receptues do ta zhvillojë, krahas rëndësisë që përmban në vete, edhe kërkësisë së studiuesve për ta pasur si pikënisje pikërisht një hulumtim që e hap dhe e kanalizon debatin shkencor mbi trendet e albanologjisë së mijëvjeçarit të ri dhe kontributin kolosal të albanologëve të huaj në këtë drejtim, ku një vend qendror zë, pa dyshim, albanologu austriak Maximilan Lambertzi.

- 1) Italo Kalvino, “Americka predavanja”, Novi Sad, 1989, fq. 43
- 2) Klod Levi-Stros, “Morfologjia bajke”, Prosveta, Beograd, 1982, fq.78
- 3) Anton Berisha, “Mundësi interpretimi”, Rilindja, Prishtinë, 1979, fq. 131/132)
- 4) Sidnei Finkelshtajn, “Studime kritike”, botoi “Naim Frashëri”, Tiranë, 1982, fq. 344
- 5) Manfred Nauman, “Teorija recepције u nauci o književnosti”, NOLIT, Beograd, 1978, fq. 146

(Autori është udhëheqës i Departamnetit të Letërsisë në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup)



KUJTESË

Dielli, ky mashtrues i madh,
gënjen të gjitha nudot e botës;
asnjë yll s'ka kuptim,
asnjë konstelacion
nuk i përgjigjet kaosit të fatit.
Eremiti i fundit
shënon Luftën e Tretë Botërore
në një të grisur fustani mbi rërë,
mbi të cilin, një pështymë Zoti
qulloso lulen e basmës...
Kujtesë...
dy duar fëmije shenjojnë nájri
dy pelegrinë pa kokë...

GRUA

Kalvarë të mundimit, ndalini devetë sonte
pranë zjarrit blu të një pylli të egër;
martohen magmë fisesh të egra,
filistini i fundit është, pa dyshim, një femër
mos e lini pa emër... quajeni Faltore...

Mbi të kridhen si pilivesa mbi zjarr
tundimet e Orfeve;
fisi i saj e dënon me heshtje,
të ngopurit bëjnë të paditurin
por Ajo rrëngeth tërfilin;
poshtë hapit të saj,
larvat kthehen në palma.

Mos e lini pa emër... quajeni Faltore
Grunaja e flokëve të saj
ngop korbin e etur;
vjen me shandanë në dorë
lëkurërat e saj, verbojnë instiklin...

Mos e lini pa emër... quajeni Faltore

Zoti i saj masturbohet mbi një kasketë
naziste,
në fund të së cilës, në një kokrrizë dheu,
mbijnë dy fije bari...

PËR SA KOHË...

Etiopia shtrin fushnaja me grurë;
bëjnë mbi të kuleçë me gjak
duar fëmijësh...
Kleopatra heq vëthin.. mban zi.
Oh, Teutë, përdridhe fijen e florinjte;
një Zot pa emër bëhet synet,
në emër të tij një korb si nata vret...
Pellgje të mëdha gjaku,
pellgje të mëdha
.....
Kaoset do vijnë, për sa kohë
në vend të egos nuk mbillet një pemë
afër farit....

FAT...

Qyqja u kthye;
varret zgjasin kokat
duke përbuzur karamelet;
furka e një plake
tjerr idhninë e kobshme...
Qyqja u kthye:
një vëlla në emër të fatit
zbut kaoset me lulka bliri...

NË VENDIN TIM

Në vendin tim flenë bashkë
egërsirat me midhjet,
kurorat e pishave puthin yjëzimin poshtë
farit;

PËR SA KOHË...

Poezi nga Shqiponja Axhami

mbi tërfil dëfrehet miza e kalit.
Përanash një pazari të gjatë
shitet mjaltë dhe helm minjsh.
Ne jemi pellazgë të vjetër
me këngë dhe saze në buzë;
por këndojmë himne në vend të
serenatave,
kalërojmë egon mbi religjione ballkanase
-

të dehur nga një ngrohtësi e parakohshme;
përkedhelim dimrat në ikje.
Ndezen në të zjarre pasionesh,
urrejtjesh:
një lagunë e e pa fund,
mes së cilës, si një grua e përdalë
endet gjysëm e dehur demokracia.
Poshtë këmbëve të zhveshura të së cilës,
rrokulliset si një mollë e papjekur
Populli im ...

Oh, pemë...

JEHONË E PIKËLLIMIT

Shko, tingull i trishtimit,
shko e vdis
në lukthin e kësaj nate pa agim.
Këto i shkruaj unë,
një Medea e krisur,
një e huaj në atdheun tim.

Por ndjemëni, kuptomëni,
ose ndryshe -
unë vdes çdo ditë nga pak.

Tymi i një udhe..
përdridhet nëpër gjymtyrët e Zotit.
Shën Elisabetë, fal disa bukë
nesër në lagjen 5 të qytetit:
martohen një cigan,
Shën Elisabetë.
Më pas, zbuloje prehërin,
thuaju bashkëqytetarvë të mi,
se të zgjohesh heret, është qëllim,
jo mburrje.
Kurtizanes që s'do tia dijë
dhe pi verë me burrat e huaj,
shkërmogja mbi prehër
kallirin e misrit
të hanë mbi të

të gjithë gushëkuqët e botës, ta bindin
se jo çdo joshje është mëvetësi.

Dashuria mbetet, gjithësesi, frut i pasosjes.

toka është mizore;
nëse e miklon me djerrinë,
bëhet mallkuese;
detari e ka padyshim ditën e tij:
le të jetë e pabindur rrjeta,
le të ketë javë pa asnjë peshk.
Të paepurit nuk dinë të gënjejnë,
ata vetëm kërkojnë...
Shën Elisabetë, shshshsht...
Jehonë e pikëllimit
më verbon me temjanin e mariuanës;
popullin tim e burgosin për këtë,
por populli im është i varfër,
unë edhe më e varfër.
atëherë si zgjidhet dilema e varfërsisë?
Populli im ka kohë që jeton si deve pa
këmbë.
Unë jam në të si një pikës ujë,
por ai s'ka etje, ka uri..
Eci mbi të dhe ndjej poshtë këmbëve
të lëvrjnë si fushnjaja orizi epokat e
ngopura.
Bëhem, dëshpërimisht, pak e nga pak
kafshëz e vogël, bulkth
që jetoj në varrezë...

Shën Elisabetë...
Tani më ndje, ose më fajëso,
ose... lute më mirë Zotin tënd
të më shndërrojë në viç....

EPISOD

Në brazdën e pluhurt
rendin milingonat
ndoshta nesër
do fillojë një shi...
turma e fshatarëve
psherëtin. Shalqiri
ky Izreal shpëtimitar
nuk u shit sivjet.

Orgjitë
përziejnë temjanin e mariuanës
me sherebelë;
fshatarët kthehen të pikëlluar
si pas fundit të një gjyqi
grykatësi i të cilit është
një Xha Kondë me penis:
vrazhdësi dhe lavdi
nën tehun e monedhës.
Qeramika e vazove të luleve
është e pamundur të bëjë bukë;
lulkat mondane mbeten në ikje,
në gjurmët e të cilave
penelata e një piktori skizofren
pikturon vaginën e munguar.

Anemitë e një gruaje
shuajnë shikimin
në këmbanën e rrugës
“Komuna e Parisit”;
është e kremtja e radhës ,
ajo do mungojë,
siç mungon në çdo gosti;
Zot i saj është prej muri,
një Zot i heshtur
që s'i dha kurrë ajër
nga frika se do e

mundëte,
se do çiftohej me çifutin e fundit
mbetur ne Kaukaz:
ai çifuti me sy jeshilë
që të kujton lëndinat,
fushat me grurë
dhe rëndësine e mëvetësisë ...

Oh, delir i fëmijrisë
i shfaqet me gjunjët e gjakosur
poshtë fustanit
prej basme Berati
në gravurën e gurtë
duke lozur lojë luftash,
rregullat e së cilës
ia mësoi reshti i bunkerëve
në të cilët kukulla prej kalliri misri
u mbyt në jashtëqitje
teksa buza e saj prej trëndafili
përsëriste refrenin e poezisë
për Faraonin.

Oxhaku i Uzinës hesht
si një kasap i dënuar me sklerozë;
bloza e tij firmos data vdekjesh
nëpër gurët një mali të ashpër:
vdiq, vdiq dhe ima atë;
kanceri i mushkërive,
e përhubura anemike pikëllohet,
thërret devenë e saj të butë
që i sjell harresën.

Në brazdën e pluhurt
rendin milngonat me sy njeriu
poshtë shtrojës
së lëkurës së qengjit ...
anemitë e një gruaje
nxjerrin gojëzat
duke lëpirë amshueshëm
sytë e nje vdekje solide.
Jetesa e saj do jetë
një muze i bukur,
i vështirë për tu gjetur,
si eshtrat e një shenjti
që dezertoj besimin

KREMTJA E NJË DIKTATURE

Bien kambanat:
është e kremtja e një diktature.
Mbi papafingo një fëmijë indiferent
qëron krahë shelgjesh,
ndërton një krrabë...
duhet trembur epërsia e zogjve të egër.

Bien kambanat...
Zërat e burgosur përhapen
si sherebelë në një plazmë prej ajri;
kohë e pajetuar rrëshqet udhëve të
pluhurta
si këmba e plagosur e një dreri...

Karuseli prej bime shtyn drejt mbrëmjes
heshtje pleqsh,
kuisje qensh....

Bien këmbanat
...në një rrëkezë loti mblidhen
pemë,
fshatra të braktisur,
të vdekurit, lumenjtë
duke përhapur brenda vetes
polenin e një faljeje.

Bie kambana;
është e kremtja e një diktature,
por jo: diktaturat s'kanë të kremte,
kanë vetëm gjëmime.
O zëra të burgosur,
mbusheni kraharorin
me timbrin e një lutjeje:
mbi krizantemën e një pranvere
duhet të mbijë çdo epokë;
nga një lule, mbi çdo kasketë naziste,
ose ndryshe, çdo natë do vdes nga një poet
dhe çdo ditë, një urë do të bëhet rrënojë



Shkrimtari matematicien Lewis Carroll (Luis Kërel), siç e ka vënë re me mprehtësi Sartri, në veprën e vet “ Liza në botën e çudirave “, një vepër sa për fëmijë aq për të rritur, “bën një përpjekje për të aplikuar në mënyrë sistematike këtë fuqi të pakushtëzuar që zotëron matematicieni për të krijuar një botë fantastike duke u nisur nga disa rregulla.” (ZH. P. Sartr, Neveria, Tiranë 1994).

Ngjashëm me të, poetesha Mimoza Pulaj, dikur mësuese matematike, në vëllimin e saj të fundit krijon një botë ku fantasia e guximshme konkurren me saktësinë matematike.

Matematika ngjan sikur është antiteza e poezisë.

Megjithatë bota poetike e vëllimit të Mimosës duket sikur u bindet disa rregullave të sakta që u ngajnë ligjeve mbi të cilat mbështetet kozmosi.

Kjo s'është e rastit, meqenëse është fjala për një poezi që i vë vetes detyrën e guximshme për të fluturuar deri në kozmos dhe për të zbuluar planete të rinj dhe hëna të reja që përmenden me emrin e tyre.

Mos është fjala për një poezi shkencore, një poezi ilustrim të shkencës?

Po jo! Atëherë do të ishte një poezi e ftohtë didaktike, një jo – poezi.

Naimi ynë u përpoq dikur ta krijonte një poezi të tillë për fëmijët në vjershat e destinuara për nxënësit. Po poezia për fëmijë e pranon disi elementin didaktik që në poezinë për të rritur mund të ngajë si virus dhe madje edhe aty ky element paraqet shume rreze.

Në këtë vëllim është fjala për një poezi moderne, madje moderniste, një poezi mendimi, një poezi hermetike midis modernizmit dhe pasmodernizmit. Dhe krahas mendimit, aty ekziston edhe ndjenja, po e tretur thellë si kripa në fund të detit.

“Hënat” e reja, planetët e rinj janë shndërruar në simbole si trupat kozmikë të lashtë, si hëna e vjetër që frymëzon një varg të tërë poetësh nga drejtime të ndryshme.

Më tepër se shkencore, poezia e Mimosës është filozofike, po filozofia nuk qendron aty si trup i huaj, është shndërruar në poezi.

Mimoza nënë, Mimoza bashkëshorte e përkushtuar, Mimoza emigrante, me zemrën e ndarë në dysh, është shndërruar në një Mimosë astronome, filozofe që sheh larg në gjithësi. Një metamorfozë e re dhe e papritur, si ajo e krimbit në flutur.

Po ngjyrat e reja të botës poetike të heroinës lirike a janë aq larg nga ngjyrat e vjetra?

Si gjithë poetët e vërtetë Mimoza është koherente me vetveten.

Heroina lirike e vëllimit të fundit ka edhe tipare që e lidhin me heroinën lirike të vëllimeve “ Djalit larg” dhe “ Puthmë fort “.

Krahas dashurisë ajo dallohet nga mendimi me anë të të cilit synon të ngjitet në kozmos. Po nuk e harron, mikrokozmosin që fsheh brenda vetes . Dhe as diellin e vogël që quhet zemër dhe e ngroh nga brenda dhe e shndërron në vatër që lëshon rreze. Mendimi është i ftohtë pa dashurinë. Dashuria pa mendim është e verbër.

Pra, Mimoza nuk harron të dojë bashkëshortin, prindërit, bijtë, vëllezërit e motrat e gjakut, vëllezërit e motrat të një kombi, vëllezërit e motrat në të gjithë planetin.

Edhe vëllezërit e motrat të planetëve të tjerë, nëse ekzistojnë.

Ajo është e brishtë si qenie njerëzore,

Mendime për vëllimin “ Gracka qiellore “ të Mimoza Pulajt

Poezia hermetike e Mimoza Pulajt në metamorfozën e saj të re

Nga Jolanda Cmeta

po dashuria që e djeg përbrenda është e pafund.

Poezitë e vëllimit të saj përshkohen nga fjalët çelësa DRITE dhe DASHURI. Është fjala si për dritën kozmike ashtu dhe për dritën shpirtërore simbolike.

Heroina lirike – poetesha – e zbërthen këtë dritë në ngjyra, në një larmi ngjyrash që i ndezin poezitë sepse poezia e Mimosës në thelb më tepër një poezi vizive ku ndërthuren e kuqja, e trëndafila, e blerta, e kaltërta, e arta, e argjenta, e hirta, madje edhe dy ngjyrat e skajshme antitetike, e bardha dhe e zeza. Janë ngjyra polivalente që shprehin kuptime të ndryshme.

Pranë gjuhës se ngjyrave, ndeshim edhe gjuhën e shifrave, atë të numrave imagjinarë me absurditetin e tyre, të ekuacioneve që kërkojnë të zbërthehen.

Pranë kësaj gjuhe të fundit vjen edhe një gjuhë tjetër, gjuha e muzikës, një

muzikë me ritëm të çuditshëm që i ngjan muzikës rock.

Të gjitha këto shkruhen në gjuhën e poezisë. Poezia e Mimosës është e pasur me një figuracion të larmishëm me metafora, krahasime, epitete, antiteza, madje me figurat e rralla të sinestezisë dhe oksimorit që shkrijnë perceptimet shqisore dhe që bashkojnë të kundërtat.

Pra, poezia e kesaj autoreje është një poezi figurash. Po nuk mungojnë as detajet konkrete, ndonëse më të rralla dhe prandaj më tepër befasuese; këpucët, byreku me djathë, fotot, sirenat, binarët, semaforët.

Leksiku i poezisë së Mimosës është i pasur: shkon nga leksiku poetik tepër fin te leksiku i përditshmëm, i zakonshëm i gjuhës bisedore, për t'u ngritur mandej në lartësitë abstrakte të matematikës, të fizikës, të astrofizikës.

Në poezinë e saj, në ndonjë moment Mimoza na kujton mitet e vjetra të Kalit të Trojës dhe endjeve të Odiseut. Për t'i çmitizuar vallë apo për të zbuluar tek to rrënjët tona?

Janë simbole të cilave nuk u ka humbur kuptimi. Gjithashtu heroina lirike - poetesha - na zbulon dukuri të reja, vëllezërit dhe motrat kozmike të Tokës, Diellit dhe Hënës për t'i parë ata si pjesë të energjisë jetësore që na përftoi dhe na mban në jetë. Mimoza nuk i vë emër kësaj energjie: Perëndi? Natyrë? Po ajo beson në një dashuri gjithënjëzore që mund t'i bashkojë njerëzit e këtij planeti, duke i fshirë kufijtë që i ndajnë (“Dritë skllave”, “Jetës”; Zëri im” , “ Det dallëndyshesh”).

Këtu ajo tregohet tepër e gjerë dhe largpamëse, tepër aktuale në kuptimin më të lartë të fjalës.

A është poezia e Mimosës një poezi që ka në bazë të vet elementin e lashtë kozmogomik zjarr?

Në të vërtetë heroina lirike është një rebele, “një dele e zezë”, siç e quan ajo veten (‘ Dele e zezë’) që ”kalëron në qiell” simbolikisht dhe afirmon kështu të drejtën e vet për liri dhe identitet në fillim në një vend ku dikur diktatura synonte të asgjësonte personalitetin e njeriut dhe më vonë anarkia synon ta largojë atë nga vlerat më fisnike dhe mandej në vendin pritës të asfiksuar nga konsumizmi.

Ky zjarr rebelimi e përshkon poezinë e Mimosës, siç pohon heroina lirike në vjershën “ Lëndë dashurie” ku e përcakton veten si “frymë e zbehtë. Në flakë. E lindur” po që megjithatë “një botë ndërtoi me lëndë dashurie”.


Po kjo poezi ka dhe fluiditetin e ujit, e detit që bashkon atdheun e saj të origjinës dhe vendin që e ka pritur, e oqeanit që bashkon kontinentet. Nga ky fluiditet jete dhe dashurie kanë buruar vargjet e vjershës “ Zëri im”: “ Oh si mundet atë muzikë që ke brenda të ta ndërpresë një pemë, një kufi?” dhe vargjet e mrekullueshme të vjershës “ Det dallëndyshesh” : Agimi zhduk natën/ Kënga e dallëndysheve/ të gjitha kufijtë”.

Poezia e Mimosës ka dhe lartësinë e ajrit. Ajo ngjitet ne kozmos, binjakëzohet me trupin qiellor Mimosë. (Beta Crucis) në vjershën “ Nëntë muaj”. Një guxim i paparë ky?! Guximi i një poeteje. Mrekullia e formimit të një fëmije a s'mund të konkurrojë me mrekullinë e formimit të një ylli? Një yll i kaltër ashtu si edhe planeti ynë është dritëkaltër më gjithësi.

Mimoza manovron si në vëllimet e tjera me drejtshkrimin, përdor fjalitë mungësore që shënojnë ndërprerjet e herëpashershme të frymës nga ankthi ose ekstaza, gërmat e mëdha të shtypit për të shënuar fjalët çelësa.

Kjo mënyrë përdorimi disi arbitrare e gramatikës nga ana e saj që të sjell ndërmend futuristët, s'është modë, s'është snobizëm, është funksionale. Frymëzimi poetik i saj, më tepër se sa t'u nënshtrohet rregullave ia nënshtrohet rregullat vetes.

Duhet thënë gjithashtu se ka çaste që errësira në poezinë e Mimosës, ndonëse është errësi thellësie, teprohet dhe lexuesi i thjeshtë mund të humbase rrugën në atë labirint fjalësh. Po kjo është një e metë e lidhur ngushtë me cilësitë, konçizitetin, thellësinë dhe poezia e Mimosës, e koncentruar, konçize, e sakte dhe fluide, e larmishme dhe e thellë, dallohet nga nderimi që ushqen autorja si për mesazhin që sjell, ashtu dhe për lexuesin. Ajo spikat kështu, duke qendruar larg nga ai inflacion fjalësh që dallon vargëzimin e sforcuar i cili është e kundërta e poezisë së njemendte.



SITA KUJTOJMË POETIN EVGENI JEVTUSHENKO?

...nuk ka Rusi të Putinit, por të Pushkinit, tha ai...

Nga VISAR ZHITI

Poeti sovjetiko-rus Evgeni Jevtushenko më 1 prill bën 5 vjet nga ikja nga kjo jetë, por këtë vit ai ka dhe 90 vjetorin e lindjes (18 korrik 1932).

Është poet i njohur dhe kompleks, poezia e tij është e lidhur dhe me Shqipërinë, ai ka ardhur në Shqipëri, ka poezi për Shqipërinë dhe gjatë kohës kur sundonte realizmi socialist, ai përflitej në qarqet letrare dhe nga lexuesi i poezisë si një mit i kuq, kritikohej dhe adhurohej fshehurazi, madje me ndikim në poezinë shqipe, pa patur asnjë libër të botuar tek ne, përveçse dy poezive të hershme të tij, të përkthyer nga Drago Siliqi, në një antologji të madhe të poezisë ruso-sovjetike, që do të ndalohej në po atë vit që doli, sepse u prishën marrëdhëniet politike dhe diplomatike midis Shqipërisë, vendit më të vogël të kampit socialist dhe Bashkimit Sovjetik, vendit më të madh, superfuqi botërore.

Edhe kjo ngjarje gjeti jehonë në poezinë e Jevtushenkos, shpotinë dhe goditjen, ndërsa në letrat shqipe do të ishte temë qendrore dhe e madhe, heroike, madje e të gjitha arteve.

Jevtushenko së pari do ta shihnim personazh në një nga romanet më të bukur të Kadaresë, "Muzgu i perëndive të stepës", estravagand dhe pa ideale, me një si simpati të fshehur për një shok shkolle në Institutin "Gorkij" të Moskës.

Pastaj u përhap me bujë dhe frikë se Jevtushenko kishte shkruar një poezi, "Trashëgimtarët e Stalinit", kundër Enver Hoxhës. Kërshëria për poezinë e tij u shtua rrezikshëm.

Ne, studentë në atë kohe, letrarët e rinj siç quheshin, poetë, etj, kërkonim të lexonim ndonjë të tij, qoftë një poezi a strofë a varg, që edhe gjendeshin në gazetatat dhe revistat letrare, ku ai shahet si poet revizionist, në shërbim të klikës së Kremlinit.

Dhe ne u rritëm dhe u formuam me kulturën e sharjes në letërsi. Kujtoj kur më arrestuan dhe në hetuesi netëve më ulërinin në qeli, i lidhur me pranga, që pse kisha lexuar librin "Molla" (Jablloko) të Jevtushenkos, që në fakt nuk e kisha gjetur dhe s'e kisha parë kurrë, por ca poezi të tij, në një revistë sovjetike, që na e kishte dhënë fshehurazi një e njohura jonë në Bibliotekën e Shkodrës. Në fakt i përktheva ashtu me fjalor, nga dëshira e madhe, ua dhashë shokëve dhe miqve të ngushtë, ashtu bënim, i jepnim njëri-tjetrit përkthime të fshehta, mbushnim fletoret. Nga të denoncuarit, unë u burgosa...

Edhe sot më vijnë ulërimat e hetuesit pas mesnate: pse e ke lexuar armikun Jevtushenko, ai ka shkruar poezi kundër Shqipërisë dhe Enver Hoxhës...

Do ia tregoja këtë fakt Jevtushenkos vetë, kur do ta takoja në Milano, në vitin 2008, se na pranuan antarë të PEN Clubit Italian në të njëjtën ditë. Ai u entuziazmuar që unë isha burgosur dhe për poezinë e tij, lajmëroi dhe të shoqen, që t'ia tregoja dhe asaj, shkëmbyem dhe libra me autograf dhe unë i tregova dhe poezinë që kisha bërë me mend i burgosur, që i kushtoj atij.

Dhe ai më dha dhe poezitë që kishte

shkruar për Shqipërinë, me trishtim dhe dashuri dhe poemën që kishte shkruar në vilën e kryeministrit shqiptar, Mehmet Shehut, të cilin e "vetëvranë". A të doli fantazma e tij? – e pyeta.

Në takimin në publik në Milano, kujtoj që një grua ngrihet nga salla n: e librarin; e "Mondadori" dhe i thotë Jevtushenkos:

- Na folë pak për Rusinë e Putinit.

Dhe ai shungëlloi:

- Zonjë, nuk ka Rusi të Putinit, por të Pushkinit... Rusia është e Dostojevskit, e Gogolit, e Pasternakut, e Esenininit, e Sollzhenicinit, e Mandelshtamit... e im... e shokëve të mij.

Jevtushenko ishte kundër, por jo kundërshtar, sipas studiuesve. Ndërkaq ai e ka ngritur zërin me poezinë e tij politike, që, pas rënies së komunizmit, Jevtushenko do ta quante "poezi e mbrojtjes së drejtave të njeriut". U bë e famshme poema e tij "Baby Yar", e shkruar në 1961, ku denonconte masakrën naziste të vitit 1941, e shoqëuar me antisemitizmin sovjetik, me persekutime nga bolshevikët ndaj hebrenjve në Babi Jar, në rretina të Kievit në Ukrainë.

Ç'do të thoshte sot Jevtushenko për luftën e çmendur në Ukrainë?

Ne kemi një tjetër poezi të tij "Pragën çaj në tanket" e vitit 1968, që del kundër pushtimit të Çekoslovakisë nga çizmja staliniste e ushtrive sovjetike në krye të forcave të Traktatit të Varshavës.

Edhe në 1989, kur Jelsini dërgoi tanket në Çeçeni, Jevtushenko e denoncoi dhe nuk pranoi një çmim prej tij.

1991 – viziton Shqipërinë, ndërkohë shoku i shkollës së tij, shkrimtari shqiptar me njohje botërore, Ismail Kadare, kishte kërkuar azil politik në Francë.

1993- Jevtushenko shkon në SHBA, në Universitetet në Oklahoma e Nju-Jork, jep leksione për poetët rusë dhe evropianë dhe historinë botërore të kinematografisë. Pranimi i tij në Akademinë Amerikane do të ngjallte polemika, poeti i pëz;en;e nga Bashkimi Sovjetik pas burgut të tij, Josip Brodskij do ta quante Jevtushenkon "Disident i emëruar".

Pas tetorit të vitit 2007 Jevtushenko e ndan jetën e tij mes dy vendeve, Rusisë dhe Shteteve të Bashkuara.

Në 1 prill 2017 ndërron jetë dhe trupin e tij e çojnë të prehet n;e am;eshim në Rusi

Mua m'u desh të shkruaj një libër të gjithë për dukurinë Jevtushenko, "Si na erdhi ai, i ndaluari" dhe shkak u bë një thënie e një studenti shqiptar, tim biri, Atjonit, që u njoh me Jevtushenkon në përrurimin e një libri të tij në Lugano, në Zvicër dhe mua më tha: "... ishte interesant, por dhe narcis... mos janë ca si egocentrikë ata që i ka përkëdhelur regjimi?" Gjithë kohës atje ai mbante për krahun Jevtushenkon që çalonte. Në fakt çalonte Realizmi socialist.

Ç't'i thosha? Me librin tim desha t'i tregoj atij dhe brezit më të ri se si u rritëm ne, me ç'poezi, ndërsa në fakt ai më shpjegoi mua shkurt se ç'ishte poeti i regjimit. Jemi para gjyqit të së ardhmes. Kurse unë dua të dëshmoj poezinë...



EVGENI JEVTUSHENKO 10 POEZI

DASHTË QIELLI

Dashtë Qielli u vjen pamja verbanëve e gungaçët shpinat drejtojnë.
Dashtë Qielli bëhemi ca Zot, pak fare, të jesh pak, pak s'të kryqëzojnë.

Dashtë Qielli të mos i ngjitemi pushtetit, heronjve të rremë jo dhe jo.
Të pasur të bëhemi, por jo të vjedhim, natyrisht nëse mundet kjo.

Dashtë Qielli të bëhemi dhelpra plakë, që s'bie në ato gracka me shkopinj, mos qofshim viktimat, as xhelatë, lypsa kurrë, as zotërinj.

Dashtë Qielli sa më pak plagosje në përleshjet që vetëm të çmëndin, sa më shumë vënde dhe përsosje, pa u dashur ta humbësh tëndin.

Dashtë Qielli që toka e pamatë gjurmët t'mos na i hajë gjithkund.
Dashtë Qielli të na duan gratë dhe kur të jemi në fund.

Dashtë Qielli të heshtin gënjeshtarët, zë hyu të ndiejmë në thirrjet e pafajshme, që Krishtin të dallojmë tek të gjallët në fytyrat e burrave dhe të grave.

Të mos mbartim si kryqin pabesitë dhe si mjeranë të biem përdhe, të mos jemi dyshues çdo ditë, dashtë Qielli qoftë Zoti në ne.

Dashtë Qielli të gjithën për të gjithë ta kemi sa më shpejt, pa u fyer prej saj.
Po, po, të gjithën, por veç zgjidh nga ato që s'të turpërojnë pastaj.

1990

BABI YAR

S'ka fare monument mbi Babi Yar,
As gur varri të ashpër në atë thepiseje.
I tmerruar sot,

sa i vjetër jam,
Sa e gjithë raca hebraike.
Si izrealit të lashtë

veten shoh
Në Egjiptin e lashtë endem, iki
Në kryq vdes me gozhdët në kockë,
Edhe sot jam me tortura shpirti.
Dhe Dreyfusi*

gjithashtu jam unë
Nga filistinët dënuar,
shitur,

pas hekurave jam
nën dhunë,
I pështyrë,

me gurë
goditur.
Dhe në Bruksel më kanë sharë,
Me çadrat hedhur, i çarë...

Tani jam
një djallë në Białystok**.
Gjak në dysHEME.

Gjaku rrjedh në stol.
Zotërit e barit dhe lokalit tok
Turfullojnë erë qepë dhe alkool.

Çizmet më shkelën... Fytyrën ma nxinë,
Në masakër t'u përgjerohem banditëve.
Me talljen:
"çifutë vrisni, shpëtoni Rusinë",
Sa keq ma rrahën nënën time!

O Populli im!

E madhja
Rusi!

Me internacionalen brenda trupit.
Duart shpesh ke zhytur në ligësi,
Nën emrin e pastër klithmat e turpfit.

Unë e di mirësinë e tokës time.

* Alfred Dreyfus, oficer francez, i shkarkuar padrejtësisht nga shërbimi në 1894 për shkak të akuzave të sajura dhe nxitur nga antisemitizmi

** Belostok: vendi i masakrave të para dhe më të dhunshmet. (Shënimt janë nxjerrë nga përkthimi anglisht)

Por poshtërsinë
nuk di ku ta fus,
Që antisemitët pa pike përgjegjesie
Fshihih në “Bashkimin e Popullit Rus”.

Shikomëni që jam
dhe Anna Franku
E tejdukshme
si degëz e brishtë në prill.
Dhe unë dua.
pa fraza tanku,
Sy më sy të shihemi
me ëndje dhe trill.

Kaq pak të shohim,
më dhemb ky shpirt,
Qiellin na ndaluan, na ndaluan
gjethet,..
Por prapë kemi mjaft,
ne njerëzisht
Përqafohemi në dhomën e errët.

“Mos u tremb!”
“Po ata erdhën!”
“Janë zërat e pranverës së hershme.
Më jep një puthje.”

“Po shqyejnë derën?”
“Shhhht. është akulli që po plasaritet.”
Bari i egër shushurin mbi Babi Yar.
Pemët shohin me frikë
sikur kalojnë gjyqtarë
Këtu heshtur mashtrohemi.

Kapelja në dorë
Flokët befas bëhen
të bardhë bore.
Bërtas dhe unë, pa tingull qaj
Për mijëra e mijëra

në gropë hedhur. .
Unë jam çdo plak,
i pushkatuar
në pllajë,

Unë jam
çdo fëmijë
këtu i djegur
S’ka fibra trupi im
ta harrojë këtë,
“Internacionalja”
të mos gjëmojë më kot,
Deri sa t’varrosët e t’mos dëgjohet më
Antisemiti i fundit
në këtë tokë.
S’ka gjak hebre të mos jetë gjaku im.
Urrej me shpirt të pashpirtët në jetë
Si një hebre çdo antisemiti.
Dhe kjo më bën
një rus të vërtetë.

SHQIPËRI, ÇDO TË BËJMË ME LIRINË E MADHE?

Shqipëri, çdo bëjmë me lirinë e madhe,
me këtë grua tradhtarë të ndërgjegjes?
Në qorrsokak të dytë,
me këngën fitimtare,
liria në paliri do na çojë drejt tërheqjes?

Në banja gjaku na argëtuan marrëzisht,
me kapitalizëm po na ndjellin të fortët.
Do ta gënjejnë Rusinë
dhe Shqipërinë sërisht
dhe sërisht do të rrjedhin të hidhur lotët?

1991

PËR KRIJIMTARINË (nga revista “Junost” 12/1959)

Nuk ka rëndësi
në ke ti studiues,
por ka rëndësi
në ke ti pasues.
Fjala jote e çdo të kushtonte,
nëse në të, me etjen e zgjimit,
nuk fshihet fara e së ardhmes –
mundësia e shenjtë e vazhdimit?!

Krijoi, artist, me guxim, digju
dhe fol!
Dhe do të shfaqet Fjala,

e thjeshtë dhe e madhe si mollë,
me fillimin e mollëve brënda.

SHQIPTARKA

Shqiptarkë që të magjeps me bukurinë,
katërmëdhjetë vjeçe, e zbathur.
The se të quajnë Aksinjë,
“Po Melehoi të është shfaqur?”
“Ende s’e kam, - psherëtime lehtë, -
s’e dua shpellar, e dua poet”.

E rrallë për kohën, s’gjen ngaherë
një vajzkë kështu, e tëra perrí,
që burrin të mos e dojë bankier,
plot me para, por me poezi.

Jeta vetë ecën dhe vonë a herët
do vijnë vajza me intelekt të fortë.
Ato s’do martohen kurrë me skllëvër,
Ato s’do marrin tiranë bashkëshortë.

Etje parash e egër do jetë tretur
tek ne, në Rusi, tek ju, në Shqipëri
dhe do ngadhnjejë në shekuj e shekuj
i shenjtí mall i madh për poezi.

Dhe poetët-gjeni do të shpërthejnë
mes bunkerësh pa shpirt, të ngrirë
si balle divash të rënë,
nëndhé rroposur, në errësirë,
për të mos u ngritur kurrë më.
Ja u ngritën! Skllëvër s’na bën asgjë.

MOS U ZHDUK

Mos u zhduk... duke u zhdukur nga mua,
e çmishëruar vetvetes iu zhduke.
Vetja kështu u tradhtua
me pandershmëri prostitute.

Mos u zhduk... të zhdukesh është lehtë.
Të ringjallesh për tjetrin s’ka se si.
Vdekja të tërheq shumë thellë,
të vdesësh nuk është urtësi.

Mos u zhduk... harro hijen e tretë.
S’ka të tretë. Dy janë dashurive.
Bashkë do shkojmë në gjyqin e shenjtë,
kur gjaku na thërret për përgjigje.

Mos u zhduk... e kemi shlyer mëkatin,
fajtorë s’jemi dhe as damkosur.
Të denjë jemi unë dhe ti të falim
në mosdashje ç’kemi plagosur.

Mos u zhduk... të zhdukesh është çast,
por si do takohesh ndër shekuj?
Ç’sozi kemi në botë, ti fantazmë
dhe unë? – veç fëmijve të qeshur.

Mos u zhduk... japma dorën tënde,
në të jam i shkruar, besoji sekretit!
Dashuria e fundit – sa e tmerrshme!
s’është dashuri, por frikë e humbjes së tjetrit.

MONOLOGU I NJERIUT TË PASNESËRM

As Eva, as Adami nuk ishin antarë partie,
njerëzimi e di, të lutem dhe ti dije.
Pa parti Noja me atë arkën e tij,
Globi shtyn errësirërat pa parti.

Por Djalli, me pikpamje djalliste,
shpiku partitë, - ç’gusto neveritëse!
Në zemër të mollës futi krimbin, -
krim(b)*** dhe gjarpër një ishin,-
politikën - profesion me prejardhje
djallëzore,
që krim(b)ëzon njerëz kohë pas kohe.

Politika shpiku policinë,
Politika shpiku kryetarët.
Njerëzit kishin ëndërruar bashkësinë,
jo partitë dhe nënndarjet.

Po ku është partia e vejushave, invalidëve,
pelegrinëve,
ku është partia e familjes, e fëmijëve?
Partia e syve të skuqur ku është vallë,
në hirin e Aushvicit, Songmit, Gulakut**** të
gjallë?

Por një ditë, një ditë, një ditë,
për stërnipërit tanë të gjitha partitë
do të kujtohen si një gjë e tejshkuar
si superkafshët, si Babilonia e rrënuar.

Bota pa të persekutuar e blasfemi do të jetë,
pa çalamanë moralë në pushtet,
e gjitha një e asnjë parti,
veç ajo me emrin e thjeshtë: njeri.

*Shkruar në 1972.
Botuar për herë parë në 1991*

MILINGONA AFGANE

Dergjet një djalë rus mbi tokën afgane.
Mbi fytyrë i endet një milingonë myslimane.

Prej ditësh vdekja s’e ka rruar. Ç’mundim
të ecësh...
Dhe i mërmërit milingona me zë të imët,
vdekës:

*** Lojë e përkthimit. Për këtë poezi janë marrë për bazë
dy variante të botimit të saj në Itali.
**** Aushvic – kamp nazist internimesh në Poloni,
Songmi – lokalitet në Vietnamin e Jugut, shkatërruar
nga amerikanët, Gulagu: Magadan - lokalitet siberian
i internimeve.

“Ti s’e di tamam se nga rende për ato plagë.
Vetëm di se diku, afër vendit Iran.

Nga u shfaqe ashtu kundër nesh me armë,
ti që së pari këtu dëgjove fjalën ‘islam’?

Atdheut tonë të zbathur halleplot,
ç’do t’i jepje ti apo rreshtin e kotë?

Njëzetë milionë të vdekur s’mjaftojnë ende
për të mbërritur në këtë gjëndje?”

Dergjet një djalë rus mbi tokën afgane.
Mbi fytyrë i endet një milingonë myslimane,

që do të donte të lutej ashtu ortodoksisht
të ngrihej djali, të bëhej me shpirt.

Në atdhe, në veri, me vejusha e jetima,
pak kanë mbetur milingona të tilla.

*Shkruar më 1983.
Botuar për herë të parë më1990*

MES FRIKËS DHE TURPIT

Hë pra, shqiponjë dykrenore,
për ku po fluturojmë mes reve,
drejt ç’lavidie të re poshtëruese
mbi torturën çeçene?

Nëpër frikë dhe turp, aty
mbi majat varg,
njëra tjetrën s’e shohin dot në sy
dy kokat e shqiponjës lart.

Pëndët ndërkaq kush t’i flakte
sipër pluhurit dhe shkrumbit?
Jo, nuk qe zgjedhje zhgabe
mes frikës dhe turpit.

23 dhjetor 1994

KËRKESA E FUNDIT

L. Evstratova

Shkëlqesive e atyre që s’janë shkëlqesë,
ç’gjëra t’u kërkoj? Ja, kështu pra,
s’kemi më nevojë për udhëheqës.
E kemi një, por në kryq, ah!

Dhe duke nxitur qeshjen e ndokujt,
ka plot që qeshjen e kanë harruar,
ende do t’i kërkoj gjithkujt:
që unë të mos jem i munguar.

Dhe lutem me zë të mekur,
i humbur mes gjithë të humburve,
trëmbem nëse kam për t’u tretur
si një rreze e vogël aurore
në ditën dritë-derdhur.


I kaplluar barërave shkëlqimisht,
gjithandej mërmëris me mall:
“Nuk do të vuaj sigurish,
kur nuk do të jem gjallë.”

Asgjë nuk kam që të bëj thirrje,
as piedestal, as i dekoruar,
por ja që ka dhe përjashtime:
që unë s’kam për të munguar.

Si aromë e fletores së vjetër të poezisë
me petalet e jaseminit të tharë.
Më e tmerrshmja e të gjithave – humbja e
bukurisë,
edhe për botën - llahtar!

Ç’mëkat vdekës të vdekurit të harrosh.
Vdekje, nëse në paqe njerëzit janë lëshuar,
lëri të gjithë të jetojnë e të shpjegosh
që unë s’do të kem të munguar.

Përktheu Visar Zhiti



Autografi i Evgeni Jevtushenkos, dhënë Visar Zhitit, ku
uron një të ardhme të madhe për Shqipërinë.

1
Në kozmosin, ku shpirti yt ndrit si yllësi,
Të plaçkisin,
Se qënkish një i verbër e dot s`i sheh,
Ndaj me mitet e tua ndodh rëndom, Hirësi,
Mitomanët të të lënë pa katandi e atdhe.

Pa sytë e tu qytetërimi, o Atë i Poezisë,
Një qiell pa yje e teleskop,
Varrezë fosilesh, skelet ushtari pa medaljon,
Nëse ke mbajtur në dorë një shkop,
Magjik ai mbeti për kohën tonë.

Një univers, falë teje, i praruar,
Nga Olimp i zotave tek një had hijnajash,
Me mister e pa nebulozë,
Çdo kod orakujve u zbërtheve
Sikurse kumte me ojna zogjësh.

Zgjohu Homer, të thotë sonambuli,
Po kështu dhe leshkot, vajmedet,
Faji i Çirçes që amfiteatrin
E ktheu në stallë,
Ndërkohë Qiklopi me syrin e vetëm
Tejkqyrse e Galileit nxjerr në ankand.

Zemërimin e Akilit muzat sjellin si kuisje macesh,
Kaceku i Euolit një airbeck,
Lidhur Odiseja në një tub stripcizmi,
Ndërsa Zeusi bubullin tek Shkëmbi i Kavajës,
Eunukët e zyrave turren të tredhin Prometeun
Dhe mëlçinë t`ia shesin për transplant
Mburrur me shqiponjën në vula dekretesh
Dhe me flatrat që s`i kanë.

Hall i madh, Homer, na ka zënë,
S`kam tjetër veç teje t`i them fjalë shpirti:
E zvogëlua njeriun dhe madhështinë e morën sendet.
Divat na u bën vipa,
Hyjnitë çingi,
Tempujt u kthyen në gazerma
Ku bronzin mediokrit me letra të falsifikuara
Ia hodhën vetes në pronësi.

Hardhucat sërisht përbindështa me luspa peshku,
Lakuriqët e natës hakera,
Oktapodi boss funeralesh,
Vampirët me armë të shfarrosjes në masë,
I kthyen shpikjet në kurthe kavjesh!

Troja ikën sysh nga bombat fosforishente
Ata të stalingradit u bënë hitlerianë,
Sikurse komunisti orthodox në antikomunist pagan,
Sikurse çifutët e krematoriumeve, të dhomave të gazit
Vrasin të pafajshëm në Gaz,
Në emër të Gazpromit apo rivalit TAP?

Fantazmë e komunizmit në ditë karnavalesh
Kërkohet më kot prej mumjeoidëve në sarkofagun e
Leninit,
Sikurse Hitleri në bunkerin e shkrumbuar pa hi Sfinksi,
Bota ka zjarlllëk nga “ngrohja globale”
Duke provokuar me mirazhe hrushoviane “akujsh të
shkrirë”
Shoqëruar me psallmet liturgjike të Gorbaçovit me “I
dashur armik”?!

Ka më shumë skifterë se zogj, Imzot,
Më shumë peshkaqenë nga delfinë,
Mikrobe, viruse e mikroçibë,
Në sallonet kozmetike e shëmtuara po ia rrëmben kurorën
bukurisë
Sikurse e vërteta injorohet me një fake news
Apo kurim imazhi me balsam kompanish.

Më shumë se sa luftëtarë sheh aventurierë,
Gjithkush turret të plaçkisë atdheun,
I kthyer në mall belik,
Ti ndjehesh i tradhëtuar,
I braktisur
Pa shokë e miq.

Në barkun e një kali të drunjte ushtarë me heshta
Nga barku i avionit lëshohen desantë helmetash,
Si kandil deti,
Hapsirat ajrore mbyllen me urdhër,
Ndërsa ti, o Kalors, endesh me Pegasin përqark,
Edhe pse satelitët, si cuba të qiellit,
Ta zënë udhën.

HOMER “I VERBËR”-NË KOHË VERBANËSH

Poemë nga Fatbardh Amursi (Rustemi)

(I kushtohet, Khales al-Assad, arkeolog i famshëm, i cili fshehu thesaret e antikitetit nga vandalët e ISISI-t. Ia gjymtuan trupin dhe e varën në një semafor. Gjetiu në një semafor: prostitutat presin klientët. Sirenat e alarmit në Ukrainë, ku, civilë të pambrojtur këmbëjnë Hadin me strehimet; zëri ndjellës i sirenave dhe Odiseja lidhur pas direktut, më çuan në motin e Homerit, si autor i parë, i cili përshkroi një luftë, si ajo e Trojës. Nëse Odiseja kthehet në Itakë, Enea endet nëpër botë në gjetje të atdheut të ri. Nuk mund të mos hiqja një paralele nga bota e miteve tek kjo e mitomanëve, ku verbanët në vend të grisin “perden e hekurt”, merren me kataraktin e poetëve. Alibia e “Homerit të verbër” e përhapur nga verbanët, na bind se jemi ende në kohërat e “Qorrfermanit”, sikurse shkruan dhe “Qorri”: nofka, që verbanët i vunë shkrimtarit Kadare, si e si të barabisnin me Anastas Lulon, i cili njihej me pseudonimin “Qorri”. Duket se po jetojmë një botë me shëmbëlltyra, ku fytyra të merret me kollajllëk prej profileve të rreme, të cilët shfaqen me një identitet të vjedhur.)

Je i pari që përshkrove një luftë titanësh,
Ku mizori Akil përlotet mbi trupin e Hektorit
I hequr më parë zvarr,
Një luftë për rrëmbimin e një gruaje,
Kur pengmarrja është kthyer sot në art komercial

Dhe Patrokli flaku rrobat e heroit
E të zë pritë me kapuç të zi,
Vë maskën “rrezik vdekje” prej djalli.
Duhet të fshehësh fytyrën tënde
Më parë se t`i marrësh tjetrit skalpin.

Në Olimp pihej nektarë, Babazot,
Limonadat e gazuara po na e shpifin,
Hormone, farë e keqe, selikon, pesticide, lajka,
Ndotësit e botës
Rendin në ditën e “ujit të bekuar”
Të lajnë gjynahet mbetur në trupin tonë si vraga.

Me Laokoontin mbytur prej gjarprinjëve
Desident i parë,
Tallen fahirë e fallxhorë,
Kompanitë e ilaçeve me melhelm deheroizmi
Gjarpërin na e kthyen në simbol?!

Shampanjë fitoresh derdhet lum
Aty ku fitorja merret në tavolinë,
Druri del mode
Tallashi i presuar merr përparësi, o mik,
Ndërkohë Barka e Nojes ankorohet
Në shtratin bosh të një reaktori atomik.

Poetë selfie
Fustanin e Afroditës në vello Medeje kthyer,
Vetëm për dashurinë thurni vargje duke mos dhënë
dashuri,
Suksesi i tjetrit ua helmon shpirtin farmak,
Strehë demonësh si guvë lakuriqësh
Dhe flisni ju për engjëjt me shejtanin në bark!

Një like në facebook
Kjo nyje pisk lidhur gogël
E merrni për syth,
A hajmali,
Ndërkaq kiset mbushin trupin
Dhe mikrobi kërcënon me pandemi?!

Ju kamikazë të fjalës së lirë,
Çdo ushqim t`u japësh e ktheni në helm,
Me inate personale tentoni të ndizni zemërimin popullor,
Si e si të lëndojnë Shqipërinë
Të të bëjnë korte, ty, Kosovë?!

Perdja e syve s`të pengoi të shohësh gjithçka, Homer,
Perdja e hekurt po bie sërisht midis Lindjes dhe
Perëndimit,
Ra Muri i Berlinit, por jo Muri Kinez,
Një deus ex machina e kthyer në anije kozmike,
Ku pritet të zbresin alienë.

2
Apokrifi na u bë spekulant,
Plagjiaturisti trafikant me doktoraturë,
“Tregu i lirë” ra në “treg të zi” së prapthi,
Ajo që iku u pandeh se s`kthehej kurrë.

Supermarketeve po u zbehet shkëlqimi
“Mishi i bardhë” tregtohet, si dikur një negër.
I ngritëm himne njeriut të lirë
Po nga na dolën kaq shumë sklevër?!

E bardha ndërron vend me të zezën,
Sikurse gjeraqina me kallogrenë,
Veç i bardhi me zor e gjen gjuhën me zezakun,
Tym i zi, a tym i bardhë në Vatikan
Thua se zgjedhja e një pape do na lumturojë
Dhe i varfëri i tradhëtuar do mbushi barkun?!

Botë e kolorit veç po zbardhet
Ngjyra thjesht po quhet bojë,
Lara-bala sheh kudo,
Ditë e zisë a zi e bukës shtohet
Ndaj Netët e Bardha, ti “bardhezi” shko e festo?!

Kotësi e shpirtit shterp, asket,
Në klepsindër rëra kohën mat,
Sikurse prej plehut po del elektricitet,
Sa shumë zili xixëllonjën e kanë
Ngaqë mbahet veç me dritën e vet.

Plagët i kthyen në tatuazhe
Nishanin e hireshtës në njollë turpi,
Virgjëri e qepur po ka duk sot,
Me të zezat e tyre këta zezanë,
Rrobat e zisë i kthyen në modë.

Me gëzhojat e plumbave qorr
Në atdheun tim u bë një kambanë,
Ndoshta prej priftit Kris, mbase Kalkant,
Oh, sa shumë plumba u derdhën drejt qiellit
Për pak, Homer, desh të vranë!

Për kë tjetër bjenë këto kambana?
Orakujt vrasin kohën me fjalëkryqi,
Opinionistët transgjinorë me seksin e engjujve,
Largpamësit me horroskopin,
Konspirativët me mesazhe të koduar mafiozësh sakaq,
Vizonarëve u vënë fashën e zezë në sy,
Sikur të jetë 3D
Dhe i çojnë para togës së pushkatimit me urdhër nga lart.

Mirënjohje Ukrainë e një populli të bërë bashkë,
Ja që paska atdhe, o kozmopolit,
Ja që mbi sendet fitoka një shpirt,
Kush përdor flakën
Vihet në gjunj prej atij që ka dritë.

Baba Homer thuaji Eneas të kthehet
Se mjaft u end udhëve të botës fillikat
Në rigjetjen e një atdheu të ri,
Se si shumë ia kemi qarë hallin Odisesë
Që mbërriti në Itakë me plot peripeci...

Ftesës së universitetit të Copenhagen për të zhvilluar një cikël leksionesh në lidhje me teatrin e Pirandello-s, iu përgjigja pozitivisht. Nuk kisha qenë kurrë më parë në një vend nordik.

Në aeroport më pritë dekan i fakultetit, emrin e të cilit e njihja, meqë ai ishte i dëgjuar në fushën e strukturalizmit. Ndjemë një simpati të menjëhershme për njeri-tjetrin. Ai më shoqëroi së pari në hotel dhe më pas në fakultet, i cili, me godinat e tij në mes të gjelbërimit, ishte shumë mikpritës nga ana arkitektonike. Në korridoret e gjatë dhe të bollshëm, me mure tepër të pastër, nuk më kapi syri asnjë student.

‘Nuk jepen leksione sot?’

Ai më vështroi i habitur.

‘Po. Përse?’

‘Ku janë studentët, atëherë?’

‘Ku dëshiron që të jenë? Të gjithë janë në sallat e leksionit.’

Duke njohur gjendjen dhe huqet e universitetit të Romës, u binda se kisha mbërritur në bazën numër një të hënës. Konfirmimi nuk vonoi.

‘Nuk shkruajnë studentët nëpër mure këtu tek ju?’

‘Po, por ka një mur apostafat për këtë qëllim. Muri mbulohet me kompensatë. Kjo e fundit zëvendësohet çdo javë.’

Sekretaria e fakultetit më kishte njoftuar se në ciklin e leksioneve të mia kishin të drejtë të merrnin pjesë edhe studentët e gjuhës dhe kulturës italiane të Suedisë dhe Norvegjisë. Pra, përveç nëntë studentëve danezë, do të kisha edhe katër suedezë dhe tre norvegjezë.

Salla që më kishin caktuar ishte e shndritshme, e bollshme, elegante. Të nesërmen në mëngjes, pas një prezantimi nga ana e dekanit, dhashë leksionin e parë. Përpara leksionit, ama, isha hedhur në barin që ndodhej në brendësi të godinës ku më shërbyen me një whisky. Kjo më ishte bërë zakon në atë kohë. Në bar pashë dy bukuroshe, vetëkuptohet që ishin shtatlarta dhe bionde, studente të cilat më vonë i hasa në klasë, të ulura në rreshtin e parë. Fola për dy orë, ndërsa dy orët e fundit ia dedikova përgjigjeve ndaj pyetjeve që ata më drejtuan. Në fund të seancës, një studente daneze, topolake, me syze, tepër simpatike, më pyeti nëse kisha nevojë për një shoqërues për ta njohur Copenhagen; për këtë rol, ajo propozoi veten. Pranova. Në mbrëmje më çoi në një lokal të çuditshëm që frekuentohej nga studentë. Në një shesh të vogël ishin vendosur katër vagonë të vjetër tramvaji, të përshtatur dhe komunikues me njeri-tjetrin. Aty ndodheshin edhe dy studentet bionde të cilat u bashkuan me ne. Ishin suedeze, njëra quhej Ingrid, tjetra Barbro. Kalova një mbrëmje gazmore.

Të nesërmen në universitet, po i afrohesha barit kur Ingrid ma preu rrugën.

‘Jo,’ më tha ajo.

Shtoi se duhej ta ndiqja deri në klasë. Mbi katedër kishte një shishe whisky, një kanë me copa akulli dhe një gotë. Vura re se whisky ishte shumë i shtrenjtë. Përballë ngurrimit tim, klasa shpërtheu në të qeshura.

‘Është një dhuratë nga të gjithë ne,’ tha Ingrid.

Cikli i leksioneve ishte programuar për katër ditë, nga e marta tek e premtdja, dhe të shtunën në mëngjes do të nisesha për në Romë. Ditën e premte, përpara leksionit, dekan i më njoftoi se vonë pasdite, në universitet do të organizohej një mbrëmje lamtumire me studentët, si edhe me mua, atë, dhe rektorin. Ishin të gjithë të kënaqur me kursin tim, dhe këtë donin të ma shprehnin.

U ula në tavolinë në mes të dekanit dhe rektorit. Përballë meje qëndronte Ingrid, më e bukur se kurrë. Në mes të darkës, ajo më vështroi në sy dhe më tha, me qetësi të plotë, pa pasur frikë se të tjerët do ta dëgjonin:

‘Sonte, nëse të pëlqen, dua të rri me ty.’

Gjithçka ishte thënë shumë qartë. Sikur të kisha qenë në këmbë, do të isha shembur përtokë. Rektori nuk fliste italisht, por dekan i sigurisht që kishte dëgjuar dhe kuptuar çdo fjalë; ai vazhdoi të hante pa e hedhur shikimin nga pjata.

INGRID

Tregim nga Andrea Camilleri

Përktheu nga origjinali në italisht: Aristidh Shqevi

‘Flasim më vonë,’ thashë unë i hutuar nga Ingrid. Pas përshëndetjeve, ajo më shoqëroi jashtë ambienteve të universitetit. U ndieva i tunduar si Shën Antonio.

‘Në çfarë ore të ikën avioni nesër?’ më pyeti.

‘Në orën njëmbëdhjetë.’

‘Po të bëj një propozim. Në orën tetë, marrim tragetin për në Malmö, qytetin ku banoj unë. Këtu mund të kthehesh kur të duash, të shoqëroj unë sërish. Janë dhe tragetet e natës.’

‘Sa kohë na duhet që të mbërrijmë në Malmö?’

‘Vetëm një orë e gjysmë.’

‘Ikim,’ thashë unë.

Ajo tregoi se ishte më e fortë se unë. Trageti ishte mbushur me suedezë të pirë, sepse siç e shpjegoi Ingrid, dyqanet e alkoolit në Suedi mbylleshin në orën tre pasdite, ndaj pijanecët ishin të detyruar të shkonin në Danimarkë.

Mbërritëm, zbritëm dhe shkuam në një vend-parkim të madh ku Ingrid kishte lënë makinën e saj. Me t’u futur në makinë, ajo mori iniciativën.

Bashkëpunova. Pas pak, ajo ndezi makinën dhe kështu u nisëm drejt shtëpisë së saj.

Në një zonë me shtëpi të bukura, secila prej tyre me një oborr të madh, ajo u futi makinën përmes një porte të madhe, ndoqi rrugicën që të çonte në një vilë njëkatëshe, kaloi anash saj dhe parkoi makinën brenda në garazh pranë një makine tjetër. Teksa po ecja në këmbë, vura re se dritat e vilës ishin të ndezura. Nuk u shqetësova fare, dhe nuk e di përse por në atë çast u binda se ajo bashkëjetonte me një shoqen e saj studente. Hapi derën e shtëpisë me çelës, dhe tha diçka nga paradhoma, ndërkohë që një zë femëror iu përgjigj. ‘Eja.’

E ndoqa nga pas. U futëm në një sallon të këndshëm.

Një burrë dhe një grua, disi më të rinj se unë, ishin duke parë televizor. Ata u ngritën në këmbë.

‘Kjo është mamaja, ndërsa ky është babai,’ tha Ingrid teksa m’i prezantoi ata.

Ajo shtoi dhe diçka tjetër, besoj se po iu shpjegonte se unë isha profesor i kisha ardhur nga Italia.

‘Eja, shkojmë në dhomën time’ më tha Ingrid duke më tërhequr nga dora.

U ndieva i lebetitur dhe më erdhi turp. Ç’të bëja? Të shembesha përtokë pa ndjenja? Të shtiresha sikur më kishte kapur një krizë marrëzie? Apo të ulesha me ta dhe t’iu shpjegoja se më kishin kapur shenjat e para të sëmundjes së një njeriu shëndetlig që në atë moshë? Ndërkohë, Ingrid më kishte tërhequr prej dore deri në brendësi të dhomës së saj, pikërisht ngjitur me sallonin. Më përqafoi, filloi të më puthë, por papritur u ndal:

‘Çfarë ke? Po të shkojnë djersët çurkë.’

Nuk e lashë rastin të më ikte.

‘Në të vërtetë, nuk ndihem mirë, më merret mendja, ndoshta më ka bërë keq diçka që kam ngrënë, ose më ka rënë tensioni i gjakut...’

Brenda pesë minutave e pashë veten të rrethuar nga përkujdesjet e babait dhe të mamasë së Ingrid.

Pije të ftohta, termometër. Pas gjysmë ore deklarova se ndihesha më mirë. Babai shprehu dëshirën për të më shoqëruar deri në Copenhagen; ai më la përpara hotelit.

Atë javë, treguesi i burrërisë së italianëve në Suedi duhet të ketë rënë shumë poshtë, ashtu siç ndodh me bursën në kohën e krizave.

Pikërisht për nder të lirisë, spontanitetit dhe pastërtisë morale të Ingrid unë shpreha dëshirën që mikesha e huaj e komisarit Montalbano të ishte suedeze, dhe të kishte emrin e saj.



Para dyerve të faltores, një fetar i devotshëm kishte gjetur një foshnjë të braktisur, gjinia e së cilës nuk bëhej e ditur pa e zhveshur. Ajo lëshonte pandalshëm një zë të çjerrë që shurdhonte. I Devotshmi mori në duar foshnjën dhe ndenji një copë herë në oborrin e faltores. Duke e lëkundur sa andej sa këndej, tingujt e bezdisshëm të saj u zvogëluan dhe përhumbën si një efekt melodik i tipit *fade out*. Foshnja fjeti.

Ishin bërë plot shtatë vjet prej se i Devotshmi ishte martuar, por kurrë fëmijë nuk kishte pasur, andaj për të një gjetje e tillë i dukej si një dhuratë nga Zoti. Megjithatë, dilemat nuk e linin të qetë:

A ta lë aty ku e gjeta? Jo! Më mirë t'ia jap prijësit të faltores. Ai me siguri do ta dërgojë në jetimore. Jo, jo, as atij nuk do t'ia dorëzoj. Mos po bëj mëkat ose vepër penale? E nëse dënohem nga ligji suprem ose ai njerëzor? Nuk besoj. Do ta mbikëqyr këtë krijesë të braktisur në mënyrën më të mirë. Pse ta nënçmoj një dhuratë të tillë? Gjithë këto vite devotshmërie! Po, po, dhuratë është kjo, nga Zoti – mendoi ai teksa dilemës i dha fund dhe vendosi që foshnjën ta dërgojë në shtëpi.

Zonja përgatiste darkën në kuzhinën e cila në ballë kishte një dritare të vogël që mundësonte t'i shihej vetëm koka kujt do që hynte në shtëpi.

- E vetmja ime! Unë erdha. – thirri i Devotshmi me të hyrë në oborr.

- Mirë se erdhe, i dashur! A i solle ato që të kam porositur?

- Jo.

- Si?! Nuk i ke sjellë?! E me çfarë ta përgatis gjellën? – i bërtiti zonja murit me qëllim që zëri ta çante në mes dhe t'i shkonte drejt në veshin e të Devotshmit, i cili sapo kishte hyrë në korridorin e shtëpisë.

Ai ngadalshëm hyri në sallon dhe me zë të ulët iu drejtua zonjës:

- Qetësohu, e bukura ime. Nuk kam harruar për porositë, por isha i zënë me këtë fëmijën gjer këtu. Madje, as ritualin fetar nuk munda ta ndjek sot, për të cilin dola.

- Ç'po thua, or burrë? – ia preu zonja me një buzëqeshje të lehtë teksa nuk shqiste sytë nga foshnja që flinte aq butësisht në krahët e të Devotshmit.

- Të lutem, mos më bëj pyetje këtu. Gjersa foshnja fle, të sqarohemi në dhomën tjetër.

Qetësisht u zhvendosën aty, ndërsa gruaja duke rritur tonin e zërit i rendiste pyetjet e natyrshme.

- Mos je çmendur, or burrë?! Çka është kjo bebe? Ku e gjetë? E kujt është?

- Qetësohu pak, oj grua – e ndërpriti burri – tash t'i tregoj të gjitha. Qetësohu pak, mos nxjerr zë, sepse më dhemb koka. Mos ma shto dhimbjen.

Të dy u ulën mbi dyshekun e dhomës së fjetjes. Pushuan së foluri për aq kohë sa burri sosi një cigare të tërë. Tutje, vazhduan një bisedë të gjatë, gjersa arritën në një marrëveshje që ta mbajnë.

Teksa e fshihnin foshnjën brenda mureve të katit përdhese të shtëpisë, gruaja për më pak se nëntë muaj endej sheshit me barkun e fryrë falso, duke bërë që të gjithë të binden se foshnja do të jetë e tyre. Dhe, ashtu ndodhi.

Vitet kishin kaluar si rrufe. Flokët e të Devotshmit dhe bashkëshortes së tij dukej sikur ishin mbuluar me një shtresë të hollë fjolla boresh, dhe në lëkurën e shtrirë të fytyrës së tyre dikur, tashmë kishin zënë vend disa vija të lehta pleqërie.

FOSHINJA

Tregim nga Fatlum Mehulli

Të Devotshmit filluan t'i shfaqen edhe probleme shëndetësore meqë për nga shtati ishte i shkurtër dhe kishte aq simpati për ushqimet jo të shëndetshme, saqë yndyrat, sheqernat dhe brumërat ishin gjithnjë pjesë e përditshmërisë. Kjo shprehi kishte kaluar në varësi dhe si rrjedhojë edhe forma trupore e tij pësonte shtrembërim të vazhdueshëm. Stomaku i sheshtë dikur, tani i dukej sikur një gungë e butë kthyer anash, këmbët dhe duart e ënjtura, gjoksi merrte formë gjinjsh grash, ndërkaq në fytyrë sa vite e i shtoej dhjami duke krijuar një shtresë poshtë mjekrës. Nga e gjithë kjo gjendje e të Devotshmit nuk qëndronte shumë larg as bashkëshortja e tij.

- Oh, oh, s'di si të të them! Fillo të merresh me ndonjë aktivitet, ndoshta të përmirësohet sado pak gjendja. Të gjitha të hollat po harxhohen në barna tua, hej! Fillo të punosh diçka të lehtë, o njeri! – iu drejtua bashkëshortja të Devotshmit.

- Vazhdo edhe njëherë t'i përsëritësh këto fjalë dhe të betohem në emër të Zotit se do të të rrah keq. Moj, për çka ankon, moj?! Edhe pse nuk prek punë me dorë, unë i kam tokat e babës. Sa herë kam nevojë, shes ndonjërin. Gjitha kushtet i ke, madje mbi normalen. Eh, kush më flet për trashësi! Shikoje veten, more, si je bërë! Si një cilindër... Tmerr! Më neverit vetëm pamja jote, lëre më kur fillon llomotitjen.

- Mjaft më! Zoti të vraftë! Mallkuar qofsh!

- Mos mallko, o cilindër! Të dalë pak në qytet sa nuk kam bërë ndonjë skandal...

Kështu ishte përditshmëria e të Devotshmit, përshkallëzimi i së cilës kishte filluar qysh nga ditët e para kur bashkëshortët morën në mbikëqyrje prindërore foshnjën e humbur.

Koha kishte ecur me shpejtësi dhe foshnja qe bërë një goxha djalë për nga trupi dhe mezi po mbaronte shkollimin e mesëm. Prej se kishte hapur sytë, brenda shtëpisë së të Devotshmit qetësi nuk

mbeti. Ai me bashkëshorten vazhdimisht mendonin që ta hidhnin tutje, sikur e kishin gjetur, por në sytë e të gjithëve, madje edhe institutionalisht ai ishte i tyre.

Djali vazhdimisht sillte probleme në shtëpi: rrihej me të tjerë, ngacmonte vajzat e shkollës dhe jo vetëm, filloi me hajdutëri... dhe mbi të gjitha nisi të marrë substanca narkotike në masë të vogël që i siguronte nga dillerët, të cilët endeshin rreth shkollës herë pas here.

Çfarë mjerimi për të Devotshmin, që dikur merrej shembull për 'devotshmërinë' e tij dhe respektohej nga të gjithë. Ndërsa tani, komshinjtë dhe shokët thyenin rrugën teksa e shihnin atë, me përjashtim të ndonjërit që i jepte një përsëritje të ftohtë. E gjithë kjo kishte bërë që i Devotshmi, nga gjendja e tij dhe turpi, edhe ritualet fetare t'i rrallojë skajshmërisht. Pra, ishte bërë një parazit i vërtetë.

Shumë vjet më vonë, në një ditë të zymtë vjeshte, bashkëshortja e të Devotshmit ndërroi jetë. Ritualin e varrimit dhe pasvarrimit nuk do të zgjaste shumë. Erdhën për kryeshëndosh të afërm familjarë dhe komshinj. Disa prej tyre, ndër tjerash, me zë të ulët pëshpëritnin: "kishte goxha vjet e mjera, por vdekjen ia solli mërzia!". I Devotshmi padashje dëgjoi dhe me vete pohonte një gjykim të tillë. Megjithatë, nuk kishte mundësi të thellohej më shumë në mendime të kësaj natyre, sepse vazhdimisht në kokë llogariste se si t'i mbulojë shpenzimet e varrimit, megjithëse nuk ishin shpenzime të mëdha, por kasa e familjes po zbrazej pothuaj e tëra dhe mundësi mbushjeje i Devotshmi nuk kishte më. Djali i vetëm i tij, lëre që nuk interesohej për këtë gjë, por as në procesin e varrimit e tutje nuk kishte qenë i pranishëm. Gjithsesi, i Devotshmi në fund arriti që t'i bëjë pagesat dhe gjithçka përfundoi.

Prej asaj ngjarjeje, filluan ditët

në vetmi për të Devotshmin, i cili vazhdimisht mendonte rreth së kaluarës dhe të tashmes. Vdekja e gruas me kalimin e ditëve ia shtonte tronditjen. Nuk i hiqej nga sytë dhe nga mendja. Secila pjesë e shtëpisë ia kujtonte atë. Herë mallkonte veten për fyerjet dhe rrahjet që ia kishte bërë, herë i arsyetonte veprimet e veta. Ditët për të ecnin shumë ngadalë. Filloi ta harrojë gruan, sepse tashmë brengosej për veten, për fatin e tij:

- Gruaja më vdiq. Ai qeni vjen veç kur mbetet pa para. Tani kur të kuptoj që nuk kam një qindarkë për t'i dhënë, lëre që nuk do të më vizitojë më, por edhe do të më bërtet keq. I poshtri, është bërë si një bishë! Është bërë? Uh, i tillë ka qenë gjithnjë. Ah, unë çdo të bëj, i mjeri?! Fuqia trupore po më lëshon dita-ditës. Parat dhe burimi po shterohen. Çfarë gjendje e tmerrshme është kjo? O Zot, ty çfarë të kam bërë që ma kthen kështu? A e meritoj? – gërryente mendjen i Devotshmi, çdo ditë njësoj.

Kjo gjendje e rënduar financiare, frika ndaj të ardhmes, konfrontimet me djalin mizor, krijonin një situatë që të Devotshmit përherë ia kujtonin vdekjen. Kjo e fundit e tmerronte. Sa herë i vinte në mendje fjala vdekje, frikësohej skajshmërisht. E kapte një panik çmendurie – krizë ekzistenciale.

Gjatë dhjetorit të atij viti, në një ditë të ftohtë dimri, në shtëpi të të Devotshmit erdhi djali për të kërkuar të holla. Ishte mbushur borxhe dhe po qe se nuk i lante, bandat huadhënëse do ta hiqnin qafe, por së pari do ta torturonin mizorisht.

- Të duhen para, me siguri – gjykoi i ati sapo pa djalin.

- Sa mirë e di, babëloku! – tha me cinizëm djali – Më jep krejt ato që ke sepse më duhen urgjentisht. E di që ke harxhuar për varrimin e nanës, por unë s'të kam faj që i ndjek ti këto adetet a traditat a si i quan ti?

- O djali im, të betohem që nuk kam më për të të dhënë. Në fakt, i kam pak, sa për të blerë barna. E di edhe ti që nëse nuk i marrë me rregull përballem me ndonjë sulm.

- Më keq u bëfsh! – pëshpëriti djali, pastaj me zë të lartë - Oh, të fundit i paç! Çka më intereson mua? Përse më keni qit në këtë botë? Kur nuk je i zoti të mbash një djalë të vetëm...s'di...s'di...nganjëherë më vjen të vjell kur mendoj çfarë prindërisht kam pasur.

- Si nuk të vjen turp, ore! Të kemi rritur kaq... je bërë sa një kalë, dhe asnjëherë asgjë nga ti nuk kemi kërkuar!

- Shiko...tash edhe fajtor po më bën?

- Po, normal.

- Nuk e kam ndërmend të grindem me ty. M'i jep ato para që ke, se barnat t'i siguroj unë më vonë. Tek e fundit i vjedh në barnatore, ha ha ha!

- Mos bre bir, të lutem!

Djali nuk ia vuri më veshin, teksa vazhdimisht kërkonte aty pari. Befas iu kujtua se babai rëndom të hollat i mbante në dhomën e fjetjes poshtë krevatit. Kur i gjeti, kaloi pak kohë deri i çmbështolli dhe duke i numëruar tha me vete - brraa, nuk qenka edhe aq keq – pastaj i futi në një çantë pëlhure dhe duke dalë nga shtëpia me zë të lartë thirri:

- Babëlok! I gjeta. Mos ke dert se barna të sjell sa të duash. I fortë je ti, nuk të gjen gjë. *Ciao* se më duhet të shkoj.

Pak para se të dilte mendoi - Përse nuk ma ktheu? Zakonisht thotë diçka. Mos doli diku? Ta shoh njëherë...

Djali kthehej për në dhomën e ndjenjës



dhe pak para se të hynte me zë të acaruar bërtiti:

- Hej, a më dëgjove?!

Kur hyri, pa ta Devotshmin shtrirë në dysHEME në një pozicion zvarraniku lëkura e të cilit ishte zbehur dhe mbuluar nga një shtresë e ftohtë djerse që ia shtonte një dridhje të vazhdueshme. Sapo e pa gjendjen, djali me vete:

- Ihh, edhe kjo më duhej. Pikërisht tani. Natyrisht kështu do të ndodhte. Gjithë jetën vetëm duke ngrënë, pa pikë kontrolli. Duhet ta shpëtojë. Nuk mund ta mohoj, baba e kam, por edhe më duhet ky njeri. Me siguri ka ende ndonjë tokë pa shitur.

Ashtu veproji. Spitalin nuk e kishin larg nga shtëpia modeste, e cila ndodhej në afërsi të qendrës së qytetit. Teksa e dërgonte me taksinë që e kishte thirrur për vete më herët, djali për një çast mendoi me një buzëqeshje cinike - çfarë fati ka. E do Zoti...

Bardhë...krejt bardhë, më pas zi për një kohë. Dhe në fund prapë bardhë, duke bërë që syve të të Devotshmit të moshuar t'u jepej edhe një shans jete. Pas një operacioni të gjatë, u kthye në jetë, por goditja në tru nuk kaloi pa pasoja. Dora e majtë dhe këmbët imbetën të palëvizshme, gjysma e gojës e shtrembëruar duke ia vështirësuar ndjeshëm të folurit, po ashtu kishte dhembje të tmerrshme koke. Kur e ndjeu gjendjen e re, i Devotshmi mallkonte momentin që u kthye në jetë. Tani kërkonte vdekjen.

Pas dy javëve, spitali e lëshoi të Devotshmin. Ai u zhvendos në dhomën e shtëpisë së tij. Aty dergjej i vetmuar në shtrat, ndërsa ditët që dikur për të ecnin ngadalë, tash i dukeshin si shekuj. Djali vinte rrallë për t'i dhënë pak bukë e ujë dhe asnjë shërbim tjetër, duke e fyer dhe mallkuar vazhdimisht. Dhoma qelbej – nuk dallonte nga një WC publike e shkatërruar. I Devotshmi i palëvizshëm, nuk mund të bënte tjetër përveç përsiatjeve. Për herë të parë pas shumë vitesh, ofshau:

- Ah, nana ime! Ahh, nana ime!

Nuk i hiqej nga mendja çasti kur, dy vjet pas martesës, i Devotshmi – si djali i vetëm i shtëpisë – kishte braktisur në fshat nënën e moshuar dhe babanë e dërrmuar, me kërkesën e bashkëshortes dhe pretekstin se në qytet do të qytetërohej.

Disa muaj pas braktisjes, të moshuarit kishin ndërruar jetë për një ditë, ndërsa në qytet askush nuk dinte për aktin dinak të të rinjve, sepse edhe ashtu qëndrimi në vetmi të moshuarve nuk u zgjati shumë. Këto mendime bënë që i Devotshmi t'i harrojë dhimbjet trupore, sepse parandiente dënimet e tmerrshme që do t'i përjetonte në jetën pas vdekjes, së cilës i besonte aq shumë.

Në janarin e vitit të ri, saktësisht në ditën e fundit të muajit, djali erdhi në shtëpi. Krejtësisht i egër. Ishte mbuluar prapë nga borxhet dhe e dinte se prej shtëpisë nuk gjente shpëtim më. E mbi të gjitha, kriza mendore i shtoej kur shihte babanë dhe dëgjonte kërkesat e vazhdueshme të tij...

Disa fëmijë që po loznin në afërsi të shtëpisë, hapën veshët për të dëgjuar britmën e madhe të djalit që shante dhe mallkonte vazhdimisht. Më pas ikën me vrap kur dëgjuan dy krisma drithëruese armësh...

VRASJA E NJERIUT TË LIGJIT

Tregim nga Adil Olluri

Në mbrëmjen e tjetërdjeshme u vra një njeri i ligjit.

U vra fare pranë banesës së tij.

U vra në orën njëzetë pa një çerek.

Ishte duke ecur me hapa të ngadalshëm, pa u ngutur për asnjë çast, siç ecte gjithnjë i miri ynë që nuk shpejtonte asnjëherë. Ndoshta asnjëherë nuk do ta dimë saktë se pse njeriu i ligjit ngadalësonte gjithmonshëmërisht. Ndoshta do ta ketë pasur ndonjë arsye të bazuar në ndonjë fakt kokëfortë, por që tash vështirë se mund ta kuptojmë, sepse ai më nuk është në mesin tonë. Po të ishte mes nesh, ndoshta do të na i shpjegonte mirëfilli ecshmërinë e tij të ngadalë, edhe pse një gjë e tillë, thënë të drejtën, nuk është se do të na hynte shumë në punë. Nuk ka hyn më punë, sepse nuk mund të zgjidhim gjë edhe nëse e marrim vesh një të vërtetë të tillë, tash për tash të panevojshme.

Me siguri, ata që e lexojnë këtë rrëfim do të pyesin se ç'ishte ky njeri i ligjit? Ishte gjykatës, prokuror, avokat apo hetues? Kishte emër dhe mbiemër? Ku jetonte dhe ku punonte? Ç'vishte e ç'mbathte? Ishte i trupgjatë apo i shkurtër? E shumë e shumë pyetje të tjera e të ngjashme, që mund t'i shtonin gojët kureshtare, për t'i bërë sy katër e për t'i hapur veshët sa më s'ka, për të lexuar a për ta dëgjuar ndonjë të dhënë shtesë rreth njeriut të ligjit, që u vra në mbrëmjen e tjetërdjeshme. Fundja, ç'rëndësi ka nëse themi se ka qenë gjykatës, prokuror, avokat a çfarëdoqoftë. E rëndësishme është që u vra një njeri i ligjit dhe atë duke shkuar, shpengueshëm, në banesën e tij, ku e prisnin gruaja dhe fëmijët e tij. E rëndësishme është që u vra një njeri që nuk mëtonte ta vriste askënd. Një njeri që nuk do t'i shkonte asnjëherë mendja se në një mbrëmje me hënë të plotë do të vritej fare pranë folesë së tij.

Me të arritur në lagjen e tij dhe fare pranë hyrjes së rrokaqiellit ku ndodhej banesa e tij, iu kujtua se nuk kishte më duhan, sepse gjatë takimit gati treorësh, i kishte pirë të dhjetë cigaret e pakos së mëparshme, të cilën e kishte shtrydhur dhe e kishte hedhur në koshin e mbeturinave te dera e kafenesë së tij të preferuar, në të cilën nuk do të hynte më asnjëherë. Hyri në shitoren më të afërme, u përshëndet me shitësin shkurtak dhe militant të partisë në pushtet, i cili shante secilin gazetar që shfaqej në ekranin e vogël të televizorit të vendosur në shitoren e tij. E shprazte tërë arsenalin e mllefrit ndaj kujtdo që dilte në ekran dhe e vinte në dyshim aftësinë dhe ndershmërinë e udhëheqësit të tij të parapëlqyer. Njeriut të ligjit nuk i pëlqente aspak ky shitës gojështurur,

por përtonte të shkonte tashmë në shitoret më të largëta, sepse ishte vonë dhe dëshironte të kthehej sa më parë pranë më të dashurve të tij. Pa humbur kohë dhe pa i lejuar mundësinë shitësit të futej në bisedat e tij të zakonshme për fuqinë e patjetërsueshme e të të pakontestueshme të udhëheqësit të madh, ai bleu një pako cigare dhe një lëng dredhëze, që e pëlqenin aq shumë fëmijët e tij. Pakon arriti ta hapte dhe të tymonte dy ose tre herë, jo më shumë, por lëngun e dredhëzës nuk arriti t'ua sillte fëmijëve të tij.

Teksa merrte kthesën për të hyrë në rrokaqiellin ku ndodhej banesa e tij, u shkrepën tre plumba mbi trupin e shëndosh të njeriut të ligjit. Tre plumba në gjoksin e gjerë të të mirit tonë mjaftuan që ai të binte përdhe si një lis i madh e degëhapur, por që nuk i bën ballë dot asnjë sëpate, sado e vogël qoftë ajo.

Njeriu i ligjit u gjakos dhe vdiq në çast, ndërsa vrasësi iku me erën, si një përftim që nuk e pa askush as kur erdhi e as kur iku. Ishte si një hije që mund të shfaqej sa hap e mbyll sytë dhe të zhdukej si mos të kishte qenë fare në atë vend. Banorët e lagjes, policët dhe hetuesit habiteshin se si në një hapësirë qyteti, ku në çdo çast mund të shihje njerëz duke shkuar diku ose duke u kthyer nga diku, mund të vijë dikush, ta vrasë dikë dhe të mos e shoh askush. Për ta bërë gjendjen edhe më të çuditshmen, vrasësin nuk e kishin kapur as kamerat e sigurisë, që ndodheshin mbi dyer dyqanesh, shitoresh në kënde

të ndryshme të lagjes. Se si ka mundur t'i ikë vrasësi hije edhe kamerave të tilla, që xhironin çdo gjë, kjo do të mbetet çudia e çudive, një mister përtej misterit, që vështirë se mund të kuptohet ndonjëherë.

Njeriu i ligjit vdiq në çast. Nuk e kishte as gjasën më të vogël t'iu mbijetonte tre plumbave më të vogël e më të hollë se gishtërinjtë e dorës, të dalë nga revolveri vdekjesjellës që ndoshta nuk do të ketë qenë më i madh se një pëllëmbë e zgjatur dore. Ai do të ketë provuar ta ngrite kokën për të parë se kush gjuajti mbi të, por nuk do t'i ketë arritur as ta shihte kush e qëlloi aq saktësisht e aq vdekësisht. Fryma do t'i ndalej, nuk do të ndiente më jetë as dhimbje, gjaku do t'ia ketë përshkuar këmbishën e kaltër, cigarja e ndezur pak më parë do t'i jetë fikur nga gjaku i njomë, ndërsa lëngu i dredhëzës i blerë për fëmijë do të jetë rrokullisur deri te hyrja e rrokaqiellit.

Gruaja me t'i dëgjuar krismat do t'i linte fëmijët vetëm për pak çaste dhe do të dilte vrapthi për të parë se ç'kishte ndodhur. Sikur ta parandiente të keqen, doli pa menduar dy herë dhe u pa u munduar ta thërriste së paku në telefon. Ajo asnjëherë nuk do t'i linte fëmijët vetëm, por në këtë rast parandjenja kishte ngadhënjyer dhe zbathur kishte zbritur shkallëve.

Rreth trupit të pajetë do të jenë mbledhur kalimtarë të rastit dhe njerëz të lagjes. Dikush do të ketë telefonuar policinë a emergjencën, dikush do të ketë fotografuar. Gruaja e tashmë të ndjerit do t'i shpejtonte hapat për t'iu afruar meitit dhe kur e pa që ai ishte pikërisht burri i saj e lëshoi një britmë deri maje qiellit dhe një vaj lemeritës që nuk ishte dëgjuar asnjëherë në atë lagje.

Lajmin për vrasjen e njeriut të ligjit mori dhenë. U fol për të për dy ditë rresht në shumicën e kanaleve lajmëdhënëse të vendit tonë. Madje, për të u fol edhe në ato vendeve fqinjëve e më larg. Për të u shkruan poezi e këngë qe vajtonin fatin e keq të të vrarit. Ai për së vdekuri u bë i njohur dhe i dashur për qytetarët, të cilët për së gjalli fare pak, ndoshta edhe aspak, nuk kishin dëgjuar për të.



1

Për të arritur deri në pikën, ku më në fund m'u desh të ndalesha, unë i nënshkruari Zhani Siko po ndiej nevojën e kronikës.

Në krah të udhëheqësit të doktoraturës sime të dikurshme, Profesorit Frederik Brand, kam patur rastin të ndjek në Londër simfoninë e pambaruar të Betovenit, atë që numërohet E Dhjeta. Përgjigjen për pyetjen përse u luajt në Londër, e kisha dhënë tërthorazi në librin tim "Betoveni dhe përgjigjet e munguara". Ishte vetë kompozitori që, në të gjallë, ia kishte premtuar Shoqërisë Filarmonike Mbretërore.

Kujtoj se, kur po dilnim, dikush i foli Profesorit:

- Zoti Brand, unë nuk krijova ndonjë ide për temën e simfonisë. Mendoni ju se Kuperi (Cooper-i) ia ka dalë duke montuar këto fragmente? Dhe a mund të më thoni përse Scherzo-n e ka lënë jashtë?

Profesori e kaloi me një nënqeshje. Ndërsa mua më pëshpëriti: "Shih për çfarë kujtohet violinisti! Pyetje e hidhur. Sidomos kjo e Scherzo-s është e denjë për kërkimet e tua."

Siç e kishim bërë me fjalë, në vend të kthehesha në Tiranë, të nesërmen morëm avionin për në Bon. Isha mysafir i zotit Brand.

2

Vila Brand ndodhej pak kilometra larg qytetit dhe ishte aq e madhe, sa më vinte çudi përse dy djemtë e familjes jetonin larg prej vitesh, njëri në Suedi dhe tjetri në Danimarkë. Nga zonja kujtoj merakun për kekun e mbasditës, si dhe mirësinë që rrezatonte fytyra e saj, e cila më dukej si një dritë që e merrte me vete ngado nëpër shtëpi.

Me Profesorin, në ditën e dytë, iu kthyem disa herë bisedës për Simfoninë 10 që, duke u pajtuar me studiues të tjerë, po e cilësoj hipotetike. Beri Kuper kishte mbledhur e montuar disa materiale dorëshkrimore, masa me pak nota, që nuk lidheshin mes tyre as si motiv. Po, tha Frederik Brand, me gjasë ato skicime kanë qenë më tepër në mendjen e Betovenit, sesa në pentagrame. Madje edhe vetë Kuperi, mbasi mblodhi fragmentet, ka pohuar se mbetet një projekt që nuk e shpie përpara simfonizimin betovian. Por ka një fakt, që nuk mund të mohohet. Betoveni ka luajtur në piano një pjesë të kësaj simfonie për mikun e tij Karl Holz. Dhe përshkrimi i Holzit ngjason me skicat që gjeti Kuperi. Enigma pra nuk mungon, vazhdoi i zoti i shtëpisë, flitet për një simfoni që edhe ekziston, edhe nuk ekziston. E di si i thonë kësaj, miku im, është njëloj si të nëpërshihet aty-këtu fantazma e dikujt, që si qenie e gjallë nuk ka ekzistuar kurrë.

PËRGJIGJET E MUNGUARA

Kuartet nga Zija Çela

3

Njëherë tjetër (mund të ketë qenë dita e tretë), teksa rilexoja në dhomë "Betoveni dhe tri stilet e tij" të W. de Lenz, zonja më njoftoi se profesori po më priste në sallonin e bibliotekës. Donte rreth një orë për të ngrënë darkën dhe më ftoi të pinim një aperitiv. Libri që mbaja në dorë, u bë shkak që biseda të hapej shpejt.

Kur kisha përgatitur doktoraturën me "Pyetjet e munguara", Profesorin më kishte nxitur që, gjatë hulumtimeve për stilin, të mund të bëja njëfarë kategorizimi të simfonive. Dhe unë, dashje pa dashje, kisha mbrojtur tezën se, pothuajse në mënyrë periodike,

Betoveni i qe kthyer formës klasike. Pikërisht këtë po i sillja në mend zotit Brand, po i thoja se pas eksplozionit me Heroiken 3, Simfonia 4 ka formë të pastër klasike. Shpërthen te Pesa tematike, pastaj Gjashta më shumë poetike e pastorale, peizazh por jo aksion. Vjen Shtata me magjinë e vallëzimit, përsëri rikthim te forma e pastër me Tetën klasike. Ndërsa Nënta shënon revolucion në simfoni dhe në muzikën botërore.

- Kanë shkuar vite, Zhani, - m'u drejtua profesori, - dhe tashmë po plakem. Nuk më bie ndërmend, sipas kësaj diagrame si e parashihje në librin tënd Të Dhjetën e Betovenit, klasike e parashihje?

- Unë e shtroja pyetjen, por përgjigje nuk jepja, zoti Brand. E nëse do të më duhej ta jepja tani, do të thosha jo, jo. Me sovranitetin që kishte fituar, ai rebeli nuk do t'i bindej më asnjë kanoni formal.

Prita që tjetri të përsëriste shprehjen e tij të njohur për Betovenin, kur e cilësonte Demon shkatërrues dhe Zot krijues të formave, por ai vetëm tundi kokën. Pastaj tha:

- Në vitin 1808 kemi Simfoninë Pesë dhe Simfoninë Gjashtë. Në vitin 1812 kemi Simfoninë Shtatë dhe Simfoninë Tetë. E Nënta vjen më 1824. Sipas diagramës, ndoshta këtë vit pritëshin përsëri dy simfoni, mirëpo... Mirëpo E Dhjeta mungon.

Ai më hodhi një vështrim zhbirues nën vetulla dhe, meqë zhbirimi zgjati, teksa bluaja punkturën e tij "E Dhjeta mungon", m'u duk sikur po më fuste xixat. Si ta ndiente gjendjen time, zoti Brand iu afrua bibliotekës dhe diç mori në parvazin e një etazheri, duke thënë se do të ma bënte dhuratë. Kur e pata në dorë, për ngjyrën e errët dhe peshën e rëndë, lënda e atij trupi të vogël më përngjasi me ndonjë skorje metali, që nxirren nga furrat e shkrirjes.

- Është një meteorit, - i dha vlerën Profesorin. - Dhe ka rënë në kopshtin tim një mbrëmje pas darke, kur po shëtisja i menduar.

Ndoshta fajin e kishin ato xixat për shtysën time të menjëhershme.

- Më falni, - e pyeta, - dhe në ato çaste ju po mendoni për Betovenin?

- Po mendoja për Mozartin, - ma ktheu. - Për atë hyjnorin, që sikur pati ardhur në Tokë pikërisht nga Qielli.

Kishte folur ende më këmbë dhe më këmbë do të qëndronte një copë herë. Zoti Brand lidhi duart pas kurrizit dhe nisi të bariste ngadalë, sikur nuk ishim në sallonin gjysmërrëthor të bibliotekës, por në kopshtin me shtigje kalimesh. Ashtu, në ecje e sipër, vazhdoi të fliste. Me mua e kishte, por zëri i tij më vinte aq

turfullues, sa me gjithë gjermanishten time të mirë, kishte fjalë që më humbisnin. Pak a shumë, këtë po thoshte përmbledhtazi. Ç'ishte ajo sëmundje, ajo këputje para kohe, ajo razbitje fizike dhe mendore e Mozartit?! Ç'ishte mania e tij e persekutimit, po ato hije e shajni që i shfaqeshin?! Ç'ishte ajo parandjenjë për fundin e afërt?!

Pastaj, kur zuri vend dhe i dha mjekrës pak mënjanim, si të donte t'i bënte fresk grykës së nxehur, ma lëshoi mua zjarrminë e tij.

- E ç'mendon ti, kush ka qenë ai që i vajti në shtëpi Mozartit dhe i porosi Requiemin? Këtu mendjen, të lutem, nuk po them Minuet, po them Requiem!

Në librin tim, por pa e shprehur troç, kisha lënë të nënkuptohej se mund të ishte Salieri. Ndërsa me Betovenin e kisha pasur më të lehtë, sepse ishte gjerësisht i pranuar fakti që dikur kishte marrë mësim nga Salieri për stilin vokal.

Unë te zoti Brand e kisha mendjen, veçse nuk doja ta shihja në sy, ngaqë



po më bëhej i padurueshëm zhbirimi i vështirimit të tij. Megjithatë, ai u tregua edhe më i drejtpërdrejtë.

- Përse një Requiem, që do të luhej së shpejti në mortin e Mozartit, ndërsa ai që ia kërkoi nuk u bë më kurrë i gjallë?!

- Profesor, - mora guximin, - mos doni të thoni se porositësi ka qenë një fantazmë?

- Atë po them, Zhani. Veçse fantazma e një qenie që nuk i përket vdekatarëve të zakonshëm si ne. Nuk i përket, përderisa kurrë nuk u arrit të identifikohet diku në faqe të dheut.

Tashmë më duket pak të përmend xixat, Frederik Brand po më fuste tërbimin.

4

Me t’u kthyer në Tiranë, e ndalova dorëshkrimin e librit, që ishte gati të shkonte në shtypshkronjë për ribotim. Botuesit i thashë se kisha nevojë të mendohesha nëse do ta shtoja tekstin. Atë meteoritin, si ia ndërrova vendin disa herë në bibliotekë, e vura mëpastaj në tryezën e punës. Kot thoshte ime shoqe se isha bërë supersticioz. Kot thoshte se po e përdorja si totem ndaj dalldisjeve të mia mistike. Unë e dija pse e mbaja aty. Duke kujtuar mjeshttrat që i presin aq saktësisht diamantet, më kishte shkuar në mend se, një ditë, ndoshta do të gjeja një artist që do të gdhendte në atë gur kokën e Betovenit. E pra unë ashtu e shihja meteoritin, si një miniskulpturë.

Kur arrita te ky imazh, isha çliruar disi nga ethet e atyre xixave, që më jepnin makthe edhe në gjumë. Nuk doja ta zbusja furinë e fantazisë, por as të lejoja që shthurja e saj të ma errësonte arsyetimin. Natën, herë-herë, më dilte gjumi nga thirrjet e Betovenit. Më tepër se thirrje, ishin klithma luanike. Ai u drejtohej gjithë pezm vienezëve, adhuresve të tij të mëparshëm: “Ju, mosmirënjohës mizorë, ma kthyet shpinën tashmë! Më harruat, më braktisët, o të pafytyrë! Dashkeni bel canto tani, dashkeni Puçinin?! Mbajini pra! Ju nuk më meritoni dhe unë kurrë, kurrë nuk do të kompozoj më për ju. Unë do të kompozoj vetëm për njerëzit e së ardhmes!”

Nuk ishte pjellë e fantazisë sime kjo revoltë, as ky deklarim dhe mbyllja në vetvete e Ludwig von Beethoven-it. I pohojnë tërë biografitë e gjeniut. Çfarë nuk gjeja kund të shkruar, ishte hamendësimi im për kahun që morën ngjarjet.

Në fazën e shurdhimit absolut, kur me veshin e brendshëm riprodhonte tinguj, vetëm tinguj, unë besoja se sublimja te Betoveni ishte bërë e shumëfishtë. Njëkohësisht me frushullimën që bën Toka duke u rrotulluar në boshtin e vet, ai arrinte të kapte edhe tingujt e padeshifrueshëm që vijnë nga hapësira kozmike. Me këto përmasa që ushqenin talentin e tij, po besoja se, më 1824, Betoveni kishte

arritur përsëri të shkruante dy simfoni, kësaj here të njëpasnjëshme. Dhe nëse E Nënta ishte një shpërthim i gjithë kufijve tokësorë, deri ku ishte ngjitur E Dhjeta? Dhe nëse vërtet ishte shkruar, përse nuk gjendeshin partiturat e saj, ku ndodhej tani?!

Ngaqë ngurroja t’i dilja ballë për ballë në chat, i dërgova një e-mail zotit Brand. Ndër të tjera i thoshja: “Sipas meje, mund të ketë një arsye përse njeriu, i cili i porositi Mozartit atëherë Requiemin, nuk u identifikua kurrë. Ai nuk ka qenë një fantazëm, por një mesazher jashtëtokësor.”


Profesori e kuptoi se me këtë çelës po kërkoja të shpjegoja edhe paktin e Betovenit me jashtëtokësorët për Simfoninë 10. Nuk më interesonte nëse qe marrëveshje me ndërgjegje, me detyrim apo përkundrazi, gjithë ngazëllim e bujari kjo dhuratë nga ana e autorit. Shkurt, përmes përfaqësuesit të tyre, ata i thanë: “Ne ia përshpejtuam vdekjen vëllait tënd, por nuk e grabitëm, sepse Toka do të dukej e shkretë pa muzikën e Mozartit. Ndërsa Simfonia jote e tejkalon planetin e njerëzimit, ajo përfshin tërë kozmosin, prandaj na përket neve.”

Me gjasë, pikërisht ky përfaqësues e udhëzoi edhe për mbulimin e gjurmëve konspirative. Betoveni sajoi ato materialet e shkëptura dorëshkimore, masa me pak nota, që do të gjente Beri Kuperi nga simfonia apokrife. Madje, për të përforcuar gjasmimin se kjo ishte E Dhjeta, sajoi edhe alibinë me Karl Holzin, në praninë e të cilit luajti në piano një fragment. Megjithatë, etja për hakmarrje ndaj mosmirënjohjes që ishte treguar ndaj tij, nuk u shua me kaq. Tirani shtoi edhe një Scherzo, si për t’i dhënë tërë kësaj enigme edhe përqeshje njëkohësisht.

Ndërkaq, autori që kishte shkruar sonatat Drita e Hënës, Apasionata dhe Les Adieux, tani do të kompozonte Sonatën e Madhe, Meshën Diellore dhe Variacionet mbi një vals të Djallit. Ka të ngjarë që Hajdenit t’i ketë paraprirë intuïta, kur e njohu djalosh të ri dhe i tha: “Ju më jepni përshtypjen e një njeriu që ka shumë koka, shumë zemra, shumë shpirtra.” Ky ka qenë parashikimi më i saktë se, një ditë, Ludwig von Beethoven-i do të bëhej i mjaftueshëm edhe për Tokën, edhe për Qiellin.

Meqë hipotezën time nuk guxoja ta përfshija në faqet e librit, dhashë leje që “Përgjigjet e munguara” të ribotohej pa e prekur tekstin. Nuk kisha asnjë tundim për t’i shkruar sërish Prof. Brandit. Vendosa të ndaloja vetë në këtë kufi, para se të më ndalonte ai. Dhe ndalova, duke qëndruar në përgjim e duke mbajtur veshët hapur. Ndoshta me të drejtë, ende sot e kësaj dite, thuhet rëndom se çdo përgjigje për Betovenin e rrëzon një përgjigje tjetër, ndërsa të gjitha bashkë janë vetëm të përkohshme.

Tiranë, prill 2020



NJË PRILL!

(Skicë e shkurtër kushtuar ditës se shënuar ndërkombëtare të Rrenës legjitime!).

Nga Bajram SEFAJ

April li-li..., i lojës, i argëtimit imagjinar, pa mbarim. Ditë me emër e mbiemër.

Nuk është e mundur.

Ditë-datë, si për shembull, ditës së shtatëmbëdhjetë të muajit maj, t’i ngjitet emri Ditë Shiu! Ose një dite-datë tjetër, Ditë Breshri. Ditë Bore..., bie fjala! Ditë Pazari. Ditë Feste. Ditëlindje. Ditë Vdekjeje..., ani bën, disi. Por ditë rrenash, kjo nuk bën assesi! Nuk kalon. No pasaran! Është e paimagjinueshme, absolutisht e papërfytyrueshme, që një dite, cilado qofte ajo në kalendar, t’i ngjitet emër i caktuar. Ashtu sikurse nuk është e mundur, të caktohet ditë as datë, kur do të bjerë shi, a dëborë. Borë, shi e breshër, mund të bien çdo ditë ose të mos bien hiç. Pa orar e kalendar!

Nga, si e qysh, dita e parë e muajit prill, mori emrin Ditë e Rrenave???

Sikur ditëve të tjera të motmotit nuk rren njeri! Po të ishte ashtu, do të ishte një gjë e mirë, e mrekullueshme. Ditë e shenjtë. Festë gjithënjërzore!

Njerëzit rrejnë, mjerisht, para dhe pas një prillit. Për çdo ditë, pandërprerë e gjithmonë. Rrejnë në jetë. Në krijimtari. Në art. Edhe më keq, rrejnë kur bëjnë shkencë. Në çdo fushë tjetër. Sidomos në politikë dhe diplomaci! (Shtim: për diplomacinë thuhet se është i vetmi profesion pa etikë. Aty rrena ka legjitimitet të garantuar).

Më logjike do të ishte sikur dita e një prillit të shpallej Ditë pa rrenë. Ditë Vërtetësie! Ditë e shënuar, kur do të ishte më e bekuara e të gjithave! Ditë gjatë se cilës nuk do të këputet asnjë rrenë! Dita e një prillit të quhej Ditë mahish, gazmoresh, qesëndish...

(Episod: Ndreu hoqi dorë nga meditimi rreth kësaj teme të vjetruar. Kodi i saj, qoftë edhe gazmor, humoristik dhe argëtues, është zhbërë dhe shuar krejt. Është mekur humori, sot! Ishte i sigurt se çfarëdo që të shkruante sot, do ta shpallte të humbur, të pavlefshme!

Paradoks dhe ironi, kjo ditë i sillte sihariq. I biri nuk kishte qenë në kurrfarë kontrolli, siç shkruante. Kishte qenë në ekzaminim, në sprovë zemre djaloshare. Me një bukuroshe alpine, të bardhë si qumështi, në dhomën e hotelit të bukur dhe luksoz, mbi liqenin e hijshëm të bjeshkës!).

(Nxjerrë nga romani “Terra nullius”, ShB Rozafa, Prishtinë -2009, faqe 152-154).

Akti i botimit të parë të një vepre nga një poete, ishte inaugurimi i saj në letërsi, ishte hapja e një porte, e cila nuk do të mbyllej më, pavarësisht shtrëngatave që herë-herë e rrapëllonin portën deri në mbyllje. Sipas disa të dhënave e para grua që nënshkroi një libër (*Epin e Gilgameshit*, 2285-2250, ishte Enheduanna, një princeshë sumere. (<https://www.worldhistory.org/Enheduanna/>). Më vonë gratë i mësuan gratë, sadoqë ato nuk arritën të krijojnë rrjet të tyre si bën burrat poet deri vonë nuk arritën të krijojnë paraardhëset e veta. Vulf (*Një dhomë për vete*, 1929) i mësoi të kenë një dhomë dhe çelsin e saj për vete, ato i mësuan njëra tjetrës të shkruajnë për të gjitha nuansat e shpirtit femëror. Më së shumti shkruan për dashurinë. Natyrisht, vepra e tyre nuk u lexuan vetëm si emocion femëror, ato u imponuan edhe si art i bukur, gruaaja u bë edhe identitet kulturor, nuk duroi së qenuri shërbyese shtëpie.

Studimet psiko-analitike e socio-gjinore të Frojdit e Blumit, paragjykimet patriarkale të kulturës letrare, sidomos të shekullit të nëntëmbëdhjetë, vazhduan mosbesimin në krijimtarinë e gruas, së cilës i mungonte tradita e shkrimit femëror e “ kryeveprat nuk janë lindje të njëhershme dhe të vetmuara; ato janë produkt i shumë viteve të të menduarit të përbashkët, të të menduarit të kombeve të tëra, kështu që pas zërit individual qëndron përvoja e masave”, thotë Vulf (*Një dhomë për vete*, fq.149) por gruaaja me talent duhej shekuj të priste sepse “çdo grua e lindur me një prirje të madhe, në shekullin e gjashtëmbëdhjetë gjithsesi u çmend, vrau veten ose përfundoi jetën në një kasolle të vetmuar në fund të fshatit, një gjysmë shtrigë, një gjysmë magjistare, që ka frikë...” (*Po aty*, f. 139).

Të jesh krijuese këtu tek ne, në ambientin tonë në një masë të mirë ende patriarkal, dhe të jesh poete diku tjetër, në botën përparimtare, del pra të mos jetë ndonjë dallim shumë i madh, sado që letërsia e grave tona është e re. Realisht, leximi i poezisë së poetëve tek ne, është një lexim tjetër, është lexim i përcjellë me paragjyime, me mosbesim, shpesh tendencioz dhe injorues. Letërsia e poetëve, tek ne në Kosovë ende s’ merret seriozisht, nuk ka studime të veçanta për ndonjërin krijuese, tema doktorate apo monografi. Kemi krijuese me disa vepra letrare të botuara e pak kush merret me to. Letërsia e poetëve shpesh është përcjellë me thashetheme, afera e mosbesim. Faktorët për këtë janë të shumtë sepse lufta në letërsi është luftë e vazhdueshme, është e lashtë dhe e pafund. Jo vetëm si tematikë e përmbajtje, por më shumë si rivalitet mes krijuesish për primat. Ka shembuj të pafund të mohimit të krijuesve e posaçërisht të krijueseve. Këtë e e **evidenton psikohistoria** letrare e Harold Blumit, e cila duke qenë se është psiko-analizë, udhëheqet nga skemat frojdiane-se një -dikush mund të bëhet poet, vetëm duke mohuar baballarët e tij poet, d.m.th duke nënkuptuar mohimin krijuesit paraardhës, e që janë të shumtë. Blumi, skenën e letërsisë e sheh plot luftë mes bijve dhe baballarëve poet, një gjendje dramatike dhe aspak e këndshme. Është e ditur se të shumtën e historisë letrare e përbëjnë burrat, bijtë dhe etërit, sepse gruan e eliminon “fakti” që muza është grua dhe raportin e poetit burrë dhe muzës – grua sipas Blumit, është një raport dashurie dhe në këtë mënyrë mohohet gruaaja reale krijuese-eliminohet nga skena e letërsisë. Në këtë rast ajo shumë – shumë është objekt frymëzimi, është zanë, shtrigë e djall.

Ndërkohë, qëndrimin ekstrem të Blumit e sulmon dhe e neutralizon lëvizja feministe dhe teoricienja **Juliet Mitchell**, e cila kërkon që psikoanaliza t’i bëhej shoqërisë patriarkale, jo poetëve. Sipas Blumit, poetja-në botën e letërsisë ka pamjen e një të panjohuri, si një genie të përçudtë, jo të zakonshme dhe krejt të paqartë, pra të shpërftyruar si botë. Kjo qasje e Blumit, promovon në heshje mohimin e faktorit grua në letërsi. Blumi sillet brenda kontestit psikoseksual –patriarkal,

Shikuar sipas teorisë psikoseksuale-patriarkale të Blumit dhe nga lëvizjet feministe

Muza vazhdon të jetë grua

Nga Dije Demiri-Frangu

duke e lidhur problemin me *kompleksin e Edipit*, i cili bie mbi krijuesit burra dhe me *kompleksin e Elektrës* tek poetet. Për Blumin personat e barazvlershëm poet e poete janë të ndryshëm. Shikuar nga ky kontekst i qasjes psikoseksuale del të jetë se poetet s’ kanë ballafaqime të forta me paraardhësit gra-poete, se ato janë të pakëta por kanë konkurrencë e ballafaqim me poetët e shumtë derisa kolegët e tyre poetë, në vazhdimësi kanë beteja të mëdha me **shumë etër** të tyre. Ndaj feministet shprehin drojën për rrezikimin e gruas krijuese, duke shprehur frikën e mungesës së modelit-paraardhësve të saj, derisa ata janë vetëm burra. Në këtë mënyrë del pasqyra e historisë letrare që dominohet nga gjinia e fortë, se letërsia sado që është emër i gjinisë femrore në shumicën e gjuhëve, është burrërore në kuptimin e dominimit të emrave të tyre.

Gruaja krijuese-poetja, nga këtu e ka frikën se s’ mund i arrin asnjëherë ATA, s’ mund bëhet kurrë *paraardhëse* sepse *paraardhësit* si burra-shprehin një autoritet-burrëror, që jo lehtë mundet nga gratë. Autoriteti burrëror është shumëfish më i theksuar në vendet me histori të shkurtë të paraqitjes së krijueseve (tek ne tek më 1939 është botuar vepra e Musine Kokalarit, “Siç më thotë nënua plakë”), derisa krijuesi burrë ka modele, ajo-krijuesja s’ka modele të shumta të gruas ndaj krijohet **kompleksi i autorësisë**, kompleks që e pengon në ecjen e saj poetike. Kjo është më e theksuar tek to më shumë se kompleksi i **ndikimit-autoritetit-poetit**, ndaj krijueses i duhej paraardhësja, që të arsyetojë ekzistencën e saj, si fakt se ajo mund të jetë krijuese, e që t’i bind të tjerët duke shfrytëzuar këtë si dëshmi mbi një gjenezë- sepse të qenit grua, për një krijuese ishte fatalitet, gur Sizifi në rrugëtimin e saj, i duhej dikush ta ketë trasuar këtë rrugë, që të justifikohet se –unë nuk jam e para, nuk jam djalli që bëj diçka të panjohur. Mitchell me të drejtë e quan **“psikologjia inferiore dhe “alternative”** e grave dhe kjo psikologji e inferioritetit e ka bazën tek përqeshja që është bërë me ambicien dhe pretendimet krijuese të gruas. Natyrisht, inferioriteti është imponuar,

duke gjuajtur ate në margjina të letërsisë, kulturës e përgjithësisht jetës sociale. Në këtë mënyrë analiza e feministes Mitchell shkallëzohet, duke shtuar se krijueset kanë frikë edhe nga lexuesit, (shih në letërsinë tonë, poetet kanë pasur një afeksion ndaj disa krijuesve dhe i kanë imituar duke i menduar si strehë, si siguri mbi punën e tyre. Ato janë sjellë kryesisht brenda rrathëve tematik e motivor të emrave të tyre, kanë imituar shkrimin e poezive sociale –kundër hakmarrjes, mërgimit, varfërisë e të shpesh të poezi patriotike, si autorët mashkuj. E bënë këtë duke ndier frikën ndaj lexuesve dhe paragjyimeve të tyre, ndaj poezia e dashurisë ishte më e pakët e me një leksik të i ngurtë, shprehjet e dashurisë ishin vazhdimisht të vetensuruara. Janë këto poezi të thjeshta dhe me një leksik romantik, me një ndërtim larg erotizmit. Tani, gjithsesi kemi krijuese me ego më të fortë lirie e guximi -me poezi që shprehin feminilitetin si formë të thirrjes për liri. Krijuesja ka frikë nga paragjykimet-pikërisht si gratë patriarkale, ka frikë nga raportet kulturore por sado e viktimizuar ajo krijon. Domsodo, mbetet një anëtare e një subkulture-nënkulturë, se kulturën e mbajnë burrat krijues. Nga njëra anë, pra, paraardhësit e gruas-poete, simbolizojnë autoritetin, nga ana tjetër, pavarësisht autoritetit të tyre, ata nuk arrijnë të përcaktojnë mënyrat se si ajo e përjeton identitetin e **vetë si** shkrimtare. Përkundër gjithë kësaj, dihet se poezia e gruas veçohet parasegjithash me një psikologji të thellë e të larmishme ndjenjash dhe me një mendim të prerë, gjë që e dallon nga “paraardhësit”. Për më tepër, gruaaja bën një proces të reduktuar të shkrimit, sakaton frymëzimin e saj ngase autoriteti mashkullor, që doemos ka implikime në jetën e saj krijuese si botues, redaktor e si juri, shkrimtares i duket se është drejtpërdrejt kundër termave të përcaktimit të gjinisë së saj, ai mund të jetë kundër arsenalit tematik e leksikor profeminist, që mund ta ketë poetja. Kjo është arsyeja pse “frika nga ndikimi” që përjeton një poet mashkull, homologja e tij- gruaaja shkrimtare e ndjen në radhë

të parë si **“frikë nga autorësia”**, ajo nuk mund të bëhet kurrë një “paraardhëse”, ndaj do jetë e izoluar nga qarqet e poetëve derisa paraardhësit mishërojnë autoritetin patriarkal (jo më kot është krijuar metafora mbi **atësinë** letrare), ata vazhdimisht e shikojnë gruan brenda stereotipeve të kundërta si engjëll dhe përbindësh. Në këtë mënyrë janë ngritur barrikada ndaj subjektivitetit dhe kreativitetit të saj. Ato profilizohen si përbindsha në rast se nuk janë të dëgjueshme ndaj normave të vjetra, nëse nuk sillen si engjëj. Kohët e fundit, në fakt, sociologë dhe historianë shoqërorë, si Jesse Bernard, Phyllis Chasler, Naomi Weinstein dhe Pauline Bart, janë marrë me hulumtimin e ashtuquajtur “sëmundje femërore”, që Frojdi e kishte pagëzuar si –histeri, derisa sociologët sot fajësojnë pikërisht shoqëritë patriarkale e që fatkeqësisht deri në shek.XIX kjo sëmundje mendore merrej si shkak i gjinisë dhe mundësisë së saj riprodhuese. Kjo qasje sigurisht e kishte burimin qysh te Aristoteli, për të cilin feminiteti ishte një deformim. Depersonalizimin e gruas tash bota moderne bën në tjera forma shfrytëzimi dhe nënshtrimi dhe atë përmes politikave të bizneseve, që duan ta shohin vetëm si mall të bukur. Nisur nga shkaqet ekzistenciale dhe tjera, ajo zbrret peshën, bën intervenime plastike sepse ka frikë nga pamja e saj, sërish shkak i autoriteti patriarkal. A ka luftë kundër autoritetit letrar patriarkal? Tek-tek, duket ndonjë reagim i heshtur kundër klaneve burrërore të krijueseve, por jo edhe luftë. Sipas studimeve-kjo luftë është e mundshme përmes lëvizjeve feministe. Frika nga izolimi që mund t’i bëjnë poetes lexuesit e poetët- autoriteti patriarkal i artit, droja dhe ankthi për etikim të punës së saj si një paturpësi, kanë reduktuar në masë horizontin e saj krijues dhe kanë bërë që ajo të ndjehet “inferiore” ndaj vetshpalljes –poete. Kjo dukuri që ishte e theksuar më shumë para shekullit XX, ende vazhdon të shprehet si mosbesim ndaj saj, sadoqë tash është e ndërtuar krijimtaria e tyre si një subkulturë, e autoriteti patriarkal shpreh frikë nga kjo subkulturë.

Shenjë e fortë e luftës së grave për autoritet krijues ishte qëndrimin e dy autorëve të mëdha ruse, Marina Tsvetaevës e Anna Akhmatova e që është qëndrim gjeneral i krijueseve, klithja e tyre: s’ jemi poetesha, jemi poete, ato insistonin se e meritonin titullin e -poetes, të vetëdijshme për forcën e talentit që kishin, garonin si poete me poetët. Këto shkojnë më tutje, kanë guximin të plasohen si autore që realisht tashmë i kishin mundur shumë autorë, kishin kapërcyer vlerat letrare të poetëve të kohës-shekulli XX, që mendoheshin të pakonkurentë si: S. A. Yesenin, V. V. Mayakovsky, E. E. Mandelstam, A. Bely etj. Të bindura në potencën e tyre krijuese ato sulmuan dhe thyen tendencat për injorimin dhe marginalizimin e krijimtarisë së tyre. Shumë statistika, shumë të dhënat flasin për prezantimin dhe influencën e tyre, ato u lexuan shumë, u shkrua shumë për to dhe vazhdojnë të jetojnë si poete. Poashtu edhe Mary Shelley, si 19 vjeçe (1816) me “Frankenstein”-in la në hije Shellin, Bajronin e të tjerë, duke e nisur një zhanër të ri ashtu edhe si Agata Kristi, me më shumë kopje të shitura titujt e saj-dy trilionë kopje. Nathalie Sarraute klithte në një intervistë: “Kur shkruaj nuk jam as burrë, as grua, as qen, as mace”, duke kritikuar seleksionimin e grave krijuese si qytetare të rendit të dytë, të botës së letërsisë.

Bronte dikur pushon së shkruari me emra burrash, Sharlot dhe Emili u bënë emra, Simon de Bovoar me librin *Seksi i dytë*, u bë feministja më e njohur e shek.XX. Pas Perl Bak, ka edhe tjera gra nobeliste dhe ndoshta s ka më nevojë Annie Gottlieb të thotë se edhe në ëndrra fajësojmë nënat tona për zgjedhjet ndëshkuese që na imponon kultura jonë.”A e dini se çfarë po bëni? Po shkatërroni feminilitetin tim, fuqinë time femërore, e cila është e rëndësishme për mua ...!” Shumë feministe evidentojnë se



krijueset sikur duan të harrojnë gjithçka të tyre, injorimin e inferioritetin që ua sjell trashëgimia familjare dhe niveli i nënave që i edukoi të heshtin. Natyrisht, kjo vlenë edhe për poetet tona.

Frika e autorsisë e shek. XIX u mund dhe fuqia femrore duke ndërtuar identitetin e vet, nis me guxim ta shpreh atë që ndjen e mendon, sepse çkado që shkruhej merrej si pjesë e jetës dhe historisë së saj autoriale, si një sekret që duhej ç’koduar, mendohej si jeta private e saj dhe paragjykohej. Mesazhi i krijimit merrej si histori e saj. Qasjes injoruese ndaj gruas i kanë ndihmuar shumë ideologji, shumë filozofë dhe krijues ku gruaja ishte portretizuar si objekt joshës, ku dashuria e saj merrej si dobësi dhe jo dashuri, ajo portretizohej si qenie neorotike dhe parasegjithash me intelegjencë më të ulët se burrat. Kjo qasje ishte kronike dhe natyrisht duheshin përpjekje të mëdha për çbërjen e këtij miti. Ajo duhej të zhvishej nga shumë attribute të dhëna nga burrat krijues, e para duhej të luftonte me frikën e saj sepse si thotë - Simone de Beauvoir në “Seksi i dytë” - “ato nuk kanë asnjë të kaluar, asnjë histori, asnjë fe të tyren.” Burrat patën përfitime nga to me shekuj, megjithatë gruaja tani nuk përfaqëson vetëm të keqen-Juliet Mitch ell, “kulti i paaftësisë femërore” që u zhvillua në Angli dhe Amerikë nga edukimi patriarkal, sadoqë kishte bërë që edhe vajzat e zgjuara e me plot imagjinatë, duhej t i nënshtroheshin frymës së kohës patriarkale, të jetoj e depersonalizuar, e pa pavarësi ekonomike- miti u ç bë. Ato tash kultivojnë, jo vetëm letërsi për fëmijë, si dhe zhanre të kualifikuara si më të vogla - ditarë e tjerë dhe me kusht t ’i kenë lexues vetëm gratë, shkrimi i tyre tani nuk përkufizohet - gratë për gratë. Stabilizimi i shumë emrave të njohur sidomos viteve të 70-ta e 80-ta, krahas paraqitjes së strukturalizmit, bëri që teoritë feministë të pushojnë, sado që kjo është në disfavor të krijimit të tyre. Letërsia e disa burrave-krijues, sidomos atyre të SHBA-së (Henri Miler dhe Norman Mailer), ku gruaja paraqitej si ngacmuese e tradhtare vazhdojnë të qarkullojnë. Kur e bën autorin të vdes Roland Barthes (“Vdekja e autorit”, 1977) si dhe kur Derrida (1988) e bindi opinionin letrar se vepra letrare është një sistem shenjash, nisin e fajnë teoritë feministë, dhe veprat e poetëve bëhen objekt i kritikës letrare si tekste dhe jo si vepra autorësh. Poetet nuk trajtoheshin më si zezakët e Afrikës. Veprat e grave trajtohen në nivele akademike, statusi gra-poete, nuk lë më përshtypje.

Gjithsesi, në forma të ndryshme vazhdon lufta grua –burrë. Më 2007, Drew Faust u emërua presidentja e parë femër e Harvardit në histori. Gjithkund u arsyetua zgjedhja e saj si shkak i gjinisë. E dihet se asnjë grua e asnjë poete nuk ka dëshirë të vlerësohet shkaku i gjinisë, sikur që s kanë dëshirë të thuhet shkrimtar burrë, shkrimtar zezak, shkrimtar homoseksual e tj.

Se poetetet ishin të parat, dëshmon letërsia popullore. Ninullat dhe përrallat ju rrëfesheshin fëmijëve para gjumit nga nënat, derisa lirinë e fjalës publike ende nuk e kishin ato. Më vonë pos shkollës së vuajtjes-jetës, gratë i kryen edhe shkollat formale dhe ndryshoi raporti dhe më nuk fshiheshin pseudonimeve mashkullore.

Beauvoir, Simone de (1984) The Second Sex, trans. H. M. Parshley.
Sandra M. Gilbert i Suzan Gubar- Psychoanalysis and feminism: A radical reassessment of Freudian psychoanalysis.
J Mitchell - 2000 - psycnet.apa.org
1.https://www.nytimes.com/1971/02/21/archives/female-human-beings-female-human-beings.html?auth=link-dismiss-google1tap
Laura J. Shepherd, “Sex or Gender?: Bodies in World Politics and Why Gender Matters”, in:Laura J. Shepherd (ed.), Gender Matters in Global Politics: A feminist introduction toInternational Relations, Routledge, Oxon and New York, 2010, p.
Sandra M. Gilbert, Susan Gubar, The Madwoman in the Attic: Woman Writer and the Nineteenth-Century Literary Imagination, Yale University Press, New Haven dhe Londër, 1984

1.
Dreqi erdhi dhe më pyeti:
- O zotëri që të ka lënë mendja, ku po shkon?

Ti edhe pse je dreq, nuk e kupton, pse njeriu nuk guxon të largohet nga përgjegjësia e njeriut.

Në planetin Tokë ku jetojmë, në vendin më të pushtuar e më të sunduar dhe më të ballafaqeshëm nga sfidat e kohës.

Me pasaportë miku t'i shpesh vjen dhe më pyet:
Ku po shkon.

Kur zjarri nuk rri pa folur.
Njeriu gjen fjalë për të biseduar me njeriun.

Për t'u mësuar me vetveten.
Nuk e di pse po ndodh kjo.
Kujdes, i thashë vetvetes.
Për sot e sot dhe për terrin e botës egoiste, njeriu ende po lufton me pasqyrën.
Duke i prishur të gjitha pamjet.
Pa e ditur pse po i prishë...

2.
Lirinë më vjen ta kërkoj.
Nuk e thashë unë.
Fytyra e jetës e tha.
Magjia e Bjeshkëve të Nemuna e tha.
Fjala më e famshme në botë.
Lëviz, lëviz...
Për një marrëdhënie tjetër e tjetër e tjetër.

Edhe Zoti e kishte një plan tjetër.
Asgjë nuk është siç ka qenë.
Pas shpinës hapi koha krahët.
Mua po më duket se nuk e kuptova egoizmin.
Digju shpirt, digju.
Ke qenë shpresë dhe buzëqeshje.
Shpirti më tha:
- Shpirti nuk digjet lehtë.
Diçka e zezë, si ide fluturimi, shpejt kalon.

Përtej maleve.
Magji!
Ç'dreqin po ndodhë?
Kur për çdo gjë më vjen të kërkoj botën.
Çmenduria nuk është më siç ka qenë.
Po presim...
Sot çmenduria prish gjithçka...
Piramida e Ramzesit të Tretë, në Egjipt, nuk është më siç ka qenë.

Ndryshimi i botës është një mal me kujtime që u kushtohet të gjallëve dhe të vdekurve.

Ato tregime e ato lecka tani nuk i përkasin askujt.

Flasin për një jetë e për një luftë që është bërë dhe për një luftë që do të bëhet...

3.
O dreq, dhe i biri i dreqit, ish Njeriu është në hall. Nuk po di ta thërrasë Oqeanin Paqësor. Si ta thërret ndryshe.

Unë i thashë:
- Edhe pse nuk kërkoja më shumë se pak, po më duket se nuk kuptova asgjë.
Ç'po ndodhë me mua, nuk e di!
Dreqi qeshi dhe, betohem, më tha:
- Kjo është e gjitha...

Në idetë e fluturimit, në kërkim më shumë se pak...

4.
Varfëria të ha shpirtin.
Gazeta me lajme të mbrëmjes është sa për t'u parë në terr.

Të mos shkojmë aty ku është thesari.
Lakmia krijon imazh të egër.
Të bëjmë një fotografi artistike.
Ndoshta na ka mbetur edhe diçka pa u thënë.

Na pëlqen rreziku.
Pse jo!
Unë jam rreziku që nuk e kam ditur.
Shpejt erdhi një kohë tjetër.

Të gjithë ju miqtë e mi, jeni duke jetuar në kujtime...
Ju lutem, një minutë qetësi.

MAGJIA E BJESHKËVE TË NEMUNA

Ese nga Rexhep Ferri

Pjesën më të madhe të kërkesave, njeriu rrallë i realizon.

Më nuk kam as pyetje e as kërkesa, e as syza për lexim.

Nuk ka se çka më duhet ky planet i shëmtuar, i pistë...

Kush e bëri të pistë?

Njeriu nuk po e thotë.

Para syve më kalon shqetësimi.

Nga Teatri i Ëndrrave, një botë që nuk ekziston, derisa këndon ora me qyqe, ky analfabetizëm qeshet para pasqyrës, si e vetmja mundësi nga historia e gjatë e pashkruar harrova shumë fjalë.

Besomëni, nëse doni të më besoni.

Për ta kuptuar më mirë magjinë, kohën e ardhshme e fotografova.

Nuk e di si më erdhi: heshtja dhe balta.

5.
Ishte shumë terr.
Nuk pashë.
Frika nga vetvetja është më shumë se frikë.

A ekziston edhe diçka tjetër? Po flitet se fluturimi po ndiqet e po regjistrohet.

Sa xhami ka Kosova.

Sa librari ka Kosova.

Sa shtëpi publike ka Kosova.

Sa patriot të rrejshëm ka Kosova.

Kur shkojmë për ta humbur vetveten.

Çka të bëjmë me vetveten.

Masa e qeverisë janë vetëm sot për sot.

Dhe jo vetëm kaq.

Shumë afër, afër është edhe rruga e refugjatëve.

Folkloristët zbulojnë një histori.

Për të zbuluar fytyrën malit ia tregojnë fytyrën. Nga rrëfimi në rrëfim.

6.
Ka më shumë se një mënyrë për të jetuar.
As çorrfermani.
As çorrkadia.
S'kanë se çka të mendojnë më shumë.
As për mirë.
As për keq.
Nuk ndryshojnë.
Për të shkurtuar shqetësimet.

Vetëm historia e pashkruar po e mbanë anën time.

Si për mirë.

Si për keq.

S'kam se çka të mendoj më shumë.

Pas një jete si të qenit.

Si të qeshim.

Si të jetohet.

Si të vdiset.

Aman vdekja qenka ma e pastër se

këmisha.

Pas një jete kur vjen drita.

Pse ta humbasim dritën.

Pas një jete.

Pas një vdekjeje.

7.
Nuk po flas politikisht për t'u graduar ose keqkuptuar, ose për t'u bërë qen partiak. Njerëzit që nuk e dinë se çka është shtëpia, këtë patriotizëm kurrë nuk e kanë kuptuar.

Kjo paralizë nuk është maçungë tupani,

por gjurmët i ka gjurmë që nuk analizohen,

por me heshtje të paralizojnë.

Të keqinterpretojnë.

Për t'u bërë nën partie.

Kopil partie.

Sondazhet tregojnë se shqiptarhonja

këndeje e andej Bjeshkëve të Nemuna është

populli më i lumtur në rajon.

Sa lehtë është me sundu.

Kokrra e budallait jemi, kush e ka

menduar se jemi kaq të gjerë.

Buzëqeshja e lagjeve të fëmijërisë sime

dhe e ngërçeve të djalërisë.

Si të doni e paguajmë. E përdorim e

s'e paguajmë. S'e paguajmë. S'e paguajmë.

Gjatë këtij udhëtimi është një shpërthim

i madh i marrëzisë që na çmend dhe e

përdorim edhe s'e paguajmë. E përdorim e

s'e paguajmë.

Me një heshtje të gjallë ende po

tregohemi se te Kali i Skënderbeut në Tiranë

dhe te Kali i Skënderbeut në Prishtinë janë

dy sheshe të caktuara, ku ne shqiptarhonja i

qesim të gjitha të larat e të palarat me i shitë

si patriotizëm.

Kur e gjejmë vetën dhe kur e harrojmë

vetën.

Zoti i së vërtetës e paska humbur rrugën.

Para se të perëndon horizonti.

Është diçka e bukur që unë të bukurën

e mendoj.

Unë, shiu, lotët...

Si të dalë nga kjo histori politike?

Histori mashtruese e histori e pashkruar


e kujtesës së heshtur dhe e kohës së humbur.

Ora me qyqe, si ora me qyqe...

Mbyllja e syve..

Mbyllja.





VENUSI I URBINOS

Dr. Bledar Kurti

Pashë vajza të reja që vjedhurazi hidhnin vështrime të fshehura drejt saj; pashë të rinj që e vështronin gjatë dhe zhytshin në të; Pashë burra të moshuar e të pafuqishëm që dorëzoheshin përpara bukurisë së saj me një përqendrim patetik.
Mark Twain

Venusi i Urbinos (1534) është një nga veprat më mbresëlënëse dhe me ndikimin më të madh në historinë e artit. Mjeshtrit e mëvonshëm të pikturës do frymëzoheshin prej saj, duke e pozicionuar modelen e tyre me të njëjtin qëndrim apo shtrirje, me krahun e djathtë të mbështetur mbi nënkresë, e me dorën e majtë duke prekur seksin e saj. Pavarësisht përpjekjeve të mëvonshme të figurave të shquara të artit si impresionisti Edouard Manet, apo edhe fotografi modernist amerikan Man Ray, nuk do arrinin dot t'i afroheshin madhësisë dhe sensualitetit, as me penel e as me aparat fotografik, kësaj pikturë kaq pluskuese në mendjen dhe imagjinatën e shikuesit, e kaq joshëse e tunduese për çdo sy.

Një foto vlen sa një mijë fjalë, është shprehja e njohur gjerësisht, por kjo tablo e Tiziano Vecellio (1488-1576) i njohur shkurt si Ticiani, flet më shumë sesa një libër i tërë. Kjo pikturë shpërthen me ngrohtësi. Ngjyrat kryesore të saj janë jeshilja, e bardha, e kuqja dhe grija, të shoqëruara me një njollë blu të qiellit në plan të fundit. Ato e bëjnë trupin nudo të femrës të spikasë dhe të ngrohë vështrimin e shikuesit. E gjithë tabloja është e mbushur me detaje të cilat në fakt sfumohen nga mendja për shkak të yshtjes që ndjell trupi femëror. Në dorën e saj ajo ka një buqetë me lule, perdet dhe dysheku janë të shpalosura me imtësi, dyshemeja është e përshkruar me detaje të jashtëzakonshme, dhe ka çarçafë, mbulesa, sixhade, një qen, dy shërbëto, një sënduk, një kolonë romake, një vazo me lule, një dritare, një pemë, një peizazh fshati, një perëndim dielli, të gjitha të trajtuara individualisht, por që së bashku

harmonizohen në mënyrë të përsosur.

Në këtë tablo çdo gjë është e qetë, e rregullt dhe e ëmbël.

Venus do të thotë dashuri, por Ticiani nuk e titulloi kështu këtë vepër, emrin që ka sot ia dha Giorgio Vasari, biografi i shekullit të 16-të, dhjetë vite pasi përfundoi kjo tablo. Me shumë gjasa modelja ishte një kurtizane ose prostitutë. Sipas të dhënave, në Venecia, në vendin dhe kohën kur u pikturua kjo vepër, kishte 11,000 prostituta, e duke marrë në konsideratë popullatën e Venecias së asaj kohe, 170,000 banorë, raporti i prostitutave me meshkujt ishte 1 me 15. Një kurtizane ishte e klasit të lartë, e dalluar nga një *meretrice* (prostitutë e thjeshtë) dhe *puttana* (prostitutë rruge). Kurtizanet kishin shtëpinë e tyre, e shpeshherë ishin të famshme. Sipas të dhënave sot njihen edhe disa prej emrave të tyre, si Lucrezia Squarcia, Vienna Rizi Stellina, Lucia dagli Alberi, etj. Dhe ne sot, me mendjen e njeriut modern, duke imagjinuar jetën bohemiane të artistëve në përgjithësi, mendojnë se Ticiani ishte një artist i dhënë pas seksit, që flinte me modelet e tij, ose kishte ndonjë dashnore sekrete. Kjo është tërësisht e gabuar, pasi Ticiani ishte i martuar dhe kishte tre fëmijë, dhe sipas letrave dhe rrëfimeve të bashkëkohësve të tij, ai ishte një bashkëshort i devotshëm ndaj të shoqes.

Kuptimi i gjithë tablosë nuk është ende i qartë, pavarësisht shumë e shumë interpretimeve dhe spekulimeve të ndryshme që janë bërë për të ndër shekuj. Por, disa elementë të veprës janë të qarta, të ditura, dhe të kuptueshme. Është e pranuar që Venusi ishte një modele prostitutë pasi ishte traditë e kohës që artistët në Venecia e praktikonin për çdo vepër që krijonin. Madje dimë edhe që paguheshin dhjetë soldi. Disa elementë të tjerë ne i kuptojmë nga konteksti kulturor i kohës, por padyshim një pjesë e mirë e informacionit mbi veprën ende mbetet e mjegullt.

Dikush mund të pyesë, përse artistët nuk

i shpjegojnë veprat e tyre? Përse nuk i bëjnë një përshkrim e të japin një informacion më të plotë për çfarë kanë krijuar? Në këtë mënyrë edhe shikuesi do e kuptojë më mirë veprën! Për çdo pikturë, artist, muzikant, shkrimtar, apo krijues i çdo zhanri, këto do ishin pyetjet më të papërshtatshme. Nëse dëshironi ta inatosni një artist bëjini atë pyetjen e rëndomtë: çfarë ke dashur të shprehësh me këtë vepër? Provojeni e do shikoni vetullat e artistit apo artistes që ngrysen, ose në rastet e vetëpërmbytjes do vëreni që ai apo ajo do flasë përçartë. Kjo ndodh pasi arti është një univers i tërë, ndaj nuk mund të përmbledhet në pak fjalë. A mund t'ia përshkruash dikujt aromën e trëndafilit? Edhe freskinë e erës apo ëmbëlsinë e cicërimave të zogjve nuk arrimë dot t'i përkufizojmë me fjalë, e jo më artin vetë. Arti është komunikim personal me shikuesin, përmes imazhit, mesazhit dhe ndjesive. Dhe ndjesia e ngrohtë dhe e brishtë që përçon kjo vepër nuk mund të shpjegohet dot me fjalë. Ndaj ne, si në këtë vepër ashtu edhe në çdo vepër arti, duhet të përfshihemi, të kuptojmë, të ndiejmë, të përjetojmë magjinë që mbart. Ne udhëhiqemi nga elementët që na jep artisti, të cilat janë si një hartë e një thesari të fshehur, dhe shikuesi përjeton një përvojë të jashtëzakonshme, jo kur e gjen atë thesar, por gjatë udhëtimit për ta gjetur atë. Është një komunikim i bukur që e shuan konceptin e kohës, falë së cilit ne sot arrijmë ende të komunikojmë me artistin që jetoi pesë shekuj më parë.

Dhe çfarë na thotë Ticiani përmes kësaj veprë?

Tabloja ka një qendër. Po, qendra e veprës është pikërisht aty ku bie perdja në të majtë të pikturës. Në seksin e Venusit.

Ticiani e ka përdorur perden si një tabelë sinjalistike për ta çuar shikimin tonë në atë destinacionin. Perdja shkrihet butësisht me dorën e majtë të Venusit e cila prek fundbarkun e saj, me një prekje e cila është

interpretuar herë si e dëlirë dhe e pafajshme e herë mëkatore. Perdja në të majtë shërben edhe për ta ndarë tablonë në dy plane. Ajo ndihmon shikuesin të dallojë erosin në figurën e Venusit dhe planin në sfond në të cilin shpaloset një moment i jetës së zakonshme.

Giorgio Vasari e pa personalisht këtë pikturë në koleksionin e Dukës në Urbino. Ai e përshkroi atë si «një Venus i ri që rri shtrirë në pëlhurat e bukura dhe lule.» Në këtë vepër, mbulesat dhe tapiceritë janë po aq të rëndësishme sa edhe figura e femrës. Gjatë të gjithë karrierës së tij, rrobat e veshura nga gratë dhe ambienti që i rrethonin ato ishin po aq interesante për Ticianin sa edhe vetë figurat që pozonin. Ashtu si shumë bashkëkohës të tij, shpesh artisti i shihte femrat si stereotipa dhe i pikturonte me një qasje të atillë. Por femra në këtë vepër është ndryshe. Ajo mbart një dybotshmëri, mishore dhe frymore, ndaj edhe ajo vazhdon ta magjepsë njerëzimin edhe pesë shekuj më vonë.

Dokumentet e kohës e quajnë tablonë *Venusi i Urbinos* thjesht si *donna nuda* (grua lakuriq) dhe është vërtetë një portret i idealizuar i një kurtizaneje veneciane, por që tashmë është e maskuar nën titullin e respektuar të Venusit, një emër që i jep asaj një shkëlqim të marrë nga mitet e lashta dhe tek dija e epokave. Për të pikturuar trupin e saj Ticiani përdori nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë shtresa boje transparente. Ndaj trupi i saj është aq pulsues dhe flokët e saj aq të ngjashme me ujëvarat.

Skena e tablosë shpaloset brenda një pallati të madh, i llojit të kohës së Rilindjes, me vetëm një pjesë peme dhe disa reve që shihen përtej lozhës në anën e pasme. E rrethuar nga një mjedis bashkëkohor, gruaja qëndron e mbështetur në jastëkët e një shtrati të parregulluar. Ajo pret vëmendjen dhe ndihmën e shërbëtorëve të saj që shihen në sfond, njëra prej të cilëve mban një fustan të mëndafshhtë mbi supet e saj, ndërsa tjera

kërkon për veshje të tjera brenda në sënduk.

Megjithatë, në qendër të kësaj pikturë nuk janë veshjet apo mjedisi por lakuriqësia befasuese e Venusit. E shtrirë e gjitha përpara shikuesit, trupi i gruas, koka dhe busti i të cilës janë theksuar edhe më shumë nga perdja jeshile dhe muri i errët pas saj, është pika referuese e erosit në artin perëndimor. E vetëdijshme për spektatorin mbi të cilin ajo ka fiksuar shikimin e saj enigmatik, ajo e paraqet trupin e saj me dëshirë dhe pa turp, për kënaqësinë e shikuesit. Nuancat e shumta të cekjeve të penelave, modifikimi i rritjes së ngjyrave dhe shpalosja delikate e dritës, të gjitha bashkohen për të formuar një ndjesi jete, që merr frymë brenda trupit të saj. Kjo figurë, ky trup i kësaj gruaje është një nga trupat më epshor në të gjithë historinë e artit perëndimor. E mbështjellë nga një atmosferë luksoze dhe e pikturuar me një ndjenjë të mahnitshme realizmi, Venusi me flokët e saj të shndritshme dhe që zbresin poshtë shpatullës e deri në barkun e saj të fryrë butësisht, vazhdon të mbajë të magjepsur shikuesin me pozën dhe sensualitetin e saj.

Atmosfera e veprës është si në një ëndërr, Venusi duket si perëndeshë e dashurisë, por në të nuk ka cupidë, siç ndodhte gjithmonë në veprat tradicionale të Venusit, e as një peizazh parajse. Në mungesë të këtyre elementëve tradicionalë, Ticiani na lë të kuptojmë se nuk bëhet fjalë për një figurë perëndeshë por për një femër reale. Dhe jo një femër e zakonshme, por një femër epshore. Kësisoj, shumë studiues kanë ngritur teza se vepra u porositi nga ndonjë klient i pasur që viziton prostitutën e tij. Por vepra përmban edhe elementë të një jete martesore ose të paktën një lidhje dashurore. Shikimi i saj është sa joshës aq edhe i kthjellët, dhe trëndafilat e kuq që mban në dorë janë simbol romance dhe dashurie, sikurse edhe vazoja me lule mërsinë që njihej si simbol i ndjenjave midis një çifti, pasi është një bimë që lulëzon gjithmonë në çdo ditë të vitit. Në të shohim edhe një kone, që në atë kohë simbolizonte dëshirat trupore, por gjithashtu, siç ndodh edhe sot, simbolizon besnikëri. Dhe po i njëjti qen është pikturuar edhe tek një tablo që Ticiani i bëri portretit të nënës së Dukës. Qeni nuk po leh, përkundrazi është i shtrirë dhe i rehatuar, që na lë të kuptojmë se njeriu që femra po shikon është i njohur për të, e jo një i huaj. Mund të ishte edhe një bashkëshort. Ndaj vepra, mund të mos jetë thjesht një histori prostitute, e as një bashkëshorteje, por një ide, një ideal i dashurisë.

“La pittura è propria poesia, cioè invenzione,” (Piktura është poezi, domethënë shpikje), tha Paolo Pino, artisti dhe shkrimtari venedikas i shekullit të 16-të, ndaj edhe kjo tablo duhet parë si e tillë. Kjo nudo përbën një hap përpara në krahasim me ikonografinë e deriatëhershme. Ajo shpaloset si një sensualitet fërgëllues: shtrirë përmbi një shtrat, hyjnesha ia ngul sytë me ngashënjim shikuesit. Konia e kruspulluar dhe shërbyeset në sfond e përforcojnë mbresën e jetës së përditshme, që e bën edhe më të pranishme vashën lozonjare. Për shumë prej nesh sot, kjo pamje e bukur dhe sensuale mund ta ketë humbur disi ngarkesën erotike, por pesë shekuj më parë ajo ishte me të vërtetë befasuese.

Komenti tipik mbi sensualitetin e veprës përmbledhet në letrën e një miku të Ticianit, i cili i shkroi kështu një sundimtari venedikas: “Ju betohem, zotëri, se nuk ka njeri me sy e me mend, i cili, duke e parë Venusin e Ticianit, nuk e beson që s’është e gjallë; nuk ka askush që është ftohur nga vitet, apo është ngurtësuar prej moshës, të mos ndiejë ngrohtësinë, butësinë, dhe vlimin e gjakut në venat e saj.”

Si një tablo poetike, ajo ka disa defekte realizmi në trupin e Venusit. Shikoni me kujdes kokën. Në raport me trupin, supet dhe gjatësinë, është shumë e vogël. Shikoni tani edhe këmbët, janë aq të vogla sa që Venusit sot do i duhej të vishte këpucë apo sandale të një fëmije 6 vjeçare. Edhe gjoksi i saj është shumë i vogël, ndërkohë që barkun e ka të fryrë. A nuk e njihte mirë Ticiani vizatimin? A nuk e njihte mirë anatominë? Përse vërehen gabime kaq trashanike dhe të pafalshme për një mjeshtër si ai?

Por, nuk janë gabime, është vetëm një dredhi optike, një eksperiment që Ticiani përdor për të hipnotizuar shikuesit. Kur shohim tablonë, qendra e vështrimit është tek seksi i Venusit, e cila është pjesa e vetme e vizatuar në proporcion, dhe teksa përqendrohemi aty, ajo pikë e cila duket sikur del nga tabloja e prek hundën e shikuesit, krijon një hapësirë sferike që shpërndahet nga koka dhe këmbët e bashkohet tek peizazhi jashtë lozhës. Në këtë mënyrë Ticiani e ka bërë veprën tre dimensionale e me plane vështrimi për të shpalosur thellësinë. Ticiani ishte piktor por më herët në jetën e tij kishte punuar edhe si skulptor, ndaj krijimi i pamjes tre dimensionale ishte i rëndësishëm për të.

Idea për të ofruar pikëpamje të shumëfishta të figurës ishte një element i Rilindjes dhe shërbente si paragon midis pikturës dhe skulpturës. Që në fillim të karrierës së tij Titiani kishte sfiduar artin

e skulpturës, duke shpikur reliefin *all’antica* edhe në pikturë. Gjithashtu, skulpturat greko-romake luanin një rol të rëndësishëm tek artistët fiorentinë dhe venedikas, ndaj edhe gjinjtë e vegjël dhe barku i fryrë i Venusit ngjasojnë me statujat greko-romake, të cilat ishin edhe frymëzimi i Rilindjes. Referencat antike që dallojmë në këtë vepër janë një shembull i interesimit të tij në artin e antikitetit klasik, të cilin ai e shihte si një burim të pashtershëm për motive dhe frymëzime. Megjithatë, ai kurrë nuk e kopjoi me fanatizëm artin antik; përkundrazi, ai e transformoi atë që huazonte për qëllimet e veta artistike.

E gjithë figura e Venusit duket si një poezi pasioni. Forma e saj e përgjithshme ngjason me një gjethe. Ajo qëndron e shtrirë sikur të ishte një gjethe që pluskon mbi ujë. Aq e lehtë, aq e butë, dhe aq përndezëse. Një genie dybotëshe. Gjysmë prej mishi e gjysmë perëndeshë.

Ajo kurrë nuk e humbi fuqinë e saj për t’i tronditur njerëzit. Rreth vitit 1880, shkrimtari Mark Twain shkoi për ta parë në Galerinë Uffizi në Firence, dhe ja si u shpreh ai:

Dhe atje e varur në mur, pa asnjë leckë apo gjethe për t’u mbuluar, ju mund të shikoni pikturën më të pisët, më të turpshmen, dhe më të pahijshmen që ka bota - Venusi i Ticianit. Nuk është se ajo është e zhveshur dhe e shtrirë në shtrat - jo, është qëndrimi i një prej krahëve dhe i dorës

së saj. Nëse do përpiguesha ta përshkruaja atë qëndrim, do të ishte një piskamë e shkëlqyer - por aty Venus qëndron e shtrirë, për të kënaqur gjithkënd, dhe është e drejta e saj që të qëndrojë e shtrirë, sepse ajo është një vepër arti, dhe arti ka privilegjet e veta.

Ticiani lindi rreth vitit 1488 në Pieve di Cadore. Ai la fshatin e tij të lindjes që në djalëri për të shkuar në Venecia, ku studioi nën Sebastiano Zuccato, Gentile dhe Giovanni Bellini, dhe në vitin 1508 punoi si ndihmës i Giorgione. Më pas, ai punoi në Padova dhe vetëm pas vdekjes së Giorgione dhe Bellini u hap rruga për të në Venecia. Ai u shpall piktori zyrtar i Republikës. Ai gjithashtu hodhi themelet e pozicionit të tij në jetën qytetare dhe u bë figura kryesore në botën e pikturës italiane. Reputacioni i Ticianit ishte i jashtëzakonshëm, por takimi me perandorin Charles V në dimrin e vitit 1532/33, çoi në emërimin e tij si piktor i perandorit, dhe i dha atij një gradë edhe më të pazakontë në botën e artit ndërkombëtar. Gjatë jetës së tij të gjatë, e cila mendohet se zgjati nëntëdhjetë e nëntë vjet, ai u ngjiti në një kulm lavdie thujtëse të krahasueshëm me Michelangelo. Thuhet se Perandori Charles V, në shenjë nderimi për të kishte marrë e ruajtur një penel që Ticiani e kishte flakur. Kjo ishte një shenjë përlulje para madhësisë së gjenit. Por, mjeshtri i madh, e huazoi këtë kompozim të Venusit nga një version i mëparshëm i kolegut të tij Giorgione, i cili, dekada më herët kishte pikturuar tablonë *Venusi i Fjetur*, i njohur edhe si *Venusi i Dresden* (1510).


Por, Venusi i Giorgione dallon nga vepra e Ticianit. Edhe pse mendohet se ishte vetë Ticiani që e përfundoi edhe tablonë e Giornione, ajo ka elementë të ndryshëm nga Venusi i Urbinos. Kur punoi si asistenti i tij, Ticiani mësoi aq shumë nga Giorgione sa historianët e artit e kanë të pamundur të dallojnë dorën e njërit apo tjetrit. Për një kohë të caktuar ai e imitoi aq shumë Giorgione sa pikturat e tij merreshin ndonjëherë për ato të mjeshtrit. Ticiani e adaptoi me drojë qëndrimin e Giorgione ndaj dritës dhe hijes, megjithatë, pavarësisht sa i varur mund të kishte qenë Ticiani, ai gjithmonë e ruajti pavarësinë e tij në pikturë. Dhe kjo vërehet midis dy Venuseve.

Venusi i Giorgione është shtrirë në natyrë, duke ruajtur kështu motivin tradicional ndërsa Ticiani e lidh hyjninë me jetën e përditshme në dhomën e një zonje; Giorgione e lidh siluetën e pemës dhe tokës, vijën e peizazhit në të majtë, me linjat e supit, gjoksit, krahut dhe dorës që prek seksin, duke shpalosur burimin dhe esencën e natyrës, ndërsa Venusi i Ticianit është një femër e vërtetë që preket e të ysht si një hyjni e mëkatshme, e cila mban një buqetë tunduese me trëndafila dhe derdh flokët shkujdesshëm. Dhe dallimi kryesor midis tyre është tek vështrimi. Venusi i Ticianit e vështron drejt e në sy shikuesin, aktive dhe me vetëdije të plotë ajo është tejet ftuese, ndërsa ai i Dresden ka sytë e mbyllur dhe është një figurë pasive e pavetëdijshme.

Veprat e Ticianit u frymëzuan nga arti i Raphael dhe Michelangelo. Kur vizitoi Romën në vitin 1545, Ticiani u impresionua aq shumë nga Moisiu i Michelangelo dhe nga vepra e tij *La Pieta*, sa që i kujtoi ato deri në fund të jetës së tij. Por, pavarësisht ndikimit të tyre, Ticiani mbeti gjithmonë vetja, i patrembur nga madhështia e atyre mjeshtërve. Ai u bë inxhinier i ngjyrës, dhe krijues i një emocioni të rrallë në art. Gjatë viteve të fundit të jetë së tij, ai madje nuk përdorte më penela, por bojën e hidhte drejt e me gishta. Ticiani zë vendin e parë në shkollën venedikase, dhe padyshim vepra e tij, *Venusi i Urbinos*, zë vendin e parë në bukurinë e figurës femërore në historinë e artit botëror.



Autoportret i piktorit italian Tiziano Vecellio (rreth 1490-1576), i njohur më shumë si Titiziano

A black and white close-up portrait of a man with dark, wavy hair and a serious expression. The lighting is dramatic, with strong shadows on the right side of his face. The text 'RIKARDI' is overlaid in a large, white, serif font at the top.

RIKARDI

Nuk kam asnjë peng

Onufri